



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 174 Prot.

Tiranë, më 09/02/2023

VENDIM

Nr. 16 DATË 09/02/2023

MBI

“ANALIZËN VJETORE TË PUNËS PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022, NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE”


Në zbatim të nenit 32, pika 1 dhe të nenit 38, pika 1, gërma “g”, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afati për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Senati Akademik pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Të miratojë raportin mbi analizën vjetore të punës për vitin akademik 2021-2022 në Universitetin e Arteve, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca si dhe t’i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)




das Buch

18



UNIVERSITETI I ARTEVE

**RAPORTI VJETOR I VEPRIMTARISË MËSIMORE ARTISTIKE-KËRKIMORE-
SHKENCORE DHE FINANCIARE VITI 2021-2022**



**SENATI AKADEMIK
TIRANË, DHJETOR 2022**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

HYRJE

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në Udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor...”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 21.10.2019, Universiteti i Arteve, Tiranë, paraqet Raportin vjetor të veprimtarisë mësimore, artistike-kërkimore shkencore dhe financiare për vitin akademik 2021-2022, në nivel universiteti, në kuadër të informimit dhe transparencës për veprimtarinë e tij.

Ky raport bazohet në raportet analitike të njësive kryesore të Universitetit të Arteve, si dhe të strukturave të tjera të UART.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur aktivitetin në tërësi të Universitetit të Arteve për vitin akademik 2021-2022.

Raporti vjetor është një pasqyrë e aktivitetit akademik dhe aktivitetit financiar, të zhvilluar nga Universiteti i Arteve, Tiranë. Raporti paraqet dhe pasqyron në formë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje për: funksionimin dhe performancën e strukturave përgjegjëse (organe kolegjiale, komisione të përhershme) në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike dhe financiare të UART dhe të fakulteteve; procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, njohuritë dhe kompetencat në nivel njësie kryesore; projektet ku personeli i UART merr pjesë si palë aktive, përqindjen e të diplomuarve; numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit, numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit që ofron UART, mbështetjen për studentët (bursa apo përjashtim/reduktimi i tarifave të shkollimit), pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre, cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi; mobilitetin e personelit akademik të realizuar në kuadër të projekteve, përmirësimit dhe plotësimit, sipas standardeve shtetërore të cilësisë. plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen mjediset didaktike, artistike-kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin, pagesat për pagat, sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Ky raport është hartuar referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësitë kryesore të UART si dhe nga sektorët e tjerë.

Në mbledhjet e organeve kolegjiale dhe drejtuese ndiqen procedura dhe protokolle të përcaktuara, të UART, në plotësimin e kërkesave të ligjit nr. 80/2015 si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

UART ka si prioritet fuqizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, reflektuar kjo dhe në miratimin e një strukture të posaçme për sigurimin e cilësisë. Nga burimet në dispozicion të UART, konstatohet se është treguar përgjegjshmëri në përmbushjen e detyrave përkatëse nga strukturat përgjegjëse. Kurrikula që ofron Universiteti i Arteve, Tiranë, është e lidhur ngushtësisht me kërkesat e profilizuara të saj dhe mbështetet nga një staf akademik tejet profesional. Programet e studimit janë qartësisht të përcaktuara dhe të përshtatshme me tregun, kjo në përmbushje të misionit që vetë UART ka në “...ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës të studentëve, të kualifikimit të tyre artistik si dhe veprimtarive të tjera në fushën e arteve”.

Universiteti i Arteve përbëhet nga Rektorati, Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik dhe Fakulteti i Arteve të Bukura.

Funksionimi i organeve kolegjiale dhe drejtuese kryhet në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Çdo njësi, strukturë, personel akademik, ndihmës akademik, dhe jo akademik është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procedurave, aktiviteteve dhe veprimtarive që zhvillon Universiteti i Arteve për realizimin e objektivave dhe zhvillimin e procesit mësimor, atij artistik-shkencor, si dhe aktiviteteve të tjera.

Senati Akademik ka ushtruar kompetencat e tij për mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike gjatë gjithë vitit akademik, nëpërmjet vendimeve të marra në mbledhjet përkatëse, të cilat i janë adresuar njësisive përkatëse për zbatim.

Bordi i Administrimit ka ushtruar kompetencat e veta në mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare të UART, nëpërmjet vendimeve të marra.

Rektorati, dekanatet si organe kolegjiale, në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë shqyrtuar dhe marrë vendime lidhur me strukturën e vitit akademik, komisionet për monitorimin e konkurseve të pranimeve, regjistrimeve të reja, transferimin e studimeve, komisionet për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, etj. Po ashtu janë propozuar dhe miratuar grupe pune, komisione apo grupe të posaçme në nivel universiteti.

Këshilli i Etikës si organ kolegjial, nuk ka pasur raste të adresuara këtij organi lidhur me mosrespektimin të kërkesave të moralit dhe të etikës në realizim të funksionit të detyrave të individëve.

Njësitë administrative, ndihmës akademike, rektorati, dekanatet si dhe komisionet ad-hoc të ngritura në rang Rektorati, në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë zbatuar vendimet e organeve kolegjiale apo drejtuese.

Mbi analizën e vitit akademik 2021-2022 të Fakultetit të Muzikës

Në vijim të urdhrin tuaj Nr. 74 datë 02.11.2022 “Mbi zhvillimin e analizës vjetore të Fakultetit të Muzikës për vitin 2021-2022, ju informoj si më poshtë vijon.

DEPARTAMENTI KMDP

1. Veprimtaria Mësimore

1.1. Proçesi mësimor për vitin akademik 2021-2022, bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Arsimit Nr. 395, datë 06.10.2021 *Për caktimin e datës së fillimit të vitit akademik 2021-2022 në institucionet e arsimit të lartë*, dhe shkresën e Rektorit të UART, për strukturimin e vitit përkatës akademik, Nr.1390.prot, datë 25.10.2021 *Struktura vjetore e procesit mësimor për vitin akademik 2021-2022* ka nisur si më poshtë vijon:

- Datë 18.10.2021 Ciklin I Bachelor dhe Ciklin II viti II Master;
- Datë 15 Nëntor Cikli II, viti I Master.

Përgjatë vitit akademik 2021-2022 Njësia Bazë KMDP ka marrë të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e ngarkesës mësimore bazuar në Udhërat e Rektorit të UART Nr.170, datë 25.11.2021, Nr.181, datë 24.12.2021, Nr.27, datë 18.03.2022. Njëherazi, bazuar në Urdhrin e Rektorit për rifillimin e vitit akademik dhe Vendimin e Dekanatit të Fakultetit të Muzikës Nr.1, datë 19.01.2022, sezoni i provimeve dimërore është spostuar në mënyrë që të jetë në koherencë me përfundimin e procesit mësimor, ndërkohë që ky i fundit është spostuar respektivisht me 2 (dy) javë për vitin I, Cikli II Master, sikurse dhe me 1 (një) javë për të gjitha vitet e tjera të studimit. Semestri II dhe sezoni i provimeve të verës dhe vjeshtës janë zhvilluar në përputhje me strukturën vjetore të procesit mësimor për vitin akademik 2021-2022.

Shpërndarja e ngarkesës mësimore, për vitin akademik 2021-2022, është realizuar në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*.

Fillimisht është realizuar shpërndarja e ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar dhe në vazhdimësi të atij me kohë të pjesshme dhe afat të caktuar. Ngarkesa mësimore e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për vitin akademik

2021-22 në Njësinë Bazë KMDP ka rezultuar në një total prej 11,925¹ orësh. Stafit akademik me kohë të plotë pranë Njësisë Bazë KMDP ka mbuluar 9,159 orë mësimore pra rreth 76% të totalit të orëve, ndërkohë që ai me kohë të pjesshme rezulton të jetë në shifrën e 2,769 orëve pra rreth 24% .

Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*, ndërkohë që një pjesë e tyre, në aktmarrëveshjet e nënshkruara me Njësinë Bazë KMDP, pas miratimit të dekanit të FM, janë ngarkuar me orë të tjera, në tejkalim të mbinormës por pa pasur efekte financiare. Stafit akademik me kohë të pjesshme dhe afat të caktuar, ka realizuar normën mësimore, në përputhje me udhëzimin e sipërpërmendur, ndërkohë që në disa raste, ka pasur pedagogë të cilët kanë pranuar të realizojnë orë mbi normën e parashikuar, deri në 100%, por gjithsesi pa pretenduar përfitime financiare përtej atyre të normuara. Krahasuar me vitin akademik 2020-2021, për shkak të rënies së numrit të studentëve të regjistruar në programet e studimit pranë Fakultetit të Muzikës, vërehet një rënie e orëve në auditor, reflektohet qoftë në ngarkesën e stafit akademik me kohë të pjesshme e qoftë në atë me kohë të plotë, si më poshtë vijon:

	2020-21	2021-22	Diferenca
Orë gjithsej²	12,670	11,925	745
Stafi Akademik me Kohë të Plotë	9,582	9,159	423
Stafi Akademik me Kohë të Pjesshme	3,088	2,769	319

Në programet e studimeve të Ciklit I-II që zhvillohen pranë Departamentit KMDP për vitin akademik 2021-22, ndoqën studimet 122 studentë. Krahasuar me vitin akademik 2020-21 kemi një rënie prej rreth 12% në numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit që ofrohen në Departamentin KMDP. Rënia më e madhe e të regjistruarve vërehet në Ciklin I Bachelor në masën rreth 22%. Numri i studentëve sipas programeve të studimit dhe cikleve përkatëse në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Njësia Bazë KMDP rezulton si më poshtë vijon:

	2020-21		2021-22	
	Bachelor	Master	Bachelor	Master
Muzikologji	7	5	6	2
Kompozicion	14	4	7	7
Dirizhim	5	6	5	6
Pedagogji Muzikore	49	49	35	54
Totali	139		122	

Të gjitha programet e studimit në Njësinë Bazë KMDP janë me status aktiv dhe vazhdojnë funksionimin në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bazuar në konsultimet e mbajtura me pedagogët dhe konsultimet e herë pas herëshme të regjistrave mësimore, rezulton se objektivat e secilës prej lëndëve, në programet e studimit pranë Njësisë Bazë KMDP, janë realizuar në përputhje me parashikimet e Syllabuseve të lëndëve respektive.

¹ Në ngarkesën mësimore janë përfshirë edhe lëndët e mbuluara nga pedagogët me kohë të plotë pranë Fakulteteve të tjera të UART, sikurse dhe pedagogët me kohë të pjesshme pranë Njësisë të tjera Bazë pranë FM. Ngarkesa mësimore përllëgaritet për të gjitha lëndët e zhvilluara nga pedagogët e atashuar pranë Njësisë Bazë KMDP, sikurse dhe ata të përmendur më sipër.

² Në tabelën e mësipërme janë paraqitur totali i orëve për stafin e akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme pranë Njësisë Baze KMDP

Përgjatë vitit akademik 2021-2022, janë materializuar ndryshimet e planeve mësimore, sipas argumentave të parashtruar me shkresën Nr163. prot, datë 15.09.2021. Të gjitha ndryshimet e aplikuar në planet e programeve të studimit kanë ardhur si rezultat i analizës së veprimtarisë mësimore dhe harmonizimit të lëndëve të njëjta mes programeve të ndryshme të studimit qoftë përsa i përket sasisë së ngarkesës mësimore të parashikuar në auditor e qoftë përsa i përket krediteve (ECTS), sikurse dhe përshtatjes së emërtesave për ti bërë më të qarta për studentët aktualë apo për kandidatët e ardhshëm.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 Njësia Bazë KMDP ka zgjeruar ndjeshëm ofertën akademike në nivelin e formimit shkencor dhe atij profesional. Më konkretisht falë aplikimeve të suksesshme të kësaj njësia është siguruar:

- Hapja për herë të parë e programit të ciklit III doktoratë në “Muzikologji” me Urdhrin e MAS Nr. 128, datë 16.03.2022.
- Çeljen e trajnimeve për programin “Mësimdhënie e muzikës për nxënësit me aftësi ndryshe”. Trajnimi i sipërpërmendur është akredituar nga ASCAP me Vendimin e Komisionit të Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit Nr.118, datë 20.05.2022

Të gjitha programet e studimit të ofruara nga Njësia Bazë KMDP janë hartuar dhe zhvillohen në përputhshmëri të plotë me misionin e Universitetit të Arteve parashikuar në Statutin e UAR Neni. 4. Rrjedhimisht këto programe promovojnë, mbështesin, ruajnë dhe konsolidojnë vlerat kulturore dhe akademike kombëtare. Përbajtja e programeve të studimit pranë Njesisë Bazë KMDP synojnë aftësimin e studentëve në krijimtarinë dhe interpretimin muzikor, kërkimin shkencor artistik dhe në mësimdhënien e muzikës për të gjitha nivelet arsimore në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit përkatës. Si të tilla, të diplomuarite këtyre programeve do të pasurojnë trashëgiminë kulturore kombëtare duke krijuar kështu një vlerë të shtuar në kapacitetet akademike në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, programet e studimit të ofruara në Njesisë Bazë KMDP, janë të aprovuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, e kështu, reflektojnë prezantimin e ofertës akademike në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit. Të gjitha lëndët e parashikuara në planet mësimore të programeve të studimit të ciklit I, Kompozim, Dirizhim, Muzikologji dhe Pedagogji Muzikore, sikurse dhe ato të ciklit II, Kompozim dhe Mësuesi, Dirizhim dhe Mësuesi, Muzikologji dhe Mësuesi, Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi janë zhvilluar konform programeve të lëndëve të cilat janë objekt rishikimi i përvitshëm dhe pësojnë ndryshime/përshtatje në varësi të propozimeve të pedagogëve përkatës. Lëndët e zhvilluara në programet e sipërpërmendura në total kanë rezultuar në një ngarkesë prej 10,384 orësh mësimore në auditor të grupuara si më poshtë:

Sasia e orëve për lëndët e zhvilluara nga studentët e programeve KMDP					
	Lënda*	Ushtrime/Seminare	Speciale	Leksione	Totali
1	Harmoni	300		120	420
2	Harmoni Stilistike	120		45	165
3	Kompozicion		780		780
4	Kontrapunkt (Stili i Ngushte, Stili i Lire, Kontrapunkt I-II, Hyrje ne kontrapunkt Vokal-Instrumental)	420		120	540
5	Shkrim Muzikor III			30	30
6	Analize Forme KMDPIK	210		60	270
7	Analize Rep Specifik	330		30	360
8	Instrumentacion-Orkestracion	270		60	330
9	Shkrim Muzikor I-II	4		30	34
10	Lexim Partiture	1050			1050

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al

11	Elektroakustike (Produksion Muzikor)	150		30	180
12	Hyrje ne Menaxhim Projekti			30	30
13	Shkrim dhe Metodika e Punës Studimore	10		60	70
14	Stil Gjuhësor dhe Letrar	10		60	70
15	Anatomi			30	30
16	Zhvillim Kurrikule	15		30	45
17	Vlerësim në Arsim	15		30	45
18	Histori Muzike	40		317	357
19	Estetika e Muzikës	6		30	36
20	Solfezh KMDP	60		90	150
21	Folklor	6		30	36
22	Shkrim ne PC	24		21	45
23	Dirizhim Speciale (Ork-Kor)		840		840
24	Dirizhim Bande	60			60
25	Edukim Koral	120			120
26	Dirizhim Koral-Orkestral (Pedagogji)	60			60
27	Bazat e Dirizhimit	60			60
28	Hyrje ne Etnomuzikologji	2		28	30
29	Hyrje ne Muzikologji Sistematike	2		28	30
30	Muzikologji		660		660
31	Teoritë dhe Metodatat e Analizës	6		30	36
32	Teknikat e Kompozimit Shek XX (I-II)	150		90	240
33	Pedagogji e Përgjithshme	10		30	40
34	Didaktika	60			60
35	Psikologji Komunikimi	15		30	45
36	Psikologji Edukimi	15		30	45
37	Edukimi Muzikor ne Arsimin Special	15		30	45
38	Psikologji Arti			30	30
39	Etike	10		30	40
40	Teoritë e te Nxënës dhe Menaxhim Klase	15		60	75
41	Psikologji Zhvillimi	15		30	45
42	Muzika ne Shoqëri	15		30	45
43	Sociologji Muzikore	10		30	40
44	Organologji	4		30	34
45	Semiotika dhe Semantika	12		60	72
46	Historia e Estetikës	4		30	34
47	Hist e Inst te Muz Perendimore	2		15	17
48	Historia e Mendimit Teorik	8		60	68
49	Inst-Ork. Bande	90		15	105
50	Hyrje ne Teknologjine e Muzikës	210		30	240
51	Jazz dhe Pop			30	30
52	Muzike Filmi dhe Media	10		30	40
53	Improvizim ne Piano	120			120
54	Arranzhim dhe Kompozim Jazz	75		30	105
55	Teori Jazz (Harmoni)	150		30	180

56	Pedagogji Muzikore I			60	60
57	Pedagogji Muzikore II			60	60
58	Histori Arti	15		30	45
59	Kanto Sekondare	60			60
60	Kurrikula Muzike			15	15
61	Italisht			30	30
62	Anglisht	27		33	60
63	Kërcim Folk dhe Bashkëkohor	46		14	60
64	Frëngjisht			30	30
65	Ansambël Jazz	30			30
66	Piano Sekondare	1050			1050
67	Fizarmonike (sekondare)	120			120
	Totali	5713	2280	2391	10384

1.2. Në vitin akademik 2021-2022 në Njësinë Bazë KMDP kanë dhënë mësim 25 pedagogë me kohë të plotë dhe 26 pedagogë me kohë të pjesshme dhe afat të caktuar. Dëshirojmë të theksojmë se stafi akademik me kohë të plotë që ka dalë në pension në vitet e mëhershme akademike, sipas parashikimeve të shkresës Nr.109, 110. prot, datë 02.07.2021, (protokolluar në Rektorat me Nr.740/1, datë 5.7.2021) *Mbi planifikimin e stafit akademik me kohë të pjesshme dhe të plotë për vitin akademik 2021-2022 dhe për të cilin, në po të njëjtën shkresë është kërkuar plotësimi me dy pedagogë me kohë të plotë për vitin akademik 2021-2022, deri më sot nuk ka mundur të plotësohet. Ndërkohë, për vitin akademik 2022-2023 parashikohet dalja në pension pleqërie e 4 (katër) pedagogëve të kategorisë Profesor, çka do të reduktonte stafin akademik me kohë të plotë në 21 pedagogë dhe do të krijonte vështirësi për sa i përket plotësimit me titullarë të disa lëndëve dhe në mënyrë të veçantë mbarëvajtjes së programit të sapoçelur të Ciklit III, doktoratë në "Muzikologji". Rrjedhimisht, bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Neni. 65, Pika. 1 dhe Statutin e UART, Njësia Bazë KMDP ka parashikuar angazhimin e 2 (dy) pedagogëve, që mbushën moshën e daljes në pension, me kontratë. Gjithsesi, në vazhdimësi për vitin akademik 2022-2023 e në vazhdim Njësia Bazë KMDP rinovon kërkesën për çeljen e konkursit për 2 (dy) pedagogë me kohë të plotë, ndërkohë që parashikohet, për vitin akademik 2022-2023 angazhimi i 24 pedagogëve me kohë të pjesshme. Në zbatim të VKM Nr. 173, datë 26.02.2020 dhe urdhrit të Rektorit të Universitetit të Arteve Tiranë Nr. 23 datë 28.02.2020 dhe të shkresës Nr. 264/2 prot, datë 28.02.2020, Dr. Meri Kumbe, për shkak të emërimit Zv. Ministre e Kulturës, pasi i është ngrirë pozicioni i punës pranë Njesisë Bazë KMDP, është angazhuar sërish si pedagog me kohë të pjesshme.*

2. Veprimtaria Administrative

2.1. Përgjatë vitit akademik 2021-2022 ka filluar procesi i akreditimit për programet e studimit të Ciklit II "Kompozim dhe Mësuesi", "Muzikologji dhe Mësuesi", "Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi", sikurse dhe "Dirizhim dhe Mësuesi". Në funksion të sa më sipër Njësia Bazë KMDP me shkresën Nr.85.prot, datë 07.03.2022, në përgjigje të shkresës Nr.283. prot, datë 28.02.2022, me tonën Nt.75. Prot, datë 28.02.2022 të zv. Rektorit, Prof. Dr. Erald Bakalli, ka paraqitur përbërjen e grupeve të punës për hartimin e RVB-ve për secilin prej programeve të sipërpërmendur. Në funksion të procesit të sipërpërmendur, janë riparë dhe hartuar edhe rregulloret e programeve të studimit të cilat do të nënshtrohen procesit akreditues, sikurse dhe Rregullorja e Njesisë Bazë KMDP.

2.2. Në funksion të plotësimit të të gjitha detyrimeve, bazuar në planet mësimore përkatëse, të programeve të studimit pranë Njesisë Bazë KMDP, sikurse dhe për promovimin dhe

mbështetjen e stafit akademik dhe studentëve të diplomuar pranë kësaj njësie, departamenti KMDP, në vitin akademik 2021-2022, ka iniciuar dhe bashkëpunuar me disa institucione të cilat mbulojnë fushën e arsimit dhe kulturës. Kësisoj janë realizuar bashkëpunime me:

- a. Njëpërmjet shkresës Nr. 116, datë 04.04.2022 Fakulteti i Muzikës ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Para universitar Zyrën Vendore Arsimore të Qarkut Tiranë. Bazuar në marrëveshjen e mësipërme, studentët e programeve të Ciklit II “Kompozim dhe Mësuesi”, “Muzikologji dhe Mësuesi”, “Pedagogji Muzikore dhe Mësuesi”, “Dirizhim dhe Mësuesi”, sikurse dhe ata të Ciklit I në programin “Pedagogji Muzikore”, kanë mundur të kryejnë praktikat mësimore, sipas parashikimeve në planet përkatëse mësimore, në shkollat e arsimit para universitar në Tiranë.
 - b. Njëpërmjet shkresës Nr. 159, datë 27.04.2022 Fakulteti i Muzikës ka nënshkruar një marrëveshje me Organizatën “SOS-Fshatrat e fëmijëve Shqipëri”. Marrëveshja e sipërpërmendur është nënshkruar me synimin e realizimit të praktikave të lëndës “Muzika në Shoqëri” për programin e studimit “Pedagogji Muzikore”.
 - c. Ministria e Kulturës, përsa i përket aktiviteteve të mbajtura në fushën e muzikës, shpalli vitin 2022 si viti i kompozitorit Çesk Zadeja. Lidhur me sa më sipër, sikurse dhe në kuadër të 110 vjetori të pavarësisë dhe 60 vjetori të themelimit të Fakultetit të Muzikës, u çel fondi i krijimtarisë muzikore. Njësia Bazë KMDP ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Kulturës për hartimin dhe implementimin e këtij fondi duke sugjeruar edhe administrimin e tij në 2 (dy) kategori, respektivisht fondin për krijuesit e rinj dhe atë për kompozitorët e karrierës.
- 2.3.** Në vitin 2022, duke filluar nga muaji Prill, janë mbajtur mbi 60 aktivitete në kuadër të 60 vjetorit të Fakultetit të Muzikës. Njësia Bazë KMDP qoftë njëpërmjet pedagogëve të saj, si pjesëmarrës me krijimet e tyre muzikore që u interpretuan në koncertet e mbajtura në kuadër të 60 vjetorit, e qoftë në cilësinë e organizatorit të aktiviteteve dhe promovimit të figurave të rëndësishme që kanë kontribuar pranë kësaj njësie, është përfaqësuar denjësisht në aktivitetet e mbajtura. Lidhur me sa më sipër por edhe në vazhdimësi të aktiviteteve të përvitshme që organizon Njësia Bazë KMDP si Master-Class-e, Koncerte, konferenca etj., gjatë vitit akademik 2021-2022, janë organizuar nga kjo njësi aktivitetet si më poshtë:
- 16.11.2021, Master-Class me kompozitorin Ismail Mehmeti (SHBA).
 - 19.11. 2021, Leksion i hapur me temën “Procesi i Vetë rregullimit në Edukimin Muzikor” mbajtur nga Dr. Egli Prifti.
 - 16.12.2021, Master-Class me temën “Teknikat e interpretimit të muzikës bashkëkohore në instrumentin e Saskofonit”, mbajtur nga Rafael Yebra (Spanjë).
 - 03-05.06.2021, Master-Class me dirigjentin Paolo Olmo (Itali).
 - 04.06.2021, koncerti klasës së kompozicionit.
 - 09.06.2022, Tryezë e Rrumbullakët me temën “In Memoriam” me synim evidentimin e disa figurave me një kontribut të veçantë në edukimin muzikor, pranë Fakultetit të Muzikës. Takimi u moderua nga Prof. Dr. Zana Shuteriqi (drejtuese e katedrës së Muzikologjisë), ndërkohë që referate u mbajtën nga pedagogë të Fakultetit të Muzikës.
 - 10.06.2022 u organizuar leksioni i hapur "Shkallët e lashta në muzikën popullore shqiptare dhe veçoritë e harmonizimit modal", mbajtur nga Prof. Asoc. Pëllumb Vorpsi.
 - 30.06.2022, Festivali i Muzikës së Re Vokale, ku u interpretuan vepra të kompozitorëve, pedagog pranë kësaj Njësia.

Gjithashtu, qëkurse, në kuadër të aktiviteteve mbajtur për 60 vjetorin e Fakultetit të Muzikës, u pa me vend vlerësimi i një sërë pedagogësh të dalë në pension, të cilët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në formimin e brezave të rinj. Njësia Bazë KMDP me shkresën

Nr.199/1.prot, datë 26.05.2022, Nr.185.prot, datë 14.05.2022, dhe Nr.158/1.prot, datë 04.05.2022, propozoi, çka dhe më pas u miratua nga Fakulteti i Muzikës dhe Senati Akademik:

- Prof. Hajg Zacharian dhe Prof. Zef Çoba për tu vlerësuar me titullin e mirënjohjes nga Universiteti i Arteve Tiranë.
- Z. Albert Paparisto për tu vlerësuar me titullin “Doctor Honoris Causa”
- Prof. Hamide Stringa për tu vlerësuar me titullin “Profesor Emeritus”

2.4. Në funksion mbështetjes së veprimtarive mësimore dhe atyre artistike/shkencore Njësia Bazë KMDP ka hartuar parashikimet të mbështetura edhe me projekt-buxhetet përkatëse. Më konkretisht, në kuadër të hartimit të PBA 2023-2025 dhe planit të punës së miratuar nga rektori i UART Prof. Kastriot Çausi, bërë me dije nëpërmjet shkresës Nr. 429.prot, datë 18.03.2022, me tonën Nr.107/1.Prot, datë 28.03.2022, nëpërmjet shkresës Nr. 233.prot, datë 08.07.2022, kemi paraqitur parashikimet tona të argumentuara për PBA 2023-2025.

Gjithashtu në përgjigje të shkresës Nr.278/1. prot, datë 28.02.2022, me tonën Nr.71.Prot, datë 28.02.2022, të Znj. Alma Sinanaj, lidhur me përcaktimin e shpërndarjes së të ardhurave për vitin 2022, në koherencë me PBA 2022-2024, nëpërmjet shkresës Nr. 71/1.prot, datë 07.03.2022 kemi paraqitur kërkesat për mbështetje lidhur me:

- a) Përfundimin e studios së muzikës elektroakustike;
- b) Realizimin e një CD me vepra të studentëve të kompozimit;
- c) Realizimin e një libërthi (booklet) për promovimin e Njesisë Bazë KMDP dhe programeve të studimit që zhvillohen pranë kësaj Njësie.

3. Veprimtaria Artistike-Shkencore e Stafit Akademik

Bazuar në Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*, VKM Nr. 329, datë 12.04.2017 *Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik*, sikurse dhe aktmarrëveshjet e nënshkruara me Njësinë Bazë KMDP, stafi akademik me kohë të plotë pranë kësaj njësie ka realizuar një sërë veprimtarish artistike-shkencore, të cilat në total po i përmbledhim si më poshtë:

Veprimtaria Artistike-Shkencore e stafit akademik me kohë të plotë pranë Njesisë Bazë KMDP për vitin akademik 2021-2022	
Botimet e realizuara nga stafi akademik (monografi, artikuj etj.)	2
Krijimtaria Muzikore e stafit akademik interpretuar gjatë vitit akademik	46
Artikuj shkencor të stafit akademik	7
Koncertet e mbajtura nga stafi akademik	89
Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore	9

Problematika dhe Sugjerime

Problematika 1. Panvarësisht kërkesave të përsëritura nga Njësia Bazë KMDP për krijimin e mbështetjes financiare të stafit akademik me kohë të plotë për veprimtaritë artistike/shkencore, për fat të keq konstatohet ende e mbështetjes financiare.

Konkretisht, të gjitha pjesëmarrjet e stafit akademik në konferenca shkencore, aktivitete koncertore etj., janë mbuluar me shpenzimet e vetë stafit akademik ose me fonde të siguruara nga këta të fundit nëpërmjet aplikimeve në donatorë të ndryshëm. E njëjta problematikë vërehet edhe për financimin e botimeve të studimeve, përkthimeve etj. të stafit akademik.

Problematika 2. Qëkurse Njesisë Bazë KMDP i është aprovuar programi i Ciklit III, doktoratë në “Muzikologji”, gjykojmë që tashmë është e domosdoshme mbështetja e një reviste shkencore. Një revistë e tillë është kërkuar prej vitesh nga njësia jonë, ndërkohë që tashmë mungesa e saj do të sillte vështirësi në mbarëvajtjen e programit të doktoratës. Studentët e

programit të doktoratës, sikurse dhe stafi akademik, kanë detyrimin e realizimit të botimeve shkencore.

Zgjidhja 1. Lidhur me problematikën 1, sugjerojmë që të krijohet mundësia e një fondi të dedikuar për të mbuluar shpenzimet e pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca dhe aktivitete artistike në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Zgjidhja 2. Lidhur me problematikën 2 propozojmë çeljen e një reviste shkencore. Kjo revistë, bazuar në mundësitë reale të financimit dhe ngritjes së bordeve editoriale, mund të jetë edhe një revistë për gjithë Universitetin e Arteve, ndërkohë që botimi i saj, në mënyrë që të ulë kostot, mund të materializohet edhe *online*.

Problematika 3. Laboratori i Tingullit, një financim ky i vitit akademik 2018-2019, aktualisht nuk është vënë plotësisht në punë. Kjo për shkak të mungesës së izolimit akustik çka e bën të pamundur arritjen e të gjitha objektivave të lëndëve, sipas programeve të studimit, sikurse dhe pamundëson regjistrimin audio. Njëherazi mosplotësimi përfundimtar i laboratorit të tingullit dhe kërkesave të tjera për logjistikën e nevojshme në funksion të zhvillimit të lëndëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës, do të sjellin vështirësi serioze në thithjen e studentëve për një sërë programesh studimi që zhvillohen pranë njësisë tonë. Konkretisht, Njësia Bazë KMDP, parashikon rritjen e ofertës akademike me lëndë të fushës së teknologjisë së muzikës, në mbështetje të të cilave nevojitet pajisja me bazën e nevojshme materiale sipas parashikimeve të shkresës Nr.77/1.prot, datë 20.05.2021 dhe shkresës Nr.33/1.prot, datë 04.02.2022.

Zgjidhja 3. Problematika e paraqitur më sipër, duhet të marrë zgjidhje urgjente nëpërmjet mbështetjes pikë së pari të izolimit akustik të Laboratorit të Tingullit dhe plotësimi të bazës materiale. Njëherazi, në mënyrë që ky Laborator të funksionojë plotësisht, organika e Fakultetit të Muzikës duhet plotësuar me një inxhinier zëri i specializuar në trajtimin e aparaturave audio.

Problematika 4. Tashmë prej kohësh planet mësimore të arsimit të mesëm të ulët kanë përgjysmuar ngarkesën mësimore të lëndës së muzikës, ndërkohë që kjo lëndë, së bashku me format e tjera të artit, paraqiten si lëndë me zgjedhje në arsimin e mesëm të lartë. Një qasje e tillë krijon mangësi të theksuara në formimin e nxënësit i cili në të ardhmen mund të jetë një kandidat për studentët në një prej programeve të studimit në Njësinë Bazë KMDP. Pranë njësisë tonë kemi pasur shpesh herë studentë të cilit vinin nga arsimit para universitar jo specifik muzikor, çka e bën këtë kategori pjesë të kandidatëve të mundshëm për student pranë programeve tona. Njëherazi, përgjysmimi i orëve në dispozicion të lëndës së muzikës në nivelet arsimore të sipërpërmendura ka sjellë një mungesë të theksuar tregu për punësimin e studentëve të diplomuar në programet tona.

Zgjidhja 4. Propozojmë rishikimin e ligjit të arsimit para universitar sikurse dhe planet mësimore të parashikuara për kurriculën. Në gjykimin tonë lënda e muzikës në arsimin para universitar të mesëm të ulët duhet të rivlerësohet në 2 orë në javë, çka do të mundësonte impaktin e duhur formues dhe social që muzika ka mbi brezin e ri. Njëherazi vlerësojmë se Artet, në arsimin e mesëm të lartë, duhet të kthehen në lëndë të detyrueshme të kurriculës shkolllore.

DEPARTAMENTI I INTERPRETIMIT

Gjatë këtij viti jubile të 60 Vjetorit të FM, DI ka realizua objektivat e synuara në aspektin didaktik ashtu dhe në drejtim të aktivitetit artistik si për personelin akademik ashtu dhe për studentët e këtij departamenti. Ky departament ka luajtur rolin kryesor në projektin e madh të FM, duke mbajtur mbi 80% të aktiviteteve të realizuar me pjesëmarrjen e pedagogëve, studentëve si solistë, në ansamble dhe orkestra. Pjesa e mbetur e aktiviteteve është realizuar prej DI në bashkëpunim me departamentet e tjera të UART.

Perveç aktiviteteve duhen evidentuar dhe këto fakte:

- Hapja e dy programeve të reja të studimit: “Muzikë Jazz” dhe “Perkusion”

- Kemi pasur prurje pozitive e studentëve të vitit të parë sidomos në programin e studimit Violinë, Piano, Kitarë, Fizarmonikë etj. Prurjet pozitive lidhen me disa arsye si më poshtë:
 - angazhimi i profesorëve me kohë të plotë dhe atyre të ftuar ka qenë mjaft serioz dhe dhe gjithnjë e më cilësor;
 - Rekrutimi i pedagogëve të rinj dhe atyre të ftuar ka qenë gjithnjë e më rigoroz bazuar edhe në performancën e tyre si në drejtim të mësimdhënies dhe komunikimit me kolegët dhe studentët ashtu në aktivitetet e tyre artistike;
 - Përfshirja gjithnjë e më shumë e studentëve në projekte artistike brenda dhe jashtë shkollës veçanërisht në projektin e 60 Vjetorit të përmendur më lart;
 - Studentëve i është dhënë mundësia që të përzgjedhin pedagogun e tyre të Lëndës Speciale, Muzikës së Dhomës apo lëndëve të tjera individuale.
- Departamenti i Interpretimit ka rekrutuar 5 pedagogë të rinj me kohë të plotë midis 12 kandidatëve. Vlen të veçohet fakti që për herë të parë në këtë institucion ka pedagog me kohë të plotë në Trombon dhe Bastubë, si dhe u rekrutua një pedagog me kohë të plotë në Oboe pas më shumë se 25 vitesh mungesë. Kandidatët fitues kishin një përvojë shumë të mirë në drejtim të mësimdhënies, performancës artistike dhe njohjes së thellë të syllabus-ëve të lëndëve për të cilat konkuronin. Numri i pedagogëve të ftuar vazhdon të reduktohet në lëndët speciale me synimin që studentët të jenë pjesë e klasave të profesorëve tanë të titulluar. Pjesa më e madhe e studentëve janë sistemuar në klasat e profesorëve me tituj e grada ndërsa është bërë një seleksionim mjaft serioz për pedagogët e ftuar duke u fokusuar në kontributin e tyre profesional e artistik. Mjaft nga pedagogët me kohë të plotë duhen falenderuar për angazhimin e tyre duke marrë edhe dyfishin e normës bazë.
- **Aktiviteti artistik** i pedagogëve dhe studentëve ka qenë shumë më i pasur se vitet e mëparshme falë edhe jetës artistike dhe atmosferës së krijuar në UART me rastin e 60-vjetorit të FM. Shumë nga koncertet recitale, koncertet e klasave, koncerte on-line e deri te botimi i CD-ve ose organizimi i festivaleve në të gjithë vendin janë realizuar prej stafit tonë dhe studentëve të këtij departamenti
- **Vetëm në periudhën Prill-Qershor 2022 janë organizuar dhe realizuar 60 koncerte me pjesëmarrjen e 90% të studentëve dhe thujse të gjithë pedagogëve të departamentit të Interpretimit me klasat e tyre. Në këto aktivitete pati një pjesëmarrje të madhe të publikut jo vetëm pjesëtarë të shkollës por edhe jashtë saj, përfshirë publik i huaj i cili i dha një vizibilitet të madh shkollës sonë dhe në të njëjtën kohë pasurojë jetën artistike në kryeqytet me aktivitete thujse të përditshme.** Disa pedagogë të DI kanë organizuar dhe aktivitete artistike me ansamble të mëdha dhe grupe më të vogla ku kanë përfshirë mjaft studentë. Gjithashtu paralelisht janë organizuar edhe master-klase dhe workshop-e (free) me studentët e DI, në kuadër të këtyre eventeve. Këto aktivitete kanë qenë në të njëjtën kohë edhe si një laborator dhe përballje me publikun për studentët dhe pedagogët e DI.
- Një pjesë e pedagogëve dhe studentëve kanë marrë pjesë edhe në aktivitete të rëndësishme jashtë vendit. Departamenti Interpretimit vazhdon të mbështesë pa kursim projektet artistike individuale kolektive apo evente të rëndësishme të pedagogëve dhe studentëve siç janë Festalet Ndërkombëtare, etj. Disa pedagogë vazhdojnë të kenë fare pak aktivitet artistik.
- **Programi Erasmus** ka rifilluar pas një periudhe ndërprerje për shkak të pandemisë. studentë kanë shkuar nëpërmjet këtij programi në *Norvegji* (6 studentë) dhe *Spanjë* (3 studentë) dhe, gjithashtu kemi pasur shkëmbime profesorësh (*3 Trieste, 3 Cosenza - Itali*) dhe (*6 Vigo, 2 Granada - Spanjë*) personel administrativ (1 *Vigo Spanjë*).
- Përsa i përket **projekteve shkencore**, vazhdon të ketë një numër të kufizuar të tyre për

shkak edhe të specifikës sonë që tashmë shpresojmë që do marri rrugë pas statusit të veçantë për institucionin tonë. Në të dhënat bazë që DI ka mbledhur së fundmi për çdo pedagog, vërehet se shumica syresh ka aktivitet artistik në projekte artistike brenda dhe jashtë vendit ndërsa kur vjen puna të projektet kërkimore e shkencore, kjo rubrikë është e bardhë, për pjesën më të madhe. Megjithatë, disa pedagogë janë të angazhuar në projekte evropiane. Po ashtu, ka disa botime librash studimorë dhe partiturash apo katalogësh, si dhe artikuj kritikë të cilat gjithashtu ndihmojnë në zhvillimin e procesit mësimor.

DEPARTAMENTI I KANTOS

Nëpërmjet materialit në vazhdimësi, po Ju informoj rreth aktivitetit pedagogjik dhe artistik që njësia bazë Kanto ka zhvilluar përgjatë vitit akademik 2021-22.

1. Veprimtaria Mësimore

- 1.1. Njëherazi me fillimin e vitit akademik është kryer shpërndarja e studentëve duke siguruar ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe në vazhdimësi të atij me kohë të pjesshme. Ngarkesa mësimore për vitin akademik 2021-22 në Njësinë Bazë Kanto ka rezultuar në një total prej 5740 orësh pra rreth 21% më pak (kryesisht tek pedagogët me kohë të pjesshme) se ngarkesa e vitit akademik 2020-21. Në Njësinë Bazë Kanto stafi akademik me kohë të plotë ka mbuluar 70% të totalit të orëve ndërkohë që ai me kohë të pjesshme rezulton të jetë në shifrën 30%. Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore e cila, në raport me pozicionin respektiv, varijon nga 30%-35% të normës bazë. I njëjti fenomen vërehet në disa raste edhe tek pedagogët e ftuar që kurse 24% e tyre rezultojnë të kenë më shumë se 150 orë mësimore.
- 1.2. Me fillimin e vitit akademik 2021-22 janë aplikuar edhe ndryshimet e planeve mësimore të miratuara në Këshillin e Fakultetit më datë 15.09.2021 Nr. Prot 153/1 dorezuar ne Rektorat me 21.09.2021 me numër protokolli 1074/1. Konkretisht bazuar ne kurikulen e departamentit Kanto lendet parësore dhe dytësore nuk kane pësuar modifikime apo ndryshime
- 1.3. Në lidhje me provimet e integruara dhe çështje të tjera që kanë lidhje me ECTS-të, minimumin që duhet të sigurojë studenti për të kaluar nga një vit në tjetrin, frekuentimin e mësimit etj., është vërejtur një mungesë e theksuar informacioni tek studentët. Për të plotësuar këtë boshllëk, është hartuar i ashtuquajtur *Manuali i Studentit* i cili ofron informacione bazike për studentët nisur nga problematikat që hasen
- 1.4. Në Mars 2020 FM dhe Departamenti Kanto ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Folklorike pranë Ministrisë së Kulturës. Marrëveshja parashikonte bashkëpunimin mes dy institucioneve në funksion të pajisjes së studentëve të programit mësimore Pedagogji Muzikore me njohuri bazë rreth ndërtimit dhe funksionimit praktik të instrumenteve folklorikë. Lidhur me sa më sipër në ambientet e UART dhe FM studentët e pedagogjisë muzikore kanë ndjekur work-shop-in nën udhëheqjen e bartësit sugjeruar nga QKVF-ja.
- 1.5. Veprimtaria e Departamentit Kanto lidh marrëveshje bashkëpunimi me Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit dhe Ansambllit Popullor TKOBAP për angazhimin e studenteve ne strukturat teatrale si dhe angazhimin e tyre ne trupat e institucionit.
- 1.6. Departamenti Kanto lidh marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore Rajonale te Tiranës ne kuadrin e praktikave mësimore te cikleve mësimore 9-vjcare dhe te mesëm.
- 1.7. Sezonet e provimeve dimër/verë janë mbajtur në përputhje me Rregulloren Mësimore të UART-së dhe duke respektuar datat e shpalluara nga Sekretaria Mësimore. Në përgjithësi sezonet e provimeve janë zhvilluar pa probleme. Gjithsesi vlen për tu vërejtur mungesa e korrektesës së disa pedagogëve me kohë të pjesshme, por ka edhe raste të atyre me kohë të

plotë, çka ka sjellë vonesa në mbylljen e procesverbaleve të provimeve sidomos në provimet e sezonit të verës.

1.8.Përgjatë vitit akademik 2021-22 ka vijuar implementimi i pjesëmarrjes te UART dhe FM në projektin Erasmus+. Konkretisht është aplikuar si partnerë në katër projekte Erasmus+.

1.8.1.Pjesëmarrja në Erasmus+ me lider Konservatorin “Giuseppe Tartini” Trieste (Itali), nënshkruar datë 06.01.2015, ka siguruar disa bursa semestrare studimi për studentët e FM në konservatorin e sipërpërmendur sikurse dhe dy bursa shkëmbimi mes stafëve akademike. Përzgjedhja e studentëve është kryer në përputhje me të gjitha procedurat e përcaktuara nga BE, duke ndërmarrë hap si më poshtë vijon:

- Njoftimi i studenteve është siguruar në sajë të shpalljes së thirrjes në faqen web të UART-së, por edhe duke sensibilizuar të gjithë pedagogët me kohë të plotë, të cilëve iu është nisur ndërkohë njoftimi nëpërmjet postës elektronike.
- Janë ngritur dy komisione, në rang Fakulteti për secilën fazë, të cilët, mbasi kanë marrë në shqyrtim kandidaturat dhe duke respektuar kriteret përzgjedhëse të programit Erasmus+, sikurse dhe duke marrë në konsideratë sugjerimet e Konservatorit “G. Tartini”, kanë shpallur fituesit.

Si rezultat i partneritetit të sipërpërmendur, nga Universiteti i Arteve Kristiansand, Norvegji ne vitin akademik 2018-2019 është pjese e programit Erasmus + ne Fakultetin e Muzikës dega Kanto studentja Mari Rikke Danielsen viti i pare Master

Ne vitin Akademik 2019-2020 marrëveshje ne kuadër te Erazmus + studentja Jasmine Deliler kryen studimet ne ciklin Master II dega Kanto.

Ne vitin 2021-2022 marrëveshje bashkëpunimi me Konservatorin G.Stanislav ne Cosenza - Itali ku Prof Antonio Frato zhvillon Masterclass ne kuadër te Erazmus + me departamentin Kanto.

1.8.2.Është aplikuar për pjesëmarrje në Erasmus+ me lider Konservatorin “Nicoló Paganini” Genova (Itali). Pjesëmarrja parashikonte shkëmbim studentësh dhe pedagogësh. Në përfundim të fazës përzgjedhëse projekti në fjalë nuk ka rezultuar fitues

2. Aktiviteti Artistik dhe Shkencor

Aktiviteti artistik i stafit akademik me kohë të plotë pranë Njësisë Bazë Kanto është zhvilluar në kuadër të *Stinës Koncertore të 2021/22* organizuar nga FM dhe/ose në aktivitete të tjera zhvilluar në partneritet me FM-në sikurse dhe falë iniciativës individuale të vete pedagogëve. Më poshtë po listojmë disa prej tyre:

- a. Koncert i FM 60 Vjet Fakulteti i Muzikës Departamenti Kanto me pjesëmarrjen e Pedagoqeve dhe studenteve te klasave përkatëse
- b. Koncert Recital për Soprano dhe Harpe 20.04.2021 Soprano Ulpiana Aliaj, Harpe Antonio Ostuni
- c. Koncert i Klasës se Kantos se Ped Eriona Gjyzeli ne kuadër te 60 vjet FM zhvilluar ne ambientet e Universitetit te Arteve për tu zhvendosur me pas ne qytete te tjera te vendit si ne Berat, Shkodër, Kruje. Qëllimi i bashkëpunimit dhe implementimit te edukimit artistik nëpërmjet bashkëpunimit me shkolla te mesme te muzikës te cilat shihen ne vijim si një forme rekrutimi për studentët e UART.
- d. “ Zërat e se Ardhmes “ bashkëpunim i Pedagoqeve: As. Prof Dr Kastriot Tusha, Lek Josif Gjipali, Lek Manjola Nallbani, Lek Ardita Meni ne bashkëpunim me student te klasave përkatëse zhvillojnë Koncert ne kuadër te 60 Vjet UART
- e. Koncert Recital Aa/Lek Manjola Nallbani ne Pallatin e Brigadave me 21.06.2022
- f. “ Epistolat Muzikore “dedikuar rrugëtimit te shkollës se kantos. Koncert i klasës se Ped Nereida Fico ne bashkëpunim me studentet e klasës se saje te Kantos realizuar me 20.05.2022
- g. Koncert i klasës se Prof Suzana Frashëri ne bashkëpunim me student te Kantos me 23.05.2022

- h. “Këngë popullore te vjetra te përpunuara për zë dhe piano nga pianistja e pare Shqiptare Lola Gjoka” realizuar si album dhe prezantuar me 7.05.2022 ne bashkëpunim me As/Lek Mariana Leka.
- i. As/Lek Ardita Meni koncerte bashkëpunimi ne 60 Vjet UART ku angazhohet me pjesëmarrje te ndryshme ne disa aktivitete si vetëm apo dhe e angazhuar me student te saje.
- j. As.Prof.Dr Kastriot Tusha koncerte te ndryshem zhvilluar ne ambientet e UART, ne Tirane, Shqipëri dhe jashtë saj ne një hark kohor te vazhdueshëm.
- k. As/Lek Josif Gjipali interpreton role ne Opra “Un Ballo in maschera”,”Rigoletto”, “Il Trovatore” ne teatrot Magio Musicale Fiorentino, Comunale di Bologna, etj.
- l. As/Lek Ulpiana Aliaj interpreton role ne Opera “Viva la Diva”, “Le Nozze di Figaro”, “Ivan IV” ne Tetarot : Salzburg Stadtheter, Stadtheater Leipzog, OperaMontpellier, etj.
- m. Ne kuadër te Tirana Youth Capital mbështetur nga Universiteti i Arteve dhe Bashkia Tirane organizohet event i mbajtur me 10 dhe 11.06.2022 ne ambientet e Parkut Rinia dhe Kalaja e Tiranës. Organizuar nga Ped Nereida Fico ne bashkëpunim me studente te klasave te Kantos.
- n. Ne kuadër te 60 Vjetorit te UART realizohen operat: “Mrika”, “Dido dhe Enea” si dhe koncert i klasës korale ne drejtimin e Ped Suzana Turku si dhe koncerte te Ansambllit Vokal drejtuar nga Ped Bujar Alliu me pjesëmarrjen e gjere te studenteve te katedrës Kanto.
- o. CD “Arie Antike te Zgjedura” realizuar nga Prof Suzana Frasheri ne piano Elvis Peci mbështetur nga Bashkia Tirane me 14.01.2022

Raporti vjetor i kryetarit të degës të Fakultetit të Muzikës 2021-2022

Kryetarja e Degës në Fakultetit të Muzikës, në bashkëpunim e koordinimin edhe me strukturat e tjera në Rektorat edhe në Fakultet ka qenë e angazhuar të realizojë çdo detyrë administrative sipas detyrave funksionale si dhe ato të punëve operative ditore dhe vjetore.

Në zbatim të planit vjetor të punës dhe të detyrave funksionale të postit të punës kam udhëhequr punën dhe kam përgatitur; a) Projekt-Buxhetin (pjesën e shpenzimeve operative dhe investimet), b) bashkëpunim për përgatitjen e orarit vjetor të programit mësimor, c) dokumentacionin ditor për shërbime dhe mirëmbajtje, d) dokumentacionin ditor për listprezencën, e) çdo dokumentacion tjetër të kërkuar nga Administratorja e UART.

Së bashku me punonjësit në varësi, specialistët dhe laborantët mësimore kemi mbajtur në gjendje pune ambientet mësimore dhe infrastrukturën mbështetëse. Në sezonin e verës janë mbikëqyrur punimet për mirëmbajtjen ambienteve duke siguruar mbarëvajtjen e punës dhe çdo nevojë tjetër. së bashku me Përgjegjësën e Instrumenteve muzikore është kryer kontrolli periodik i pianove akordimi dhe riparimi i tyre .Çdo ditë kemi garantuar shërbimet e tjera, kontroll të rrjetit elektrik, hidraulik si dhe higjenizimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve.

gjatë periudhës së vitit akademik 2021 - 2022, janë realizuar detyrat sipas planit-vjetor të punës Disa nga përgjegjësitë kryesore, që kam realizuar janë:

1. Planifikimi ditor i planit të punës për: Laborantët dhe Sanitarët. Kryetarja e Degës është në kontakt të përditshëm me laborantët dhe sanitarët mbi planin ditor të punës. Kontakti fillestar ndodh në fillim të ditës mbi pikat kryesore të planit si :kontrolli i ambienteve të mësimit, provimeve, koncerte, konkurse dhe master-class që mund të jenë planifikuar për ditën në vijim. Më pas komunikimet në vijim kryhen për të përshtatur mbi çdo punë të papritur dhe të nevojshme siç mund të jenë: ndryshimet në orar, akomodimi i studenteve në ambientet përkatëse dhe në rast ndryshimesh bëhet njoftimi i studentëve dhe stafit akademik .Sanitaret kanë bërë pastrimin e ambienteve të mësimit përpara fillimit të procesit mësimor për secilin grup. Janë pastruar tavolinat, karriget, dorezat e dyerve, kompjuterëve etj. dhe ajrosja e ambienteve . Laborantët kanë menaxhuar zhvillimin e procesit mësimorë në grupe të vogla duke mos lejuar përplasje oraresh.

.Në fund të ditës bëhet një rikomunikim i të gjitha detyrave të kryera dhe planit pasardhës.

2. Planifikimi ditor i planit të punës për Përgjegjësin e Instrumenteve Muzikore dhe kontakti në fund të ditës për plotësimin e dokumentacionit Teknik.

Gjatë vitit shkollor 2021-2022 në Fakultetin e Muzikës janë bërë ndërhyrje në piano si dhe në të gjithë instrumentet muzikore të varur nga magazina e UART .Nga laboratorit i veglave muzikore për vitin akademik 2022 janë bërë këto akordime dhe riparime ;

- 1) Akordime mbi 500 copë
- 2) Ndërrim tela çeliku 1094 copë
- 3) Ndërrim tela basi 106 copë
- 4) Mekanizma 65 copë
- 5) Çekiçë 80 copë
- 6) Sordina 70 copë
- 7) Riparime kapitale 4 copë
- 8) Stof i kuq 330 cm
- 9) Stof jeshil 280 cm
- 10) Akse 765 copë
- 11) Kapsolla 90 copë
- 12) Centrim nivelime 80 copë Piano
- 13) Riparime tastiere –pedale
- 14) Riparime Bassi 12 copë
- 15) Riparime fizarmonikë 8 copë

Gjithashtu gjatë periudhës së festimeve të 60 vjetorit të Fakultetit të Muzikës janë bërë akordime të përditshme të pianos që ndodhet në hollin kryesor të FM-së.

3. Lidhja e kontratave me studentët dhe pedagogët për instrumentet muzikor.

Takim me sekretarinë mësimore të FAS: Ema Gurra dhe Merita Bega.

Takim me përfaqësues të Sektorit mësimor & Kurrikulës, Informimit të studentëve Këshillimit të Karrierës Alumni: Suela Kromidha, Edlira Isak, Jona Kasimati, Prof. dr. Erald Bakalli.

Takim me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të cilësisë: Prof. dr. Erald Bakalli, Prof. Arian Paco, Prof. as. Alert Celoaliaj, Prof. as. Dorian Cene, Dr. Ermir Hoxha, Suela Kromidha, Edlira Isak dhe Jona Kasimati.

Takim me përfaqësues të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore: Elia Plaku.

Takim me përfaqësues të Sektorit të Projekteve Artistike & Shkencore: Prof. Pjetër Guralumi dhe Prof. dr. Erald Bakalli.

Vëzhgim mjediseve (auditorëve, laboratorëve dhe shërbimeve për studentë). Vizitë në bibliotekën e UART: Grupet e Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), Koordinatori Teknik ASCAL (KT), Kordinatori institucional (KI), Grupi shoqërues i FAS, Enela Mastori.

Biblioteka UART: Miranda Bakiasi.

Gjatë takimeve u shkëmbyen mendime, u sqaruan çështje dhe të gjithë u larguan më të informuar në lidhje me këtë proces kaq të rëndësishëm për institucionin. Takimet u përmbyllën më një vizitë në të gjitha ambjentët që Fakulteti i Artit Skenik ofron.

Takim përmbyllës: Prof. Petrit Malaj, Prof. as. Taulant Pustina, Prof. Ilir Martini, Prof. dr. Erald Bakalli.

Ekspertët, gjatë ditëve në vijim shprehën konsiderata mjaft positive për materialet e paraqitura nga GVB dhe presim të paraqesin draftin dhe raportin final për akreditimin e pesë programeve të studimit në FAS, ndërkohë që UART vazhdon përgatitjet për kryerjen e takimeve të radhës për programet e tjera të studimit të ciklit të dytë.

b. **HARTIMIN E SYLLABUSEVE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT.**

Gjatë këtij viti akademik me porosi të Dekanit të FAS prof. Petrit Malaj dhe nën drejtimin e zv. Dekanit prof. Ilir Martini është bërë e realizueshme dhe materializuar duke u mbështetur në legjislacionin aktual të Ligjit të Arsimit të IAL dhe udhëzimeve përkatëse, për rishikimim, përshtatjen dhe mirë hartimin e të gjitha syllabuseve të të pesë programeve të ciklit të dytë të studimit, master në arte në Fakultetin e Artit Skenik.

Ky material u realizua me cilësi të lartë profesionale dhe kryesisht nga stafi akademik i lëndëve artistike, i mbështetur edhe nga ato të lëndëve teorike. Vlen të përmenden mbështetësit dhe

punës së palodhur të prof. Alfred Trebicka, Prof. as. Alert Çeloaliaj, prof. Ilir Martini, prof.as. dr. Gjergj Prevazi, prof. as. Dr. Elida Rapti etj.

I gjithë ky material ishin në shërbim të procesit të akreditimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë master në arte pranë FAS.

U realizuan syllabuset si më poshtë:

Programi i ciklit të dytë të studimit master në Aktrim dhe Mësuesi.

Programi i ciklit të dytë të studimit master në Regji Teatri dhe Spektakli dhe Mësuesi.

Programi i ciklit të dytë të studimit master në Skenografi dhe Kostumografi dhe Mësuesi.

Programi i ciklit të dytë të studimit master në Regji Filmi dhe Televizioni dhe Mësuesi.

Programi i ciklit të dytë të studimit master në Koreografi dhe Mësuesi.

U rishikuan planet mësimore të të pestë programeve të studimit në fakultetin tonë. Tashmë planet mësimore janë të konsoliduara. Rëndësi i është kushtuar në këtë periudhë planifikimit të angazhimit me ngarkesë mësimore të personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm, duke i dhënë prioritet atij të brendshëm.

Njëherësh, nga anëtarët e personelit akademik të brendshëm janë riparë dhe rikonceptuar programet e lëndëve, për t'ju përgjigjur sa më mirë kërkesave bashkëkohore të procesit të mësimdhënies dhe me orientimin drejt tregut të punës.

Programet e studimeve janë përmirësuar sipas strukturave dhe kërkesave specifike në varësi të departamenteve, në formën e diskutimit dhe të reflektimit të zhvillimeve më të fundit, duke marrë si bazë rezultatin e vlerësimit të vitit të kaluar akademik.

Ndryshimet dhe përmirësimet e programeve të studimit, janë bërë në funksion të rritjes së cilësisë dhe në përputhje me Rregulloret Mësimore të dy cikleve të studimit me kohë të plotë Bachelor, Master i Arteve të të gjitha programeve të studimit të FAS, Statusit të veçantë të UART si dhe Statutit të UART.

Në kuadër të zbatimit të planeve e programeve të studimit si dhe rëndësinë e lëndëve profesionale artistike për formimin e përgjithshëm e specifik të studentëve, në të gjitha vitet e studimit në departamentet Aktrim – Teori, Regji dhe Regji Filmi & TV, Skenografi-Kostumografi dhe Koreografi, jemi përpjekur të rrisin nivelin e mësimdhënies dhe të përvetësimit të të gjithë elementëve profesionale artistike në to; ndonëse përvetësimi i tyre është një proces i gjatë e në vazhdimësi që kërkon rritje të nivelit të njohurive e shprehive të secilës fushë specifike, për të arritur rezultate optimale të matshme e të krahasueshme me studente të universiteteve të tjerë rajonal dhe më gjërë, përmes një sistemi të ekualivalentimit të vlerave e krediteve.

Edhe gjatë vitit akademik 2021-2022 është vënë re rritje dhe interes i studenteve për lëndët speciale artistike. Në anën tjetër, duhet që këtij interesi e kërkesave në rritje, t'u përgjigjemi edhe me një impenjim e angazhim më të madh të stafit tonë mësimdhënës si dhe një bazë laboratorike të studiove dhe atelieeve për të krijuar një infrastrukturë për të sjellë një vlera më të lartë cilësore në realizimin e projekteve artistike.

Objektivat e programeve të studimit në Fakultetin e Artit Skenik kanë patur në qendër të vëmendjes, pajisjen dhe zhvillimin e një procesi kreativ me studentët mbi njohuritë krijuese e kërkimore për artin skenik, por çka është më e rëndësishmja me realizimin konkret të punëve krijuese në provime e projekte artistike.

Një moment shumë i rëndësishëm i Fakultetit të Artit Skenik janë:

realizimi i detyrave të lëndëve speciale artistike si projekte artistike dhe shkencore.

Fakulteti i Artit Skenik si pjesë e Universitetit të Arteve, është unik dhe shumë i rëndësishëm në drejtimin arsimor, artistik e krijues në Shqipëri dhe i vetmi që ofron diplomë universitare të ciklit të parë e të dytë në fushën e arteve skenike dhe në kinematografi. Ky fakultet ka mbuluar dhe kualifikimin shkencor të artistëve të diplomuar dhe merr pjesë në jetën krijuese me krijimtari të mirëfilltë artistike, jo vetëm me trupat e saj tradicionale, por edhe me projekte të studentëve, pedagogëve, bashkëpunëtorëve të brendshëm e të jashtëm. Profesorati mësimdhënës dhe ai i mjeshtërive që ka Fakulteti i Artit Skenik ka emra të mirënjohur të jetës skenike si: regjisorë, aktorë, skenografë, kostumografë, koreografë dhe regjisorë filmi.

Proçesi i mësimdhënies në këtë institucion është shkruar me atë të përformimit artistik. Pranë Fakultetit tonë kanë funksionuar dhe akoma funksionojnë trupa e teatrit, bashkëpunimi në projekte artistike pedagog-student si dhe grupe të pavarura studentësh e pedagogësh në projektet e pedagogëve të koreografisë.

Ne do të vazhdojmë të këmbëngulim për një mbështetje të posaçme nga shteti në mënyrë që, duke u siguruar kjo mbështetje e merituar financiare ndaj këtyre trupave të gatshme artistike, të mundësohet jo vetëm shpërfaqja e vlerave të këtij potenciali të fuqishëm talentesh njerëzore që Fakulteti i Artit Skenik zotëron, një potencial i përbashkët i studentëve dhe i pedagogëve, por për shumë më tepër: në dobi të jetës skenike të Tiranës e më gjerë.

Ne sigurojmë se kostoja e një projekti artistik tek ne është shumë herë më e vogël se e një projekti që vihet në skenë në çfarëdo institucioni tjetër, sepse shumë veprimtari me nivel cilësor mbeten të mbyllura brenda mureve të saj dhe arkivohen si punë kursesh a diplomash, si mbrojtje gradash a titujsh, megjithëse meritojnë një komunikim publik të gjerë. Çdo buxhet i dhënë për këtë qëllim do të rikthehet në publik me një vlerë shumë më të lartë dhe me një kosto pa dyshim më të ulët. Këto projekte do të kenë impakt të jashtëzakonshëm tek studentët e talentuar që aktualisht studiojnë në Fakultetin e Artit Skenik, por edhe për të gjithë ata të tjerë që kanë mbaruar studimet në institucionin tonë dhe për nga vlerat që kanë shpërfaqur meritojnë të jenë bashkëpunëtorë në këto projekte. Kjo na inkurajon që në zërin e buxhetit ne të kërkojmë të administrojmë më shumë fonde për projekte të mirëfillta artistike. Ato do bëjnë të mundur realizimin e një prej qëllimeve kryesore e pikërisht kontaktin e lidhjen e domosdoshme të studentëve me tregun, me vetë spektatorin.

Ajo çka është më e rëndësishme në këtë proçes është të kuptuarit konkret nga ana e stafit pedagogjik dhe atij studentor, që puna konkrete në fakultet dhe në secilin program studimi matet me produksionin artistik në fund të çdo sezoni provimi gjatë vitit akademik mësimor.

Vlerat konkrete të shkollës sonë artistike mbështeten në realizimet më cilësore të projekteve artistike të cilat janë produksione artistike të kryera nga fakulteti në bashkëpunim me rektoratin e një sërë institucioneve artistike në Tiranë dhe në rrethe. Për të realizuar këto produksione janë shfrytëzuar në maksimum kapacitetet e sallave të UART Black-box i madh dhe i vogël, Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar Eksperimental, Teatri Metropol, sheshet e xhirimeve të filmave artistike, etj.

Po ashtu disa projekte të studentëve dhe pedagogëve u shpërfaqën cilësisht dhe në rrethe etj., të cilat janë në raporte dashamirësie harmonike me institucionin tonë.

Numri i produksioneve artistike, të shfaqura si provime etydeshe dhe projekteve skenike e filmike dhe koreografike arrin mesatarisht në rreth mbi gjashtëdhjetë të tilla, në sezonet e provimeve gjatë një viti akademik. Studentet tanë në specialitetet e tyre janë gjithashtu pjesëmarrës aktive edhe në aktivitete lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Konkurset e pranimit në FAS në dy ciklet e studimit për vitin akademik 2021-2022, janë zhvilluar përkatësisht sipas rregullave dhe udhëzimeve përkatëse. Janë zbatuar gjithë udhëzimet e MAS. Stafi pedagogjik, anëtarët e komisioneve të pranimit në konkurse dhe personeli ndihmës administrativ ka punuar me përgjegjësi për mbarëvajtjen e tij. Komisionet përzgjedhëse të programeve të studimeve kanë bërë përpjekjet e duhura profesionale për të seleksionuar vlerat më të mira të shfaqura nga kandidatët konkurentë.

Në kuadër të dokumentit “Pakti i Studentëve” hartuar në zbatim dokumentit të Qeverisë Shqiptare dhe Ministrive të Linjës, kemi krijuar marrëveshje dhe veçanërisht Fakulteti i Artit Skenik si më poshtë vijon:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor, Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, Galerisë Kombëtare të Arteve, Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave, Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Instituti Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Ministrisë së Kulturës dhe Universitetit të Arteve. Për implementimin e dokumentit “Pakti për Universitetin”

Qëllimi i kësaj marrëveshje është krijimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet këtyre institucioneve kulturore artistike, MK dhe UA. Objekti i rregullimit të marrëveshjeve është përcaktimi i detyrimeve respektive të palëve. Universiteti i Arteve do të përcaktojë koordinatorin institucional që do të angazhohet në përzgjedhjen, bashkëpunimin dhe koordinimin e studentëve pjesëmarrës në programet e KTOBAS-së. Të përfshijë studentët e UART, degët Regji, skenografi, koreografi, me aktivitetin e tyre konkrete dhe konkursin “YOUTH THEATRE”, si fazë e parë e krijimit të akademisë së Operas nga moshë 17-25 vjeç për sezonet e kalendarëve artistike.

Universiteti i Arteve do të përzgjedhë çdo vit akademik studentë të interesuar për intership pranë AQSHF.

Fakulteti i Artit Skenik dhe UART në vazhdimësi të procesit mësimor përzgjedhë çdo vit akademik që mbrojtjet e diplomave të planifikohen të shfaqen në sallën e teatrove si dhe shkëmbim të stafëve midis institucioneve. Realizimin e workshope-ve. QKKF, njëherësh do të krijojë hapësira për diplomat e skenografisë, regjisë, aktrimit, koreografisë dhe filmit, etj.

Organizimin e praktikave të studentëve në galeri, si vëzhgues, mirëmbajtës, si edukator për fëmijë, nxënës, student dhe përfshirjen e tyre në projektet e galerisë, por edhe në kuadrin e përvetësimit të praktikave mësimore të studentëve të ciklit të dytë në FAS.

Kemi filluar të angazhohemi për thirrje dhe njoftime të TKE, KS, etj. ndaj studentëve dhe stafit akademik. UART, do të përzgjedhë për çdo vit akademik, shfaqje për mbrojtje diplome, shfaqjet do të jepen në sallën e TKEKS, në kalendar. TKEKS, ka detyrime të shkëmbimeve të njohurive, stafit dhe infrastrukturës. Shkëmbime përvoje sipas rastit, shkëmbime materialeve studimore, botime, shkëmbim të stafit dhe eksperteve. Për zhvillimin e shfaqjeve, leksioneve, trajnimeve. Pjesëmarrës në produksionet teatrore të TKEKS, aktivitete prezantuese dhe promovuese, bashkëbisedime me studentët, dhënies së lejes për përdorimin hapësirave për përdorimin e ambienteve, për workshope, rekuizitës, kostumeve, dekorit etj.

Po ashtu jemi angazhuar dhe për t’ju përgjigjur thirrjeve dhe njoftimeve të TK, duke përcjellë të gjitha informacionet te studentët e FAS. Universiteti do të përzgjedhë për çdo vit akademik dy shfaqje të mira për mbrojtje diplome. TK do të ofrojë stazh dhe praktika për studentët në

Festivalin e shkollave të mesme TR-RIN ART. Të afrojë stazh dhe praktika për studentët në shfaqjet e ardhshme duke qenë produksione të TK, si regjisor, kostumograf, skenograf, si asistencë. Dhënies së ambienteve sipas mundësive, të rekuizitës, dekorit dhe kostumeve për qëllime akademike dhe për shfaqje diplome. Të garantojnë pjesëmarrjen e studentëve në Forumet e Debatit, për shfaqje që janë produksione të TK, dhe workshope me personalitete ndërkombëtare në fushën e Arteve Skenike. Etj.

Kemi filluar angazhimin për implementimin e tyre si:

1. Stazhe dhe praktika për studentët tanë në Festivalin teatror të shkollave të mesme **TK-RIN ART**
2. Stazhe dhe praktika në sektorin skenografi, kostumografi dhe as. regji për secilën shfaqje të zhvilluar në kuadër të **TK-RIN ART**.
3. Stazhe dhe praktika si as. Regji, as. Kostumograf, as. Skenograf, në shfaqjet e ardhshme që do të jenë produksione të Teatrit Kombëtar.
4. Audicione në shfaqjet e Teatrit Kombëtar
5. Çeljen e **Ateliesë të të rinjve** në skenë e re arTurbina e cila do të mirëpresë dhe promovojë studentët e tanë.
6. Përzgjedhja në bazë të një konkursi të shfaqjeve të artistëve të rinj, për të qënë pjesë e Kalendarit Artistik të Teatrit Kombëtar.
7. Mirëpritja e shfaqjeve më të mira të diplomave të studentëve për tu shfaqur në Skenën e Re arTurbina.
8. Bashkëpunim i ngushtë me Universitetin e Arteve dhe pjesëmarrjen e studentëve në Forumet e Debatit për shfaqjet që janë produksion i TK.

Mbështetur në këto marrëveshje, për këtë vit akademik 2021-2022, u zhvilluan aktivitete artistike të përbashkëta të cilat pasqyrohen në veprimtarinë vjetore të çdo departamenti që do pasqyrojmë më poshtë.

INFORMACION MBI REALIZIMIN E QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË MËSIMDHËNIES, TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE VEPRIMTARIVE KRIJUESE DHE INOVACIONIT sipas udhëzimeve përkatëse të ardhura nga institucioni epror:

- a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.
- b) Informacion mbi bashkëpunime ndër-institucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.
- c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:
 - i) politikat e kërkimit shkencor;
 - ii) të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien;
 - iii) produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësi bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;

- iv) të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor.
- d) Të dhëna mbi programet e studimit.

- i) IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar.
- ii) IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në process vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.

U miratua hapja e shkollës së ciklit të tretë të studimit në doktorate.

Fakulteti vendosi të emërtojë doktoraturën “Doktoraturë në Artet Skenike”. Departamenti Regji-Regji Filmi dhe Televizioni, do të jetë mbikëqyrësi i këtij program të ciklit të tretë të studimit në FAS.

Programi “Doktoraturës në Arte Skenike” synon të zhvillojë aftësitë artistike, të gjenerojë njohuri të reja dhe të avancojë kërkimet në fushën e artit. Ai mundëson që studentët e regjistruar në këtë program të zhvillohen profesionalisht jo vetëm si artistë por edhe si studiues, duke zgjeruar kompetencat artistike dhe aftësitë për të krijuar dhe mësuar njohuri të reja si dhe duke zbatuar metoda artistike inovative në aktivitetin e tyre profesional në fushën e artit.

Fokusi i programit Doktoraturës bazohet tek puna kërkimore shkencore dhe krijuese. Ajo fokusohet dhe ndërton strukturën e saj duke u mbështetur mbi aspektet e hulumtimit dhe analizave të koncepteve krijuese si dhe aspektit artistik të tyre në specifikën e aktrimit, regjisë, regjisë së filmit dhe televizionit, skenografisë, kostumografisë dhe koreografisë. Shtrirja e këtyre projekteve studimore lidhet me problematikat e artit specifik që është shfaqur në shekullin e 20-të, në vendin tonë dhe në botë.

Misioni i këtij programi doktorature është të formojë studiues me integritet të lartë profesional, kulturor, qytetar dhe promovues të rolit që ka arti skenik në edukimin e shoqërisë shqiptare

Qëllimi i këtij programi doktorature është të përgatisë studiues me njohuri teorike dhe të aftë për të bërë hulumtime dhe analiza krahasuese në fushën e artit dhe specifikat e studentit.

Programi i doktoraturës i përmbahet si parimeve të Salzburgut të vitit 2005, ku u hodhën themelet për diskutimin e edukimit të doktoraturës si pjesë e procesit të Bolonjës, por dhe parimeve të takimit të Salzburgut II të vitit 2010 që identifikoi disa parime për diplomën e ciklit të tretë të studimeve të fokusuar në:

- *programi doktoral si avancim i njohurive përmes hulumtimit fillestar;*
- *përfshirja e programit doktoral në strategjitë dhe politikat institucionale;*
- *rëndësia e diversitetit;*
- *identiteti i kandidatëve të doktoraturës si hulumtues të hershëm;*
- *roli vendimtar i udhëheqësit shkencor dhe vlerësuesit;*
- *arritja e një mase kritike si një qëllim i rëndësishëm i programeve të doktoratës;*
- *kohëzgjatje e programit studimit prej tri deri në katër vjet;*
- *promovimi i strukturave inovative;*
- *rëndësia e mobilitetit për kërkuesit e doktoraturës;*
- *gjetja financimit për kandidatët e doktoraturës;*

Në këtë kuadër edhe Programi i Doktoraturës në Fakultetin e Artit Skenik pranë Universitetit të Arteve është hapur nga nevoja për të drejtuar teorikisht edhe shndërrimin dhe rolin e arteve skenike në një "obsion të dijes", për t'u bërë fokusi i një konteksi kërkimor me orientim ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, kushtet e nevojshme për të vetë njohur krijimtarinë artistike,

përbëjnë një objekt të hulumtimit bazë, të kombinuar ndërmjet veprimtarive akademike, krijuese e artistike.

Programi Doktoraturës në Fakultetin e Artit Skenik, pranë Universitetit të Arteve do të kthehet në një program të fokusuar në kërkime shkencore të kombinuara, akademike dhe artistike të specialiteteve skenografi, kostumografi, koreografi, aktrim, regji, regji filmi, menaxhim dhe teori arti, aq të munguara në fushën e studimeve shqiptare.

Këtij serioziteti të institucionit tonë si dhe përkushtimit të anëtarëve të personelit akademik të secilit program studimi ku në të ishin angazhuar të gjitha strukturat e UART me një protokoll model nga ana jonë, më në fund i erdhi përgjigja që tashmë i hap rrugë këtij procesi dhe po vazhdon plotësimi i dokumentacioneve dhe jemi në ecurinë e duhur.

Tashmë është shpallur konkursi i pranimit në këtë program të ciklit të tretë të studimit Doktoraturë në Arte Skenike. Jemi në procesin e fillimit të shkollës së doktoraturës në FAS.

DEPARTAMENTI SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI & KOREOGRAFI

6. Programet e studimit

Departamenti Skenografi& Kostumografi dhe Koreografi është pjesë e FAS të UART.

Programet e studimit që ka realizuar Departamenti përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 janë:

PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË NË BACHELOR:

1. “SKENOGRAFI DHE KOSTUMOGRAFI”
2. “KOREOGRAFI”

PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NË MASTER:

1. “SKENOGRAFI DHE KOSTUMOGRAFI DHE MËSUESI”
2. “KOREOGRAFI DHE MËSUESI”

Departamenti SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE KOREOGRAFI, është një ndër tre departamentet e Fakulteti të Artit Skenik, të UART. Gjatë vitit akademik 2021-2022 ka bërë përpjekje serioze për të përmbushur misionin e tij për edukimin artistik dhe profesional të studentëve.

Puna e departamentit është fokusuar përgjatë këtij viti akademik tek rritja e standarteve të mësimdhënies dhe realizimin cilësor të projekteve artistike.

Misioni i Departamentit është realizuar duke përmbushur disa objektiva përgjatë këtij viti akademik. Këto objektiva kanë qenë në shërbim të rritjes së nivelit të mësimdhënies dhe të rritjes të formimit artistik të studentëve, nëpërmjet përfshirjes së tyre në veprimtaritë artistike të realizuar nga stafi akademik i departamentit.

Objektivi kryesor i Departamentit përgjatë vitit akademik 2021 – 2022 ka qenë shprehja e statusit të departamentit si bërthama më cilësore në përgatitjen e edukimit artistik të studentëve

Departamenti SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE KOREOGRAFI edhe në vitin shkollor 2021 -2022 është mbështetur në ndjekjen e arritjes së objektivave që departamenti ka inicuar në fushën e mësimdhënies dhe në veprimtarinë krijuese artistike. Departamenti ka pasur si objektiva kryesorë:

- Rritjen e standarteve të mësimdhënies dhe kualifikimit artistik të studentëve të programit të studimit SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE KOREOGRAFI. Realizimin e trajnimit të mësuesve të fushës së artit në sistemin parauniversitar
- Promovimin e vlerave profesionale të studentëve nëpërmjet aktiviteteve artistike si dhe orientimin e tyre drejt tregut të punës në fushën e punësimit.
- Rritja e aftësisë menaxheriale për orientimin e karrierës së studentëve drejt fushës së specialitetit dhe mësuesisë së fushës së artit.

1. Procesi mësimor në Departamentin SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI dhe KOREOGRAFI gjatë vitit shkollor 2021 - 2022

Departamenti SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI dhe KOREOGRAFI ka bërë përpjekje për të realizuar me përgjegjësi procesin mësimor gjatë vitit akademik 2021 – 2022.

Departamenti e ka fokusuar realizimin e procesit mësimor nëpërmjet përdorimit të teknikave bashkëkohore të mësimdhënies si në bllokun e lëndëve profesionale artistike ashtu dhe në bllokun e lëndëve teorike, mbështetur në eksperiencën më të mirë. Programet e studimit në këtë departamentin janë bazuar në rregulloret përkatëse të cilat kanë evidentuar rregulla të qarta në realizimin e programeve.

Departamenti SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI dhe KOREOGRAFI ka punuar, bazuar në standartet e vendosura nga VKM-të si dhe Udhëzimet e MAS-it për reformimin e moduleve të lëndëve si në programin Bachelor dhe në programin Master për të realizuar procesin e Akreditimit të këtyre programeve dhe për ti paraprirë fillim të vitit shkollor 2022-2023. Departamenti realizoi me sukses Raportin e vlerësimit të Brendshëm dhe përgatiti dokumentacionin përkatës me mjaft përgjegjësi profesionale për këto programe në bazë të afateve kohore të vendosura.

Departamenti ka organizuar planet mësimore të dy programeve të studimit në Bachelor dhe Master të organizuar sipas Udhëzimeve përkatëse të MASR.

Plani mësimor Bachelor në Programin e Studimit SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI dhe Programin e Studimit KOREOGRAFI realizohet në tri vite akademike dhe përmban 180 kredite.

Plani mësimor Master në Programin e Studimit SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE MËSUESI dhe Programin e Studimit Master në KOREOGRAFI DHE MËSUESI, realizohet në dy vite akademike dhe përmban 120 kredite.

Analiza strukturore e planeve mësimor të programeve të studimit të departamentit është konform kërkesave që kanë udhëzimet e MASR, duke shprehur si orët mësimore në auditor dhe orët mësimore jashtë auditorit. Raporti i tyre është sipas kërkesave të lejuara për hartimin e planit mësimor të programeve të studimit. Është realizuar në vazhdimësi rifreskimi i syllabuseve të lëndëve mësimore duke futur literaturë bashkëkohore dhe duke uniformizuar paraqitjen grafike të tyre. Departamenti punën përgatitore për rishikimin e syllabuseve e ka realizuar që në fillim të vitit shkollor 2021 – 2022.

Në programin e studimit të ciklit të parë në Skenografi-Kostumografi, duke u mbështetur në ecurinë dhe kërkesat e tregut, vendosi dhe krijoi dy syllabuse të reja si Lënda: Patroni dhe

Lënda Interdesign. Këto ndryshime nuk prekin ngarkesën mësimore pasqyruar në Planin Mësimor të këtij programi.

Departamenti ka realizuar ndarjen e ngarkesës mësimore për vitin shkollor 2021 – 2022. Ndarja e ngarkesës mësimore është realizuar duke u nisur së pari nga kriteri përvojës profesionale që ka stafi i departamentit në fushën e mësimdhënies dhe së dyti nga kriteri i përgatitjes profesionale të stafit me karakteristikat që kanë kurikulat e programeve të studimit të departamentit.

Ngarkesa mësimore është realizuar sipas Udhëzimit të ardhur nga MASR dhe është konform legjislacionit të arsimit të lartë shqiptar. Ndarja e ngarkesës mësimore të departamentit ka parasysh edhe statusin e UART si IAL me status të veçantë në drejtim të organizimit të mësimdhënies.

Gjithashtu procesi ndarjes së ngarkesës ka pasur parasysh edhe mbingarkesën duke mos tejkaluar ngarkesën mbi 200 orë të ngarkesës mësimore shtesë në auditor. Gjithashtu ka vazhduar përpjekja për të reduktuar edhe numrin e personelit të ftuar, duke tentuar që Departamenti të mbulojë me staf të brendshëm mbi 90 % të ngarkesës së orëve mësimore të programeve të studimit.

Procesi i përzgjedhjes së pedagogëve të ftuar nga Departamenti për vitin shkollor 2021 – 2022 është realizuar me transparencë të plotë. Ky proces ka përfshirë së pari hapjen e periudhës së aplikimit për ngarkesat mësimore që duheshin për tu mbuluar me pedagogë të ftuar. Procesi përzgjedhjes ka vazhduar pastaj me konkurrimin në departament.

Stafi akademik me kohë të plotë i Departamentit ka bërë përpjekje serioze përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 për të realizuar një proces mësimor me standarte në mësimdhënie. Stafi akademik në lëndët e formimit profesional të studentëve ka shfaqur nivel profesional e didaktik në procesin e mësimdhënies së tyre. Kjo evidentohet nga fidbeku i dhënë nga studentët dhe drejtuesi i departamentit. Stafi ka bërë përpjekje për të realizuar mësimdhënie cilësore. Është synuar rritja e cilësisë së mësimdhënies në lëndët profesionale artistike, për rritjen e nivelit të formimit artistik të studentëve në programet e studimit të departamentit.

Ky evidentim vihet re në rritjen e efektshmerisë së punës mësimdhënëse të stafit të departamentit nëpërmjet përdorimit të metodologjive efektive të mësimdhënies dhe rritjes së motivimit të stafit akademik e studentëve. Ka vazhduar nga stafi akademik përpjekja për të realizuar një proces mësimdhënie sa më interaktiv dhe promovuar rritjen e aftësive krijuese e artistike të studentëve.

Edhe përgjatë këtij viti shkollor qëndron shqetësimi i vazhdueshëm i departamentit me mbështetjen me bazën materiale dhe didaktike të domosdoshme për realizimin e procesit mësimor. Kërkesa për laboratorin e kostumografisë e përsëritur për disa vite, është në proces për tu realizuar.

Ristrukturimi i programit Master ka mundur që studenti, krahas formimit të tij profesional e artistik, të përgatitet edhe si mësimdhënies në fushën e artit në arsimin parauniversitar. Departamenti ka punuar me seriozitet për të mundur rritjen e formimit didaktik të studentit në programin master. Programi studimit Master i Arteve ju ka krijuar mundësi studentëve që të orientohen më mirë në tregun e punës duke pasur më shumë mundësi punësimi jo vetëm si

profesionist në fushën e artit skenik por edhe si mësues në fushën e artit në sistemin shkollor parauniversitar.

Vlen të përmendet që i gjithë stafi ishte i angazhuar për të mbyllur me sukses provimet e sezoneve.

2. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe projektet artistike e shkencore

Departamenti përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 ka marrë pjesë me stafin e tij akademik në jetën krijuese me krijimtari të mirëfilltë artistike, pavarësisht situatës.

Aktiviteti artistik e krijues i Departamentit.

Programi i studimit Skenografi-Kostumografi:

Stafi akademik i këtij programi studimi përgjatë këtij viti akademik, kishte në qendër të punës së tij krijuese, pjesëmarrjen e studentëve në procesin krijues në skenë. Pedagogët kanë qenë aktiv në projektet artistike në bashkërendim me ato të studentëve. Një pjesë e projekteve u realizuan nëpër salla apo galeri.

Në lëndët artistike speciale si skenografi dhe kostumografi të kursin e parë janë realizuar projekt detyrat me motive nga antikiteti grek.

Ndërsa në kursin e dytë u realizuan projektet e skenografive dhe kostumografive sipas veprave të Molierit dhe Shekspirit.

Në vitin e tretë u realizuan me sukses diplomat në bachelor dhe tematika e tyre ishte mjaft e larmishme.

Studentët e këtij programi Sibora Maçellari, Xheni Qose dhe Gojart Kolldashi janë angazhuar nga MULTIMEDIASTUDIO, si asistentë skenograf dhe kostumografe në filmin artistik me metrazh të gjatë VDEKJA LË TË PRESË.

Rezultate të mira kishim edhe në studimin e masterit.

Realizimi i veprimtarive krijuese të stafit pedagogjik.

Aktiviteti i Prof. Ilir Martini:

Ekspozita **TIRANA DHJETOR 2021**, Portret Zadrinorja në Galerinë e Artit Tiranë, **Aktiviteti i Prof. as. Orion Shima:**

Ekspozita **personale me temë: KJO VJESHTË**, në Galerinë e Artit UART-Tiranë. Mars 2022.

Programi i Studimeve Koreografi:

Departamenti edhe gjatë vitit 2021– 2022 është angazhuar për realizimin e projekteve artistik si në mënyrë individuale nga pedagogët e departamentit ashtu dhe me produksione me studentët për të realizuar shfaqje në kuadër të diplomave, aktivitet artistike të programuar dhe projekt detyrat semestrale dhe vjetore.

Pedagogët kanë qenë aktiv në projektet artistike dhe në projektet artistike në bashkërendim me ato të studentëve. Një pjesë e projekteve u realizuan nëpër salla teatri, sheshe etj. U realizuan edhe projekte në bashkëpunim me sektorin e kulturës italiane, etj.

Aktiviteti i Prof. as. Dr. Gjergj Prevazi 2021-2022

23 Tetor 2021 koreografia dhe koncepti i shfaqjes

SHKUNDEM me Albanian DanceTheater Co. në Teatrin Eksperimental

3 Nëntor 2021 koreografia në produksionin teatror Bordell Ballkan nga Jeton Neziraj, me regji të Blerta Neziraj, në Teatrin Oda Prishtine.

02 Dhjetor koreografia dhe koncepti i shfaqjes Re-START me Balkan Dance Project, premierë në Kulturin Dom Velenje/ Slloveni

30 Dhjetor 2021 koreografia e produksionit teatror I'M MEFISTO, me regji të Dino Mustafić, në Teatrin Eksperimental.

10 Maj 2022 koreografia në produksionin teatror BURRNESHAT nga Jeton Neziraj, me regji të Erson Zymberi, me Qendrën Multimedia Prishtine/ Teatri Oda.

3 Qershor 2022 koreografia në produksionin teatror HANDKE PROJECT nga Jeton Neziraj, me regji të Blerta Neziraj, me Qendrën Multimedia Prishtine/ Teatri Oda.

8 Qershor 2022 koreografia në instalacionin FORMAT të artistit visual Ilir Kaso, në hollin e Ministrisë së Kulturës.

8 Korrik 2022 koreografia dhe koncepti i shfaqjes ANGELS & DEVILS me Bad Landeck Dance Company/ Ladek Zdroj / Poloni.

Me studentet e vitit të parë të Programit Master në Koreografi janë realizuar nga studentet këto tema:

-KAM FRIKE- (semestri i parë) një kërkim mbi temën e frikës, në atë se kujt i frikësohet më shumë e brezi i ri, prezantuar në sallën Black Box në 3 Mars 2022

- ME FALNI, JAM NË PROVA - (semestri i dytë) një kërkim mbi idenë e provës, si në nga fjalët kyçe jo vetëm në danc apo art, por është si je kërkim i kahershëm i njeriut për të eksploruar nëpërmjet të provuarit të gjithçka je rreth tij, prezantuar në Black Box dhe në Teatrin Skampa Elbasan në 27, 28 Qershor 2022.

- **Aktiviteti i Prof. as. Dr. Roberta Ndokaj:**

- Tokë ajër Bashkëpunim Teatri i Puiad dhe UA 31 Maj – 4 Qershor 2022 Amfiteatri i Tiranës

- Festivali folklorik internacional i dancit Edicioni i 14 me mbështetjen e Bashkisë Vlorë / 28-29-30 Maj Vlorë

- Summer Dance – Me rastin e hapjes së sezonit turistik. Me mbështetjen e Bashkisë Vlorë – 12 Maj 2022

- Let's Dance Together – Bashkia Vlorë & Qendra e artit dhe kulturës 1 Qershor 2022

- Festivali Letrar për të rinj – Tirana Gate Edicioni VII Performanca Koreografike. Instituti i Librit dhe Promocionit 8 -10 Tetor 2021 Tiranë

- Urban Sculptures projekt me platformën e Artit “Harabel” dhe tekstil & Mode FAB – 14 Korrik 2022

- Kolonia e piktorëve Erseka 2021 – Performanca Koreografike – Instituti i Librit dhe Promocionit. Qershor 2022

- Konferencë – Muzikologjia si pjesë e trashëgimisë popullore – 22 Mars 2022 – Tiranë – Albania University

- Rinia krijon kulturë – Tiranë – 4 Qershor 2022 publikime:

- Botim – Enciklopedia e Artit Shqiptar

- Akademia e Shkencave të Shqipërisë

- Mbi personalitetin e Artit

- Skënder Selimi (në proces pune)

- **Aktiviteti i Prof. as. Dr. Artan Ibërshimi:**

- Workshop presentation me kompaninë e dancit kontemporan DNA në bashkëpunimin me studentët e kursit III koreografi Bachelor, në hollin e Universitetit të Arteve në dt 28/05/2022.

- 2) Koreograf në spektaklin “Fluturojmë me shpirtin tënd” me Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore Shota, në sallën e Teatrit Kombëtar në Prishtinë, në 07/05/2022.

- 3) Koreograf i veprës koreografik “Qark e përçark me vallëzimin” në sallën e Teatrit “Skampa”, në 19/05/2022.

- 4) Koreograf i veprës “Fletët e pashkruara të një ditari”, shfaqur në auditorët e Fakultetit të Shkencave të Edukimit në Universitetin A. Xhuvani Elbasan, në kuadër të projektit “Muaji Mars, muaji i mësuesisë në FSHE” në 30/03/2022.

5) Organizator dhe drejtues artistik i festivalit “Albanian Dance Competition” Creativity and Interpretation, 24- 28/06/2022.

- 6) Bashkautor i botimit “Dako Shtuni, Dimensionet e një artisti të harruar që meriton më shumë” botuar nga shtëpia botuese “Rama Graf” shkurt 2022 dhe me ISBN:978-9928-4653-4-4.
- 7) Pjesëmarrës në “Skampa International Theater Festival” me veprën koreografike “Qark e përçark me vallëzimin”, Tetor 2022. 8) Pjesëmarrës në festivalin “Albanian Dance Competition” Creativity and Intarpretation, edicioni I, me veprën “Fletët e pashkrura të një ditari”, 24/06/2022.

6. Konkursset e pranimit

Procesi i organizimit të konkurseve të pranimit të studentëve në programet e Departamentit Skenografi-Kostumografi dhe Koreografi për përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 ka qenë një moment i rëndësishëm në procesin mësimor dhe organizativ të departamentit.

Procesi i konkurimit është zhvilluar me transparencë të plotë dhe është monitoruar me shumë vëmendje nga strukturat drejtuese të fakultetit si dhe nga vetë departamenti konform LAL 80/2015 dhe Statutit të UART. Procesi konkurimit ka zbatuar rregullat dhe udhëzimet përkatëse.

Edhe konkursi i zhvilluar për programin Master ishte i suksesshëm. Stafit departamentit organizoi procesin e përzgjedhjes së kandidatëve duke kombinuar aplikimin e tyre me dosje dhe me intervistimin e aplikantëve për të mundur zgjedhjen e më të talentuarve.

DEPARTAMENTI AKTRIM DHE TEORI:

1. Vizioni dhe objektivat e Departamentit Aktrim & Teori të FAS.

Departamenti Aktrim & Teori, është një ndër tri departamentet e Fakulteti të Artit Skenik, të UART. Ky departament, përgjatë vitit shkollor 2021- 2022, ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të përmbushur vizionin e tij kryesor në lidhje me edukimin artistik dhe profesional të studentëve. Vizioni i Departamentit Aktrim & Teori u fokusua përgjatë këtij viti shkollor, te përpjekjet e departamentit për të rritur standartet e procesit të mësimdhënies si dhe tek realizimi cilësor i projekteve artistike dhe shkencore në fushën e aktrimit. Vizioni i shpallur nga departamenti në fillim të vitit shkollor 2021-2022, u realizua nëpërmjet përmbushjes së objektivave që departamenti kishte përcaktuar me fillimin e vitit shkollor 2021-22. Objektivat e vendosura nga departamenti përgjatë këtij viti shkollor ishin në shërbim të rritjes së njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve. Ky trend në shërbim të rritjes së njohurive teorike e profesionale aktoriale të studentëve u realizua nëpërmjet rritjes së standarteve të mësimdhënies si dhe zhvillimit të formimit profesional dhe artistik të studentëve, nëpërmjet përfshirjes së tyre në veprimtaritë artistike që u realizuan nga stafi akademik i departamentit Aktrim & Teori .

Departamenti Aktrim dhe Teori për të përmbushur vizionin e tij, përcaktoi disa objektiva për tu arritur përgjatë vitit shkollor 2021 -2022 si në fushën e mësimdhënies dhe në fushën e veprimtarive artistike e shkencore. Departamenti Aktrim & Teori vendosi ndër objektivat kryesorë që vendosi për tu realizuar në këtë vit shkollor kanë qenë:

- Rritjen e standarteve të mësimdhënies dhe kualifikimit artistik të studentëve
- Realizimin e trajnimit të mësuesve të fushës së artit në sistemin parauniversitar
- Promovimi vlerave profesionale të studentëve të aktrimit nëpërmjet përfshirjes në aktivitete kulturore dhe artistike si dhe orientimin e tyre drejt tregut të punës në fushën e punësimit.

- Rritja e aftësive menaxheriale për orientimin e karrierës së studentëve drejt fushës së aktrimit dhe mësuesisë së fushës së artit.

Strategjia e Departamentit Aktrim për arritjen e këtyre objektivave përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 ishte orientuar drejt :

- rritjes së numrit të studentëve në programin aktrim nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të kapaciteteve akademike.
- përmirësimit të standarteve të mësimdhënies nëpërmjet zgjerimit të infrastrukturës artistike e krijuese
- pjesëmarrjes aktive të stafit akademik dhe studentëve në projekte artistike dhe shkencore
- rritjes së kontributit të stafit akademik në jetën artistike skenike të vendit
- hapjes së programit te doktoratës

Gjatë vitit shkollor 2021-22 mund të themi se objektivat kryesor të Departamentit, rritja e standarteve të mësimdhënies dhe kualifikimit artistik të studentëve të programit aktrim janë realizuar plotësisht. Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet rritjes së statusit të departamentit si bërthama më cilësore në përgatitjen e edukimit artistik të studentëve në fushën e aktrimit në Shqipëri dhe rritjes së ngarkesës së veprimtarisë krijuese dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të studentëve të degës së aktrimit. Ndërkohë një tjetër objektiv i rëndësishëm ka qenë edhe edukimi i studentëve si në drejtim të rritjes së tyre profesionale për të qenë aktorë të kualifikuar, por edhe në drejtim të qenies së tyre qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. Edhe ky objektiv është realizuar nëpërmjet implementimit të ndërthurjes së mësimdhënies cilësore me rritjen e aftësive krijuese e artistike të studentëve dhe pedagogëve, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në aktivitete kërkimore dhe realizimit të projekteve artistike. Ndërsa objektiv tjetër i rëndësishëm, ka qenë hapja e programit te doktoratës. Edhe ky objektiv është realizuar plotësisht duke u kurorëzuar me hapjen e programit të doktoraturës me dy fusha kërkimi që janë Aktrimi dhe Teoria Artit. Programi i doktoratures i jep Departamentit Aktrim dhe Teori të drejtën për të rritur peshën e punës së tij shkencore si dhe për të zhvilluar më tej punën për rritjen e kapaciteteve në ndërmarrjen me stabndarte cilësore të lojës aktoriale në fushën e aktrimit shqiptar dhe në rajon.

Ndërkohë duhet evidentuar fakti se realizimi i objektivave të Departamentit, përgjatë këtij viti shkollor, është orientuar edhe nëpërmjet realizimit të një serie veprimtarish të departamentit Aktrim & Teori si në fushën e mësimdhënies por dhe në fushën e formimit profesional e artistik të studentëve nëpërmjet:

- rritjes së standarteve të mësimdhënies;
- rritjes së nivelit profesional dhe artistik të stafit akademik
- rritjes cilësore të aktivitetit artistik të stafit në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare
- shtimin e infrastrukturës artistike me salla, studio dhe mjete didaktike në shërbim të mësimdhënies dhe aktivitetit artistik profesional të stafit
- organizimit më të mirë të programeve të studimit në përshtatje me nevojat e tregut të punës në fushën e artit .

2. Procesi mësimor në Departamentin Aktrim & Teori gjatë viti shkollor 2021 -2022

Procesi mësimor në Departamenti Aktrim & Teori është realizuar me përgjegjësi nga stafi akademik i brendshëm dhe i jashtëm përgjatë vitit akademik 2021 – 2022. Departamenti ka pasur në qendër të punës së tij të përditshme rritjen e standarteve cilësorë të mësimdhënies, duke e konsideruar mësimdhënien cilësore një element bazë dhe një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë universitare në arsimin e lartë. Procesi mësimdhënies është realizuar me standarte si gjatë zhvillimit të tij në programin e studimit Bachelor Aktrim ashtu dhe gjatë realizimit në programin e studimeve Master Aktrim & Mësuesi.

Departamenti e ka rritur standartin e mësimdhënies në procesin mësimor nëpërmjet përdorimit të teknikave bashkëkohore të mësimdhënies si në bllokun e lëndëve profesionale artistike ashtu dhe në bllokun e lëndëve teorike. Departamenti Aktrim & Teori ka hartuar programet e studimit të bazuara në rregulloret përkatëse të funksionimit të tyre. Këto rregullore kanë evidentuar qartë rregullat implementuese për realizimin me efektivitet të mësimdhënies në këto programe. Departamenti ka organizuar planin mësimor të programeve të studimit të organizuar sipas Udhëzimeve përkatëse të MAS. Fokusi i veprimtarisë mësimdhënëse në programet e studimit të departamentit është fokusuar te lëndët profesionale artistike. Ky bllok lëndësh, si në drejtim të sasisë së orëve mësimore që ka programi ashtu dhe në drejtim të përqindjeve, është në përmbushje të normativave që kanë udhëzimet e MAS. Ngarkesë mësimore është përkthyer saktë edhe në drejtim të numrit të krediteve, konform kërkesave që kanë udhëzimet përkatëse të MASR.

Plani mësimor Bachelor në Aktrim realizohet në tri vite mësimor dhe ka 180 kredite. Plani mësimor Master Aktrim & Mësuesi realizohet në dy vite mësimor dhe ka 120 kredite. Analiza strukturore e planeve mësimor të programeve të studimit të departamentit Aktrim është konform kërkesave që kanë udhëzimet e MAS, duke pasqyruar si orët mësimore në auditor dhe orët mësimore jashtë auditorit. Raporti i tyre është konform kërkesave të lejuara për hartimin e planit mësimor të programeve të studimit. Stafii i Departamentit ka realizuar në vazhdimësi rifreskimin e syllabuseve të lëndëve mësimore duke pasqyruar literaturë bashkëkohore dhe syllabuset lëndor u ndërton sipas një modeli të përcaktuar në udhëzimet e MAS mbi paraqitjen grafike të syllabuseve lëndor. Duhet theksuar fakti se Departamenti ka orientuar punën përgatitore për rishikimin e syllabuseve lëndor qysh në fillim të muajit shtator 2021, me synimin që syllabuset lëndor të ishin plotësisht të rifreskuara me fillimin e vitit shkollor në muajin Tetor 2021.

Departamenti ka realizuar saktë ndarjen e ngarkesës mësimore për vitin shkollor 2021 – 2022. Ndarja e ngarkesës mësimore është realizuar duke u nisur së pari nga kriteri përvojës profesionale që ka stafii i departamentit në fushën e mësimdhënies dhe së dyti nga kriteri i përgatitjes profesionale të stafit me karakteristikat që kanë kurikulat e programeve të studimit të Departamentit Aktrim. Ngarkesa mësimore është hartuar konform Udhëzimit të MAS-it të muajit shtator 2018. Ngarkesa mësimore është konform normave që parashikon LAL 80/2015 dhe Statuti i UART. Ndarja e ngarkesës mësimore të departamentit Aktrim ka marrë në konsideratë edhe statusin e UART si një institucion i arsimit të lartë me status të veçantë në drejtim të organizimit të mësimdhënies, duke pasqyruar në kushtet e departamentit Aktrim edhe mësimdhënien e individualizuar. Gjithashtu procesi ndarjes së ngarkesës ka pasur parasysh edhe mbingarkesën duke mos tejkaluar ngarkesën mbi 200 orë mësimore shtesë në auditor. Gjithashtu ka vazhduar përpjekja për të reduktuar edhe numrin e personelit të ftuar, duke vazhduar traditën që Departamenti të mbulojë me staf të brendshëm mbi 80 % të ngarkesës së programeve të studimit.

Departamenti në fillimin e vitit shkollor 2021-2022 realizoi edhe procesin e përzgjedhjes së pedagogëve të ftuar nga Departamenti për këtë vit shkollor. Procedura e realizimit të këtij procesi u krye me transparencë të plotë. Ky proces përfshiu disa hapa duke u fokusuar së pari te hapja e periudhës së aplikimit për ngarkesat mësimore që duheshin për tu mbuluar me pedagogë të ftuar. Prosesi përzgjedhjes ka vazhduar pastaj me konkurrimin në departament. Departamenti ka angazhuar në fushën e mësimdhënies figura me përvojë profesionale dhe që kanë aktivitet të spikatur profesional në fushën e aktrimit. Prosesi rekrutimit të pedagogëve të

ftuar ka ndihmuar për rritjen cilësore të procesit të mësimdhënies në programet e studimit të Departamentit Aktrim.

Stafi akademik i Departamentit ka bërë përpjekje serioze përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 për të realizuar një proces mësimor me standarte në mësimdhënie. Stafi akademik që realizoi bllokun e lëndëve të formimit profesional të studentëve, ka shfaqur nivel profesional e didaktik në procesin e mësimdhënies së këtyre lëndëve. Ky fakt evidentohet si nga fidbeku i marrë nga studentët, por dhe nga informacionet e marra nga monitorimi dhe vëzhgimet e realizuara nga përgjegjësi departamentit dhe strukturat drejtuese të FAS. Stafi akademik është përpjekur për të realizuar mësimdhënie cilësore. Kjo prirje e stafit akademik për të punuar për rritjen e cilësisë së mësimdhënies ka ndikuar në përvetësimin më të mirë të njohurive dhe aftësive praktike të studentëve, e materializuar edhe në rezultatet e tyre akademike përgjatë vitit shkollor 2021-2022. Realizimi me cilësi i mësimdhënies në bllokun e lëndëve profesionale artistike ka ndikuar edhe në rritjen e nivelit të formimit artistik të studentëve në programet e studimit të departamentit. Stafi akademik ka vazhduar, bazuar edhe në traditën tashmë të vendosur, të demonstrojë frymë konstruktive të bashkëpunimit pedagog – student. Kjo frymë bashkëpunimi ka ndikuar në rritjen e nivelit të mësimdhënies në lëndët e bllokut të formimit profesional, prezente në kurrikulat e programeve të departamentit Aktrim.

Përpjekje në lidhje me rritjen e cilësisë së mësimdhënies ka pasur përgjatë këtij viti shkollor edhe nga stafi akademik që mbulon formimin teorik me lëndë të fushës së teorisë së artit. Rritja e cilësisë së mësimdhënies është reflektuar në rritjen e nivelit të përmbajtjes së leksioneve, nëpërmjet përdorimit të një literature më formuese dhe të dobishme në ndihmë të përgatitjes teorike të studentëve të programit aktrim. Ndikim pozitiv në rritjen e cilësisë së mësimdhënies në lëndët teorike ka dhënë edhe rritja e marrëdhënies së studentit me bibliotekën. Por ende ka mundësi për të pasuruar më tej brendinë e leksioneve në lëndët teorike me material formuese bashkëkohore. Ndërkohë rritja e kapaciteteve të infrastrukturës dhe mjediseve më të përshtatshme për zhvillimin e orëve mësimore teorike, është një element që duhet ti jepet më shumë përparësi, sepse është një element që ka ndikim në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Analiza e të dhënave të arritura nga studentët në programin Bachelor Aktrim ka treguar së është punuar me përgjegjësi shkencore dhe artistike nga stafi departamentit, tregues që materializohet nga niveli punimeve të temave teorike dhe projekteve artistike të realizuara nga studentët në fund të vitit të trete Bachelor.

Lista e temave të punuar nga studentët është si më poshtë :

TEMAT TEORIKE & PROJEKTI ARTISTIK AKTRIM – BACHELOR

1. ERGI HASANI

Tema Teorike : HISTORIKU I TEATRI “BYLIS” FIER DHE AKTORËT E TIJ

Projekti Artistik : “ SAKATI NGA ISHMANI“ – MARTIN McDONAGH

2. EDISON KAJDOMQAJ

Tema Teorike : BIOGRAFI ARTISTIKE – YLLKA MUJO

Projekti Artistik : “ SAKATI NGA ISHMANI“ – MARTIN McDONAGH

3. ENXHI BALLA

Tema Teorike : BIOGRAFIA ARTISTIKE E MERYL STREEP

Projekti Artistik : “ SAKATI NGA ISHMANI“ – MARTIN McDONAGH

4. ESMERALDA DOSKU

Tema Teorike : BIOGRAFIA ARTISTIKE E BENEDICT CUMBERBATCH

Projekti Artistik : “ SAKATI NGA ISHMANI“ – MARTIN McDONAGH

5. EVI IMAMI

Tema Teorike : BIOGRAFI ARTISTIKE - TINKA KURTI

Projekti Artistik: "SAKATI NGA ISHMANI" – MARTIN McDONAGH

6. GRISELDA PRENDAJ

Tema Teorike : AKTRIMI NË ANTIKITET

Projekti Artistik: "SAKATI NGA ISHMANI" – MARTIN McDONAGH

7. ROMEO BUSHATI

Tema Teorike : AKTRIMI NË KOMEDINË FRANCEZE

Projekti Artistik: "SAKATI NGA ISHMANI" – MARTIN McDONAGH

8. SERXHJO DANGA

Tema Teorike : PROFILI AKTORESK I AGIM QIRJAQIT

Projekti Artistik: "SAKATI NGA ISHMANI" – MARTIN McDONAGH

9. SIDORELA KOÇA

Tema Teorike : BIOGRAFI ARTISTIKE E STELA ADLER

Projekti Artistik: "SAKATI NGA ISHMANI" – MARTIN McDONAGH

Udhëheqja me profesionalizëm e temave teorike dhe projekteve artistike evidenton rritjen e efektshmërisë së punës mësimdhënëse të stafit të departamentit nëpërmjet përdorimit të metodologjive efektive të mësimdhënies dhe rritjes së motivimit të studentëve për punë të pavarur kërkimore, artistike e aktoriale. Por duhet evidentuar se edhe përgjatë këtij viti shkollor ka qenë i vazhdueshëm shqetësimi i departamentit për mbështetjen me bazën materiale dhe didaktike të domosdoshme për realizimin e procesit mësimor. Mos përmbushja e plotë e kërkesave për bazë material, ka krijuar në disa raste, edhe probleme për zhvillimin me standarte të larta të procesit mësimor. Kjo kërkesë nuk është realizuar plotësisht.

Procesi i mësimdhënies në programin master ka vazhduar të fokusohet tek formimi i specifikave që duhet të shfaqë një student i programit Aktrim. Ky proces ka pasur si qëllim ndërgjegjësimin e studentëve për të kuptuar se procesi i formimit në fushën e aktrimit është një proces i gjatë dhe nuk mbaron brenda viteve të shkollimit në auditorët e fakultetit. Procesi mësimdhënies në programin master është fokusuar edhe tek fakti se studenti duhet të kuptojë se formimi i tij si artist i skenës kërkon pjesëmarrjen direkte në aktivitete artistike kombëtare, lokale apo rajonale . Departamenti këtë synim e ka pasur në qendër të vëmendjes për të rritur numrin e studentëve pjesëmarrës në aktivitete artistike në fushën e aktrimit.

Programi Master, përgatit studentin, krahas formimit të tij profesional e artistik në fushën e aktrimit skenik, edhe si mësimdhënës në fushën e lëndëve mbi artin që janë në kurikulën e arsimit parauniversitar. Departamenti edhe në këtë drejtim ka punuar me seriozitet për të mundësuar rritjen e njohurive që çojnë në formimin sa më të plotë nga ana didaktike e studentit në programin master. Programi studimit Master i Arteve ju ka krijuar mundësi studentëve që të orientohen më mirë në tregun e punës, duke ju ofruar më shumë mundësi punësimi jo vetëm si profesionist në fushën e artit skenik por edhe si mësues në fushën e artit në sistemin shkollor parauniversitar. Ky fakt evidentohet edhe tek puna e realizuar me temat dhe projektet artistike që përmbyllin studimet e ciklit të dytë.

Lista e studentëve që kanë realizuar tema teorike dhe projekti artistik është si më poshtë :

TEMA TEORIKE & PROJEKTI ARTISTIK NE PROGRAMIN MASTER AKTRIM & MËSUESI

1. ANXHELO SHKRELI

TEMA TEORIKE : KATËR SHKALLËT E AKTRIMIT METODIK

PROJEKTI ARTISTIK : "SHAKATË " - ÇEHOV

2. ENISA HYSA

TEMA TEORIKE : TEATRI POSTMODERN DHE ADAPTIMI NË BALLKAN
PROJEKTI ARTISTIK : “SHAKATË “ - ÇEHOV

3. PAOLO KADILLARI

TEMA TEORIKE : METODAT E AKTRIMIT DHE METODAT E AKTORËVE
SHQIPTARË

PROJEKTI ARTISTIK : “SHAKATË “ - ÇEHOV:

4. ENXHI PEPKOLAJ

TEMA TEORIKE : QASJE KRAHASUESE MES GJUHËS SË LIBRIT DHE GJUHËS SË
FILMIT

PROJEKTI ARTISTIK : “SHAKATË “ - ÇEHOV:

5. BARIUS HOXHALLI

TEMA TEORIKE: KONTRIBUTI I AKTORËVE KORÇARË NË FILM DHE TEATRIN
SHQIPTAR

PROJEKTI ARTISTIK: “SHAKATË “ - ÇEHOV:

6. GRISELDA XHANGOLLI

TEMA TEORIKE: ROLI I GRUAS NË KINEMATOGRAFINË SHQIPTARE

PROJEKTI ARTISTIK: “SHAKATË “ - ÇEHOV:

3. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe projektet artistike e shkencore

Departamenti Aktrim & Teori është institucioni i vetëm i arsimit të lartë që ofron diplomë universitare të ciklit të parë e të dytë në fushën e Aktrimit. Departamenti ka vazhduar edhe përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 të marri pjesë me stafin e tij akademik në jetën krijuese me krijimtari të mirëfilltë artistike, duke përfshirë edhe studentët e programit bachelor dhe Master. Stafin akademik i Departamentit, me emrat e mirënjohur të jetës skenike, ka bërë të mundur shkrirjen e natyrshme të mësimdhënies me procesin e performimit artistik. Dy nga kolegët me impakt me spektatorin dhe studentet, Prof. Petrit Malaj Dekan i FAS dhe Prof G. Gjoka, si natarë të Bordit Artistik të Teatrit Kombëtar Eksperimental kane sjell risi të reja në përzgjedhjen e performancës artistike në këtë institucion e më gjerë. Gjithashtu Departamenti Aktrim & Teori ka vazhduar pjesëmarrjen në programet e projekteve Erasmus Plus. Këto projekte janë një tjetër mundësi që është shfrytëzuar maksimalisht nga stafin departamentit për të rritur shkëmbimet artistike e shkencore me departamentet homologe në universitetet europiane. Gjatë vitit shkollor 2021 – 2022 ka vazhduar marrëveshja me një “konsorcium” shkollash arti me qendër në Spanjë, pjesë e një projekti Erasmus +. Përpjekjet e departamentit në kuadër të këtij program kanë vazhduar për tu krijuar mundësinë e mobilitetit edhe studentëve të programeve tona të studimit.

4. Aktiviteti artistik e krijues i Departamenti Aktrim

Departamenti Aktrim, edhe gjatë vitit shkollor 2021 – 2022 ka pasur angazhim për realizimin e disa projekteve artistik. Këto projekte janë realizuar si në mënyrë individuale nga pedagogët e departamentit ashtu dhe me produksione me studentët për të realizuar shfaqje në kuadër të diplomave apo aktivitet artistik të programuar. Gjatë këtij viti shkollor, Stafin akademik i Departamentit, ka pasur në qendër të punës së tij krijuese, pjesëmarrjen e studentëve në procesin krijues në skenë. Studentët e degës Aktrim, kanë qenë pjesë aktive e projekteve artistike të realizuara në mjaft skena kryesore të vendit. Ata kanë realizuar një profil krijues cilësor për formimin e aktorit, edhe nëpërmjet realizimit të provimeve me karakter artistik. Pedagogët e departamentit Aktrim & Teori kanë marrë pjesë përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 në disa projekte të rëndësishme artistike si në fushën e kinematografisë edhe në fushën e aktrimit në teatër.

Departamenti Aktrim & Teori ka vazhduar gjatë vitit shkollor realizimin e disa aktiviteteve me projekte artistike të realizuara individualisht apo në grup me studentët. Gjithashtu ka dhe disa aktivitete që janë zhvilluar tërësisht në bashkëpunim me studentët në vite të ndryshme të programeve të studimit. Aktiviteti artistik dhe didaktik në shërbim të formimit profesional të studentëve dhe evidentimi i vlerave artistike dhe krijuese të stafit akademik të departamentit, ka vazhduar të shprehi kontributin artistik e profesional në skenat më të spikatura shqiptare. Disa nga pjesëmarrjet më të spikatura në këto aktivitete janë konkretisht:

Prof Petrit Malaj	-Përvjetori i datëlindjes - në Teatrin Kombëtar me regji te Besmir Bitrakut,
Prof Ass. Ema Andrea	- Unë jam Mephisto - në Teatrin Kombëtar Eksperimental me regji te Dino Mustafic.
Rovena Lule	- Flora - Filmi Artistik me metrazh të gjatë me regji Pluton Vasi
Prof. G. Gjoka	-CORIOLANUS - Teatri kombëtar “ Kujtim Spahivogli’ (Te rinjve) me regji prof Altin Basha
Prof. Alfred Trebicka	- Hedda Gabler - e Ibsenit në Teatrin Eksperimental -Jul Qezari – Shekspir në Teatrin Eksperimental - Portreti pambaruar i Klara Belinit - Film me Regjizor N.Ajazi.
Prof.Ass. Gëzim Rudi	- Epsh dhe Lakmi – e Eugen O. Neill Teatri Turbina - Ne te Dy – Film Dublime Filmash ne TV Top Chanel
Inis Gjoni	-HOT – Film televiziv Serial Organizatore Festivalit - Etno Fest Kukaj - Prishtin
Prof.Assoc.dr. Elida Rapti	“ Physical Education, A preventive Element Against Bullying at School” – First International Scientific Conference November 2021 Sofia, Bulgaria

Gjithashtu edhe stafi i lëndëve teorike ka vazhduar lidhjen e njohurive teorike me artin në fushat specifike të cilat mbulojnë programet përkatëse të studimit. Aktiviteti i tyre shkencor në funksion të formimit të përgjithshëm të studentit ka konsistuar në një ribotim teksti në ndihmë të studentëve, 3 referime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në shkrime artikujsh në periodikë në shërbim të fushave të studimit që mbulohe në kurrikulën e programeve të studimit në FAS.

5.Konkurset e pranimit

Procesi i organizimit të konkurseve të pranimit të studentëve në programet e Departamentit Aktrim & Teori edhe përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 ka vazhduar të jetë një moment i rëndësishëm në procesin mësimor dhe organizativ të departamentit. Gjatë muajit Gusht 2021 është ngritur komisioni i pranimit të studentëve aplikant në programin e studimit aktrim. Procesi i konkurimit është zhvilluar me transparencë të plotë dhe është monitoruar me shumë vëmendje nga strukturat drejtuese të fakultetit si dhe nga vetë departamenti konform LAL 80/2015 dhe Statutit të UART. Procesi konkurrimit ka zbatuar rregullat dhe udhëzimet përkatëse. Stafi akademik I Departamentit në bashkëpunim me dekanin prof. Petrit Malaj dhe zëvendës dekanin prof. Ilir Martini ka treguar seriozitet profesional për mbarëvajtjen e procesit të konkurseve për të mundësuar seleksionimin e vlerave më të mira të shfaqura nga kandidatët

konkurentë. Komisioni vlerësues është zgjedhur me transparencë dhe mbi bazën e profesionalizmit. Fidbeku i marrë nga procesi i konkurimit tregon se grupi i përzgjedhur i studentëve fitues në programin Aktrim përfaqëson aplikantët më të talentuar. Grupi I studentëve të përzgjedhur përmbushi pritshmërinë së pari se u realizua një proces mësimor cilësor dhe me nivel krijues me këtë grup studentësh, dhe së dyti se rezultatet që ata kanë treguar, si në programin bachelor dhe në programin Master kanë qënë të larta. Procesi i suksesshëm i konkursit në programin Aktrim është lehtësuar edhe nga angazhimi i një numri pedagogësh të departamentit. Ata kanë realizuar një fushatë promovuese me nxënësit maturan të në shkollat e mesme artistike dhe në shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm në Tiranë dhe qytete të tjera të Shqipërisë. Klima transparente e njohjes me rezultatet, gatishmëria e stafit akademik për të punuar edhe në ditët e pushimit, mungesa e ankimeve etj. janë fidbeku më i mirë që ky proces u realizua me sukses. Gjithashtu duhet theksuar se edhe konkursi i zhvilluar për programin Master ishte i suksesshëm. Stafi departamentit organizoi edhe këtu procesin e përzgjedhjes së kandidatëve duke kombinuar aplikimin e tyre me dosje dhe me intervistimin e aplikantëve për të mundësuar zgjedhjen e më të talentuarve.

6. Programet e studimit

Departamenti Aktrim & lëndë Teorike është pjesë e FAS të UART. Programet e studimit që ka realizuar Departamenti Aktrim & Teori përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 janë:

Cikli Studimit Bachelor

1 Programi studimi bachelor “AKTRIM”

Cikli Studimit Master

1 Programi studimit Master Arteve në “AKTRIM DHE MËSUESI”

Departamenti Aktrim & Teori, edhe përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022, ka pasur në fokus reformimin e programeve të studimit. Departamenti Aktrim & Teori e orientoi punën e tij në rishikimin e programeve drejt disa objektivave që ishin :

- Rishikimi literaturës teorike e profesionale të syllabuseve
- Njohja më e mirë e tregut të punës dhe përshtatja programit me nevojat e tregut të punës
- Ofrimi e mundësisë për studentët për edukimin gjatë gjithë jetës;
- Krijimi raporteve më të drejta mes formimit teorik dhe praktik të studentëve;
- Promovimi programeve për tërheqjen e një numri sa më të madh studentësh;
- Krijimi mundësive për realizimin e një mësimdhënie sa më efektive dhe profesionale.

Departamenti Aktrim & Teori ka punuar, bazuar në standartet e vendosura nga VKM-të apo Udhëzimet e MAS-it për reformimin e moduleve të lëndëve si në programin Bachelor dhe në programin Master për të realizuar procesin e Akreditimit të këtyre programeve në fillim të vitit shkollor 2022-2023. Departamenti realizoi Raportin e vlerësimit të Brendshëm dhe përgatiti dokumentacionin përkatës për këto programe në bazë të afateve kohore të vendosura.

7. Studentët

Departamenti përgjatë aktivitetit të tij mësimdhënës dhe artistik e shkencor, ka pasur në qendër të vëmendjes pajisjen dhe zhvillimin e një procesi kreativ me studentët mbi njohuritë krijuese e kërkimore në fushën e aktrimit. Ky objektiv është fokusuar me realizimin konkret të punëve

krijuese në provime e projekte artistike. Një element që ka vazhduar të evidentohet në procesin e mësimdhënies, ka qenë rritja e motivacionit që ka shfaqur stafi akademik për të ndikuar në rritjen e interesimit të studentëve për lëndët speciale, lëndët e formimit profesional si aktor dhe për lëndët teorike që i pajisin me kulturë të përgjithshme në shërbim të profesionit . Rritja e interesit të studentëve për procesin e mësimdhënien në këto lëndë është ndihmuar nga rritja profesionale e procesit të mësimdhënies që ka shfaqur stafi akademik i departamentit përgjatë këtij viti shkollor. Stafi akademik i Departamentit, duke u përballur me kërkesat gjithnjë në rritje të studentëve për një mësimdhënie sa më efektive e bashkëkohore, ka nxitur rritjen e motivimit të tyre për të realizuar një proces mësimdhënie sa më bashkëkohor dhe me kërkesat që ka sot formimi aktorit në skenën europian.

Studentët e programeve të studimit Aktrim kanë qenë pjesëmarrës edhe në disa aktivitete artistike duke realizuar disa produksione artistike të përbashkëta mes studentëve të programeve aktrim me studentët e degëve të tjera . si regji, regji filmi, koreografi, etj duke i kthyer ato në moto të studentëve në procesin krijues.

Temat e projekteve të Diplomave në programin Master dhe Bachelor kanë pasur në fokus disa nga veprat më të spikatura të autorëve më të mire të dramaturgisë botërore. Gjithashtu edhe temat teorike të diplomave të studentëve të programit Master kanë qenë cilësore dhe kanë trajtuar problematika teorike e krahasuese bashkëkohore në fushën e aktrimit. Ky fakt vërehet edhe në vlerësimet e rezultateve të studentëve në këtë komponent të vlerësimit të tyre.

Edhe gjatë vitit shkollor 2021 – 2022, ka vazhduar rritja e numrit të studentëve të angazhuar në veprimtari artistike që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve artistike, përvojë kjo që duhet të rritet më tej me pjesëmarrjen e studentëve sepse është një përvojë që ndihmon në formimin e tyre artistik. Megjithatë stafi i departamentit kërkon që në të ardhmen të rrisi më shumë bashkëpunim e punës krijuese e artistike të stafit akademik me studentët, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes të studentëve në aktivitete artistike që në bangat e auditorëve universitar.

Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & TV:

1. Vizioni dhe objektivat e Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & TV të FAS.

Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni, është një ndër tri departamentet e Fakulteti të Artit Skenik, të UART. Kjo njësi bazë përgjatë vitit shkollor 2021- 2022, ka bërë përpjekje maksimale me qëllim përmbushjen vizionit kryesor në lidhje me edukimin artistik dhe profesional të studentëve. Vizioni i Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni ka qenë i kanalizuar edhe përgjatë këtij viti shkollor në punën për të rritur standardet e procesit të mësimdhënies si dhe për realizimin cilësor të projekteve artistike dhe shkencore si në lëndën regjisorës, ashtu edhe në atë të aktrimit. Vizioni i shpallur nga njësia bazë në fillim të vitit shkollor 2021-2022, u realizua nëpërmjet përmbushjes së objektivave që kishte përcaktuar që në fillimi të vitit shkollor 2021-2022. Objektivat e vendosura nga njësia bazë përgjatë këtij viti shkollor ishin në shërbim të rritjes së njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve. Ky trend në shërbim të rritjes së njohurive teorike e profesionale regjisoriale dhe aktoriale të studentëve u realizua nëpërmjet rritjes së standardeve të mësimdhënies si dhe zhvillimit të formimit profesional dhe artistik të studentëve, nëpërmjet përfshirjes së tyre në veprimtaritë artistike që u realizuan nga personeli akademik i Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni.

Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni, përcaktoi disa objektiva për t'u arritur përgjatë vitit shkollor 2021 -2022 si në fushën e mësimdhënies dhe në fushën e veprimtarive artistike e shkencore. Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni vendosi se objektivat kryesorë për tu realizuar në këtë vit shkollor duhet të ishin:

- Rritjen e standardeve të mësimdhënies dhe kualifikimit artistik të studentëve
- Realizimin e trajnimit të mësuesve të fushës së artit në sistemin parauniversitar
- Promovimi vlerave profesionale të studentëve të aktrimit nëpërmjet përfshirjes në aktivitete kulturore dhe artistike si dhe orientimin e tyre drejt tregut të punës në fushën e punësimit.
- Rritja e aftësive menaxheriale për orientimin e karrierës së studentëve drejt fushës së aktrimit dhe mësuesisë së fushës së artit.

Strategjia e Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni për arritjen e këtyre objektiveve përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 u orientuar drejt :

- rritjes së numrit të studentëve në programin e studimit Regji nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të kapaciteteve akademike.
- përmirësimit të standardeve të mësimdhënies nëpërmjet zgjerimit të infrastrukturës artistike e krijuese
- pjesëmarrjes aktive të personeli akademik dhe studentëve në projekte artistike dhe shkencore
- rritjes së kontributit të personeli akademik në jetën artistike skenike të vendit
- hapjes së programit të doktoraturës

Gjatë vitit shkollor 2021-22 mund të themi se objektivat kryesor të Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni, rritja e standardeve të mësimdhënies dhe kualifikimit artistik të studentëve të këtij programi janë realizuar plotësisht nëpërmjet rritjes së statusit të Njesisë Bazë si bërthama më cilësore në përgatitjen e edukimit artistik të studentëve në fushën e regjiturës (po ashtu edhe të aktrimit) në Shqipëri dhe rritjes së ngarkesës së veprimtarisë krijuese dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të studentëve. Ndërkohë një tjetër objektiv i rëndësishëm ka qenë edhe edukimi i studentëve si në drejtim të rritjes së tyre profesionale për të qenë regjisorë dhe aktorë të kualifikuar, por edhe në drejtim të shndërrimit të tyre në qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. Edhe ky objektiv është realizuar nëpërmjet implementimit të ndërthurjes së mësimdhënies cilësore me rritjen e aftësive krijuese e artistike të studentëve dhe pedagogëve, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në veprimtari kërkimore dhe realizimin e projekteve artistike. Ndërsa objektiv tjetër i rëndësishëm, ka qenë hapja e programit të doktoraturës. Edhe ky objektiv është realizuar plotësisht duke u kurorëzuar me hapjen e programit të doktoraturës “Doktoratë në Arte Skenike” nën fusha regjiturë. Programi i doktoraturës i jep Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni të drejtën për të rritur peshën e punës së tij shkencore si dhe për të zhvilluar më tej punën për rritjen e kapaciteteve në ndërmarrjen me standarde cilësore të punimeve të mirëfillta kërkimore dhe teorike.

Ndërkohë duhet evidentuar fakti se realizimi i objektivave të Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni përgjatë këtij viti shkollor, është orientuar edhe nëpërmjet realizimit të një serie veprimtarish si në fushën e mësimdhënies por dhe në fushën e formimit profesional e artistik të studentëve nëpërmjet :

- rritjes së standardeve të mësimdhënies;
- rritjes së nivelit profesional dhe artistik të personeli akademik
- rritjes cilësore të aktivitetit artistik të personelit në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare
- shtimin e infrastrukturës artistike me salla, studio dhe mjete didaktike në shërbim të mësimdhënies dhe aktivitetit artistik profesional të personelit

- organizimit më të mirë të programeve të studimit në përshtatje me nevojat e tregut të punës në fushën e artit .

1. Procesi mësimor në Njësinë Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni gjatë vitit shkollor 2021 -2022

Procesi mësimor në Njësinë Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni është realizuar me përgjegjësi nga personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm përgjatë vitit akademik 2021 – 2022. Njësia Bazë ka pasur në qendër të punës së saj të përditshme rritjen e standardeve cilësore të mësimdhënies, duke e konsideruar mësimdhënien cilësore një element thelbësor dhe një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë universitare në arsimin e lartë. Procesi mësimdhënies është realizuar me standarde si gjatë zhvillimit të tij në programin e studimit Bachelor apo edhe atë Master.

Njësia Bazë e ka rritur standardin e mësimdhënies në procesin mësimor nëpërmjet përdorimit të teknikave bashkëkohore të mësimdhënies si në bllokun e lëndëve profesionale artistike ashtu dhe në bllokun e lëndëve teorike. Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni ka hartuar programet e studimit të bazuara në rregulloret përkatëse të funksionimit të tyre. Këto rregullore kanë evidentuar qartë rregullat implementuese për realizimin me efektivitet të mësimdhënies në këto programe. Njësia Bazë ka organizuar planin mësimor të programeve të studimit sipas udhëzimeve përkatëse të MAS. Fokusi i veprimtarisë mësimdhënëse në programet në të dy programet e studimit ka qenë te lëndët profesionale artistike. Ky bllok lëndësh, si në drejtim të sasisë së orëve mësimore që ka programi ashtu dhe në drejtim të përqindjeve, është në përmbushje të normativave që kanë udhëzimet e MAS. Ngarkesa mësimore është përkthyer saktë edhe në drejtim të numrit të krediteve, konform kërkesave të po këtyre udhëzimeve.

Plani mësimor Bachelor në Regji si dhe në Regji Filmi realizohet në tri vite mësimore dhe kanë 180 kredite. Plani mësimor Master në Regji Teatri dhe Spektakli dhe Mësuesi si dhe ai Regji Filmi dhe Televizioni dhe Mësuesi realizohet në dy vite mësimor dhe kanë 120 kredite. Analiza strukturore e planeve mësimor të programeve të studimit të Njësisë Bazë është konform kërkesave që kanë udhëzimet e MAS, duke pasqyruar si orët mësimore në auditor dhe orët mësimore jashtë auditorit. Raporti i tyre është konform kërkesave të lejuara për hartimin e planit mësimor të programeve të studimit. Personeli pedagogjik i Njësisë Bazë ka realizuar në vazhdimësi rifreskimin e syllabuseve të lëndëve mësimore duke pasqyruar literaturë bashkëkohore dhe syllabuset lëndore janë ndërtuar sipas modelit të unifikuar të përcaktuar në udhëzimet e MAS. Duhet theksuar fakti se Njësia Bazë e ka orientuar punën përgatitore për rishikimin e syllabuseve lëndore që në fillim të muajit shtator 2021 me synimin që të ishin plotësisht të rifreskuara me fillimin e vitit akademik 2021 - 2022.

Gjithashtu Njësia Bazë ka realizuar saktë ndarjen e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2021 – 2022. Ndarja e ngarkesës mësimore është realizuar duke u nisur së pari nga kriteri përvojës profesionale që ka personeli i Njësisë Bazë në fushën e mësimdhënies dhe së dyti nga kriteri i përgatitjes profesionale të personelit me karakteristikat që kanë kurrikulat e programeve të studimit në këtë njësi bazë. Ngarkesa mësimore është hartuar konform Udhëzimit të MAS-it të muajit shtator 2018. Ngarkesa mësimore është konform normave që parashikon LAL 80/2015 dhe Statuti i UART. Ndarja e ngarkesës mësimore të Njësisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & TV ka marrë në konsideratë edhe statusin e UART si një institucion i

arsimit të lartë me status të veçantë në drejtim të organizimit të mësimdhënies, duke pasqyruar edhe mësimdhënien e individualizuar. Gjithashtu procesi i ndarjes së ngarkesës ka pasur parasysh edhe mbingarkesën duke mos tejkaluar 200 orë mësimore shtesë në auditor. Po ashtu ka vazhduar përpjekja për të reduktuar edhe numrin e personelit të ftuar, duke ecur në traditën që personeli akademik me kohë të plotë të mbulojë mbi 80 % të ngarkesës totale të programeve të studimit.

Njësia Bazë në fillimin e vitit shkollor 2021-2022 realizoi edhe procesin e përzgjedhjes së pedagogëve të ftuar për këtë vit shkollor. Procedura e realizimit të këtij procesi u krye me transparencë të plotë. Ky proces përfshiu disa hapa duke u fokusuar së pari te hapja e periudhës së aplikimit për ngarkesat mësimore që duheshin për tu mbuluar me pedagogë të ftuar. Prosesi përzgjedhjes ka vazhduar pastaj me konkurrimin. Njësia Bazë ka angazhuar në fushën e mësimdhënies figura me përvojë artistike që kanë aktivitet të spikatur profesional në fushë dhe gjithashtu edhe eksperiencë mësimdhënie. Prosesi rekrutimit të pedagogëve të ftuar ka ndihmuar për rritjen cilësore të procesit të mësimdhënies duke sjellë frymë të re dhe ndikim pozitiv të studentët për sa i përket gërshetimit të mësimdhënies dhe tregut të punës në profesionin tonë.

Personeli akademik i Njesisë Bazë ka bërë përpjekje serioze dhe të suksesshme përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 për të realizuar një proces mësimor me standarde në mësimdhënie. Personeli akademik që realizoi bllokun e lëndëve të formimit profesional të studentëve, ka shfaqur nivel profesional e didaktik në procesin e mësimdhënies së këtyre lëndëve. Ky fakt evidentohet si nga përgjigjet e marra nga sondazhet e kryera me studentët nga Sektori Mësimor i UART por, edhe nga informacionet e marra nga monitorimi dhe vëzhgimet e realizuara nga përgjegjësi i Njesisë Bazë dhe strukturat drejtuese të FAS. Prirja e personelit akademik për të punuar për rritjen e cilësisë së mësimdhënies ka ndikuar në përvetësimin më të mirë të njohurive dhe aftësive praktike të studentëve, e materializuar edhe në rezultatet e tyre akademike përgjatë vitit shkollor 2021-2022. Realizimi me cilësi i mësimdhënies në bllokun e lëndëve profesionale artistike ka ndikuar edhe në rritjen e nivelit të formimit artistik të studentëve në të katër programet e studimit. Personeli akademik, bazuar edhe në traditën tashmë të vendosur, ka vazhduar të demonstrojë frymë konstruktive të bashkëpunimit pedagog – student. Kjo frymë bashkëpunimi ka ndikuar edhe në rritjen e nivelit të mësimdhënies në lëndët e bllokut të formimit profesional.

Procesi i mësimdhënies në programet Master ka vazhduar të fokusohet tek formimi i specifikave që duhet të shfaqin studentët e këtyre programeve. Ky proces ka pasur si qëllim ndërgjegjësimin e studentëve për të kuptuar se formimi në fushën e regjistrës është një proces i gjatë dhe nuk mbaron vetëm brenda viteve të shkollimit në auditorët e fakultetit. Prosesi mësimdhënies në programin Master është fokusuar edhe tek fakti se studenti duhet të kuptojë se formimi i tij si artist i skenës kërkon pjesëmarrjen direkte në aktivitete artistike lokale, kombëtare, apo rajonale. Njësia Bazë këtë synim e ka pasur në qendër të vëmendjes për të rritur numrin e studentëve pjesëmarrës në aktivitete artistike në fushën e aktrimit.

Programi Master, përgatit studentin, krahas formimit të tij profesional e artistik në fushën e regjistrës, edhe si mësimdhënës në fushën e lëndëve mbi artin që janë në kurrikulën e arsimit parauniversitar. Njësia Bazë edhe në këtë drejtim ka punuar me seriozitet për të mundësuar rritjen e njohurive që çojnë në formimin sa më të plotë nga ana didaktike të studentëve në programin master. Programi studimit Master i Arteve ju ka krijuar mundësi

studentëve që të orientohen më mirë në tregun e punës, duke ju ofruar më shumë mundësi punësimi jo vetëm si profesionist në fushën e artit skenik por edhe si mësues në fushën e artit në sistemin shkollor parauniversitar.

2. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe projektet artistike e shkencore

Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & TV është institucioni i vetëm i arsimit të lartë që ofron diplomë universitare të ciklit të parë e të dytë në fushën e Regjisë skenike dhe asaj filmike. Njësia Bazë ka vazhduar edhe përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 të marrë pjesë me personelin e tij akademik në jetën krijuese me krijimtari të mirëfilltë artistike, duke përfshirë edhe studentët e programit Bachelor dhe Master. Personeli akademik i Njesisë Bazë, me emrat e mirënjohur të jetës skenike, ka bërë të mundur shkrirjen e natyrshme të mësimdhënies me procesin e performimit artistik.

Gjithashtu Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni ka vazhduar pjesëmarrjen në programet e projekteve Erasmus Plus. Këto projekte janë një tjetër mundësi që është shfrytëzuar maksimalisht nga personeli i kësaj Njesisë Bazë për të rritur shkëmbimet artistike e shkencore me departamentet homologe në universitetet evropiane. Gjatë vitit shkollor 2021 – 2022 ka vazhduar marrëveshja me një “konsorcium” shkollash arti me qendër në Spanjë, pikërisht pjesë e projektit Erasmus +. Përpjekjet e Njesisë Bazë në kuadër të këtij program kanë vazhduar për tu krijuar mundësinë e mobilitetit edhe studentëve të programeve tona të studimit.

3. Aktiviteti artistik e krijues i Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & TV

Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & TV, edhe gjatë vitit shkollor 2021 – 2022 ka pasur angazhim për realizimin e disa projekteve artistik. Këto projekte janë realizuar si në mënyrë individuale nga pedagogët e Njesisë Bazë ashtu dhe me produksione me studentët për të realizuar shfaqje në kuadër të diplomave apo aktiviteteve artistike të programuara. Gjatë këtij viti shkollor, personeli akademik i Njesisë Bazë ka pasur në qendër të punës së tij krijuese pjesëmarrjen e studentëve në procesin krijues në skenë. Studentët kanë qenë pjesë aktive e projekteve artistike të realizuara në mjaft nga skenat kryesore të vendit. Ata kanë realizuar një profil krijues cilësor në formimin e tyre qoftë si regjisorë apo edhe si aktorë edhe nëpërmjet realizimit të provimeve me karakter artistik. Pedagogët e Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & TV kanë marrë pjesë përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 në disa projekte të rëndësishme artistike si në fushën e teatrit dhe spektaklit ashtu edhe atë të kinematografisë.

Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni ka vazhduar gjatë vitit shkollor realizimin e disa aktiviteteve me projekte artistike të realizuara individualisht apo në grup me studentët. Gjithashtu ka dhe disa aktivitete që janë zhvilluar tërësisht në bashkëpunim me studentët në vite të ndryshme të programeve të studimit. Aktiviteti artistik dhe didaktik në shërbim të formimit profesional të studentëve dhe evidentimi i vlerave artistike dhe krijuese të personelit akademik të kësaj Njesisë Bazë, ka vazhduar të shprehë kontributin artistik e profesional në skenat më të spikatura shqiptare. Disa nga pjesëmarrjet më të spikatura në këto aktivitete janë konkretisht:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Kategoria	Titulli
1	Milto	Sotir	Kutali	Profesor	Profesor

Shfaqja “Vilhelm Teli” – Regji Opere

Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al

Shfaqja "Vatrani I harruar" – Regji					
2	Mehmet	Tare	Xhelili	Profesor	Profesor
Shfaqja "Milingonat që nuk mjaftuan" – regjia Shfaqja "Pak Pakt" – Roli I Avokatit Shfaqja "Përvjetori I Ditëlindjes"-Roli I Polit					
3	Arben	Mentor	Kumbaro	Profesor	Profesor
Shfaqja "Ballkoni" – Regjisor Punë kërkimore për projektin pasardhës					
4	Besnik	Xhemal	Bisha	Profesor	Profesor
Filmi i gjatë "Sahatcia" – produksion. Filmi i shkurtër "Peng" – produksion					
5	Aneta	Dhimitri	Malaj	Profesor	Profesor Dr.
Hartim i rregullores Dep. RRFTV Hartim i rregullores Prog. Studimit Regji Punimi "Aktori Monologist – Teoria dhe Praktika"					
6	Donard	Izet	Hasani	Profesor	Profesor Dr.
Shfaqja "Celule Seksuale" – regjia Oponence Doktoratura Artan Ibërshimi					
7	Genci	Sefedin	Fuga	Profesor	Profesor as.
Shfaqja Koriolani					
8	Alert	Zeno	Çeloaliaj	Profesor	Profesor as.
Shfaqja "Duet për Solo – Roli i Doktor Feldman Realizim i Narracionit në dokumentarë Hartim i rregullores se Ciklit të II-të të studimit në FAS Hartimi i rregullores së FAS Hartim i rregullores së Departamentit RFTV Hartim i rregullores se Ciklit të II Programi i studimit Regji Teatri dhe Spektakli & Mësuesi. Hartim i rregullores së Ciklit të II Programi i Studimit Regji Filmi dhe Televizioni & Mësuesi Hartim i RVB për akreditimin e programeve të Ciklit të dytë Master Regji Teatri dhe Spektakli & Mësuesi Hartim i RVB për akreditimin e programeve të Ciklit të dytë Master Regji Filmi dhe Televizioni & Mësuesi					
9	Rozina	Frano	Kostani	Profesor	Profesor as.
Shfaqja "Aroma e Hënës" – Regji Shfaqja "Tre Dimra" – Regji					
10	Taulanda	Ali	Jupi	Profesor	Profesor as.
Platformë mbi Artin, Kulturën dhe Trashëgiminë e Kulturës, zhvilluar dhe hartuar në konferencën bashkëpunim me Institutin e Studimeve Politike dhe Sociale "Sami Frashëri" Dramatizim i romanit " Puthja e Amazones" - Mira Meksi - pjesë e projektit të përvitshëm "Ti ke mundësi të zgjedhësh, duaje veten, zgjidh jetën!" Krijimi dhe themelimi i institucioneve të reja, rikonceptimi dhe ristrukturimi i institucioneve ekzistuese nga ana ligjore dhe infrastrukturore si domosdoshmëri për zhvillim të qëndrueshëm në fushën e artit kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Komunizmi në kryqëzimin mes kujtesës dhe historisë, të vërtetës dhe interpretimit.					

Ngritja e blogut akademiko- social mbi artin, kulturën, edukimin taulandajupi.com					
11	Ahmet	Qemal	Pasha	Profesor	Profesor as.
Pjesëmarrës në Festivalin e Teatrit Shqiptar në Shkup					
12	Zamir	Bujar	Kokonozi	Profesor	Profesor as.
Unicef finale "Te besoj", fushate foto Video e AUSA Festivali Dardan anëtar jurie Xhirimi video promocionale per Guinness Black Dragon reklame + post produksion Golalpiol reklame + post produksion					
13	Ylljet	Riza	Aliçka	Profesor	Profesor Dr.
Mbjellja e Pemëve – Skenarist Histori Dashurie - Dramaturg					
14	Elis	Selam	Mataj	Lektor	Doktor
Organizator dhe anëtar i jurisë përzgjedhëse të filmave për DEA FILM FESTIVAL Mbikëqyrës i realizimit artistik të projektit ADNICH Projekti "Lexo përmes meje" – Salla COD					
15	Anila	Qazim	Varfaj	Lektor	MSC
Botimi me poezi "Kode nën lëkurë" - autor					
16	Joni	Mevlan	Shanaj	Lektor	MSC
Filmi me metrazh të gjatë "Another Day" – producent Skenari i filmit me metrazh të gjatë "Jeta është ëndërr" – skenarist. Projekt në zhvillim					
17	Artur	Shaban	Selmani	Lektor	MSC
Përkthime mbi ndriçimin skenik (punë në proces)					
18	Arben	Beqir	Derhemi	Lektor	MSC
Shfaqja Edmond – aktor Shfaqja Koriolani – aktor Shfaqja Ora e vdekjes – aktor Performance poetike nga Ismail .Kadare – aktor Shfaqja Pozicioni i përfshirjes - aktor dhe producent					
19	Kristaq	Telemak	Pilo	Lektor	MSC
Filmi Muri i vjetër – aktor Filmi Shkëlqimi dhe rënia e Shokut Zylo – aktor Filmi Luna Park – aktor					
20	Aldi	Rebani	Hysotoçi	Lektor	MSC
Shfaqja "Çifti i çuditshëm"- Regjisor Shfaqja "PePe"(mbrëmje poetike) - Regjisor					
21	Qëndrim	Shai	Rijani	Lektor	MSC
Shfaqja "Plus -18" - Regjisor					

Shfaqja "Fishkëllime ne errësirë" - Regjisor Shfaqja "Tregtari i Venedikut" - Regjisor Shfaqja "Arturo Ui " - Regjisor Shfaqja "Tri Motrat" - Regjisor					
22	Genc	Gezim	Gjineci	Lektor	MSC
Krijim i brandit të ri të televizionit ABC (Shqipëri) dhe udhëheqje artistike e të gjithë programeve të tij. Ribrandim i televizionit T7 (Kosovë) dhe riformatim artistik i të gjithë programeve të tij. Krijim (nga A në ZH: creative, production & broadcast) i televizionit INFO24 (Shqipëri) dhe kurim artistik i gjithë programacionit.					
23	Eno	Pirro	Milkani	Lektor	MSC
Dokumentari "Ana" – proces xhirimi Dokumentari "Legjendat e Gjolit" – ne proces.					
24	Arben	Osman	Lami	Lektor	MSC
Kryetar jurie për filmat e shkurtër dhe te animuar ne TIFF, Tirana 48 ore film fesival, pjemarres ne festivalin e Cannes, Tallinit etj					
25	Elidor	Abdurraman	Markja	Lektor	MSC
Producent ne filmin "DORI" me metrazh te shkurtër te financuar nga Qendra komberare e kinematografise (QKK) Asistent regjisor ne filmin "VDEKJA LE TE PRESE" (ne proces)					
26	Aldion	Thoma	Kola	Lektor	MSC
Sound Designer dhe Sound Editor ne filmat: Lugina e Djalit, Tea dhe Kejsi, Erik, Gjurma pa Shenje, Mbjellja e Pemëve, Winters Fireflies. Çika - The Battle Against - audio book					
29	Suela		Zalla	Lektor	MSC
Sheila - Te prezantoj Babain – aktore (fituese e çmimit Aktorja me e mire Jo protagoniste, në Kokofest 2022) Vaja - Endrrambajtesi (film i shkurtër) - aktore Peti Ftoi - "Ëndrra e një nate vere"- aktore Casting ditector tek Katrori i Pushtetit (serial televiziv)					

Konkurset e pranimit

Procesi i organizimit të konkurseve të pranimit të studentëve në programet e Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & TV edhe përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 ka vazhduar të jetë një moment i rëndësishëm në procesin mësimor dhe organizativ. Gjatë muajit Gusht 2021 është ngritur komisioni i pranimit të studentëve aplikantë në të gjithë programet e studimit Bachelor. Procesi i konkurrimit është zhvilluar me transparencë të plotë dhe është monitoruar me shumë vëmendje nga strukturat drejtuese të fakultetit si dhe nga vetë Njësia Bazë konform LAL 80/2015 dhe Statutit të UART. Procesi konkurrimit ka zbatuar rregullat dhe udhëzimet përkatëse. Personeli akademik i Njesisë Bazë në bashkëpunim me dekanin Prof. Petrit Malaj dhe zv. Dekanin Prof. Ilir Martinin ka treguar seriozitet profesional për mbarëvajtjen e procesit të konkurseve për të mundur seleksionimin e vlerave më të mira të shfaqura nga kandidatët konkurrentë. Komisioni vlerësues është zgjedhur me transparencë dhe mbi bazën e profesionalizmit. Reagimi i marrë nga procesi i konkurrimit tregon se grupi i përzgjedhur i studentëve fitues në programet e studimit të kësaj Njësie Bazë përfaqëson kandidatët me më shumë të dhëna. Grupi i studentëve të përzgjedhur i përmbushi pritshmëritë së pari se u realizua

një proces mësimor cilësor dhe me nivel krijues me këtë grup studentësh, dhe së dyti se rezultatet që ata kanë treguar, si në programin Bachelor dhe në programin Master kanë qenë të larta. Procesi i suksesshëm i konkursit në programet e kësaj njësie Bazë u mundësua nga angazhimi i një numri pedagogësh të Njësisë Bazë Regji dhe Regji Filmi dhe TV. Ata kanë realizuar një fushatë promovuese me nxënësit maturantë në shkollat e mesme artistike dhe në shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm në Tiranë dhe qytete të tjera të Shqipërisë. Po ashtu duhet theksuar se edhe konkursi i zhvilluar për programin Master ishte i suksesshëm. Personeli Njësisë Bazë organizoi edhe këtu procesin e përzgjedhjes së kandidatëve duke kombinuar aplikimin e tyre me dosje dhe me intervistimin e aplikantëve për të mundësuar zgjedhjen e më të talentuarve.

5. Programet e studimit

Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & TV është pjesë e FAS të UART. Programet e studimit që ka realizuar Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & TV përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022 janë:

Cikli Studimit Bachelor	
1	Programi studimi Bachelor “REGJI”
2	Programi studimi Bachelor “REGJI FILMI DHE TV”

Cikli Studimit Master	
1	Programi studimit Master i Arteve në “REGJI TEATRI DHE SPEKTAKLI DHE MËSUESI”
2	Programi studimit Master i Arteve në “REGJI FILMI DHE TELEVISIONI DHE MËSUESI”

Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni, edhe përgjatë vitit shkollor 2021 – 2022, ka pasur në fokus reformimin e programeve të studimit. Ajo e orientoi punën e saj në rishikimin e programeve drejt disa objektivave, siç ishin :

- Rishikimi literaturës teorike e profesionale të syllabuseve
- Njohja më e mirë e tregut të punës dhe përshtatja programit me nevojat e tregut të punës
- Ofrimin e mundësisë për studentët për edukimin gjatë gjithë jetës;
- Krijimi raporteve më të drejta mes formimit teorik dhe praktik të studentëve;
- Promovimi programeve për tërheqjen e një numri sa më të madh studentësh;
- Krijimi mundësive për realizimin e një mësimdhënie sa më efektive dhe profesionale.

Njësia Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni ka punuar, bazuar në standardet e vendosura nga VKM-të apo Udhëzimet e MAS-it për reformimin e moduleve të lëndëve sinë programet Bachelor dhe në ato Master për të realizuar procesin e Akreditimit të këtyre programeve në fillim të vitit shkollor 2022-2023. Njësia Bazë realizoi Raportin e vlerësimit të Brendshëm dhe përgatiti dokumentacionin përkatës për këto programe (Master) në bazë të afateve kohore të vendosura.

6. Studentet

Njësia Bazë përgjatë aktivitetit të saj mësimdhënës, artistik e shkencor, ka pasur në qendër të vëmendjes pajisjen dhe zhvillimin e një procesi kreativ me studentët mbi njohuritë

krijuese e kërkimore në fushën e regjisurës. Ky objektivi është fokusuar me realizimin konkret të punëve krijuese në provime e projekte artistike. Një element që ka vazhduar të evidentohet në procesin e mësimdhënies, ka qenë rritja e motivacionit që ka shfaqur personeli akademik për të ndikuar në rritjen e interesimit të studentëve për lëndët speciale, lëndët e formimit profesional si dhe për lëndët teorike që i pajisin me kulturë të përgjithshme në shërbim të profesionit. Rritja e interesit të studentëve për procesin e mësimdhënien në këto lëndë është ndihmuar nga rritja profesionale e procesit të mësimdhënies që ka shfaqur personeli akademik i Njesisë Bazë përgjatë këtij viti shkollor. Personeli akademik i Njesisë Bazë, duke u përballur me kërkesat gjithnjë në rritje të studentëve për një mësimdhënie sa më efektive e bashkëkohore, ka nxitur rritjen e motivimit të tyre për të realizuar një proces mësimdhënie sa më bashkëkohor dhe me kërkesat që ka sot formimi aktorit në skenën evropian.

Studentët e programeve të studimit Aktrim kanë qenë pjesëmarrës edhe në disa aktivitete artistike duke realizuar disa produksione artistike të përbashkëta mes studentëve të programeve aktrim me studentët e degëve të tjera si aktrim, skenografi – kostumografi dhe koreografi, etj duke i kthyer bashkëpunimin në moto të studentëve në procesin krijues.

Temat e projekteve të Diplomave në programin Master dhe Bachelor kanë pasur në fokus disa nga veprat më të spikatura të autorëve më të mirë të dramaturgjisë botërore. Gjithashtu edhe temat teorike të diplomave të studentëve të programit Master kanë qenë cilësore dhe kanë trajtuar problematika teorike e krahasuese bashkëkohore në fushën regjisë dhe regjisë së filmit. Ky fakt vërehet edhe në vlerësimet e rezultateve të studentëve në këtë komponent të vlerësimit të tyre.

Edhe gjatë vitit shkollor 2021 – 2022, ka vazhduar rritja e numrit të studentëve të angazhuar në veprimtari artistike që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve artistike, përvojë kjo që duhet të rritet më tej sepse është një përvojë që ndihmon në formimin e tyre artistik.

SEKRETARIA MESIMORE

Sekretaria mësimore e Fakultetit të Artit Skenik është angazhuar të përmbushë me sukses gjithë detyrat që burojnë nga rregulloret, udhëzimet e veçanta e gjithçka tjetër që ka të bëjë me mirë administrimin e procesit mësimor. Ajo ka marre masat e duhura për të patur një korrektësi dhe administrim të saktë të gjithë dokumentacionit që ka të bëjë me këtë proces. Për këtë angazhim ka qënë në cilësinë e duhur dhe gjithçka ka shkuar në zbatim të gjithë akteve ligjore që kërkojnë zbatim për një proces sa të rregullt aq edhe me përgjegjësi. Ajo ka kryer detyra të ndryshme dhe po përcaktojmë disa prej tyre:

- Ka ndjekur procesin mësimor (për çdo ditë). Bashkëpunim.
- Relacion për paraqitjen e pedagogëve të Dekani, Sh. Departamenteve. Bashkëpunim.
- Ka ndjekur detyrat që lë Dekani, (njoftime, porosi, orar pritje etj.).
- Ka përcjellë shkresa në Njesisë Bazë, si dhe ndjekjen e tyre për të marrë përgjigjen që kërkohet dhe brënda afateve. (Vazhdimisht)
- Ka pritur, protokolluar dhe shpërndarë shkresa të ardhura nga Rektori, MASR. (Vazhdimisht)
- Ka bërë përcjellje shkresash të Dekanit për në Departament, Rektori, Senat, brënda afatit.
- Ka përcjell relacionet që janë kërkuar nga statistika. (Herë pas here).
- Ka bërë njoftime për mbledhje në Dekanat, mbajtja e proces-verbalit në mbledhje, si dhe zbardhja e tyre. (Vazhdimisht).

- Ka ndjekur detyrat dhe vendimet që dalin nga mbledhjet. Dërguar vendimet në Njësitë Bazë, përcjellje për në Rektorat, afishime në ambientet e Fakultetit etj.
- Ka kryer kontroll në regjistrat e pedagogëve për plotësimin e tyre në kohë dhe me rregullsi. (Vazhdimisht)
- Ka realizuar pritjen e Studentëve për sqarime të ndryshme. (Vazhdimisht)
- Ka pajisur sipas kërkesave të studentëve, me dokumente që u nevojiten. Herë pas here).
- Ka bashkëpunuar me Njësitë Bazë për të nxjerrë në kohë datat e provimeve, miratimi nga Dekani, afishimi për studentët, pajisja e pedagogëve me fletën përkatëse të datave të provimit. (Çdo sezon provimesh). (Përcjellja për në faqen e UART, Internet sektorit IT.
- Ka përgatitur fletët e provimit në tre sezonet (Dimri, Vera dhe Vjeshta).
- Ka ndjekur provimet, dhënien e fletës së provimit kryetarit të komisionit, pritjen e fletëve të provimit paraqitjen nga kryetari i komisionit pas çdo provimi, kontrollimin e tyre për rregullsi konform kërkesave. (Çdo sezon). (Bashkëpunim nxjerrje të dhënash për sistemin).
- Ka bërë regjistrimin e notave në regjistrin ditor, nxjerrja e të dhënave për secilin student.
- Ka për të bërë hedhjen e notave ne Amëz.
- Ka dërguar relacion në statistikë, në përfundimin e provimeve në çdo sezon.
- Ka përgatitur në bashkëpunim Suplementitn e notave për studentët që janë diplomuar.
- Ka dhënë vërtetime notash për studentë që kanë përfunduar vite të ndryshme studimi. (Herë pas here).
- Kam përgatitur dhe lëshuar vërtetime të ndryshme për studentë që kanë përfunduar studimet në vitet e mëparshme. (Herë pas here).
- Ka përpiluar dokumentacionin për regjistrimet për konkurim, për ciklin e parë të studimeve, Bachelor, ndjekja e zhvillimit të konkursit për pranimet e reja në Fakultetin e Artit Skenik. (Gusht –Shtator të çdo viti Akademik). Përcjellja në Rektorat dhe Statistikë.
- Ka kryer regjistrimin e kandidatëve fitues për secilin program studimi. (Shtator, Tetor. Nëntor, Dhjetor, miratuar nga MASR), në letër dhe onlain. Informacion në Rektorat-Statistikë, Internet sektorit IT.
- Ka bërë regjistrimin e kandidatëve fitues për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikulimit, me 12 karaktere, në regjistrin e Amzës (Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor, për vitin Akademik).
- Ka përpiluar dhe përcjellë tabelën me të gjitha të dhënat për studentët sipas shtojcës së MASR, për të marrë nr e matrikulimit për studentët e kursit të pare Bachelor në Sektorin e Statistikës për përcjellje në MASR, (pritja e listës së përfunduar nga MASR me Nr. Matrik. Hedhja nga ana e sekretares në regjistër e të dhënave).
- Ka përgatitur Librin me të gjitha gjenerimetet për kurset I-II-III-të që vazhdojnë studimet në fakultet për ciklin e parë. (Dorëzuar në Statistikë)
- Ka kryer regjistrimet e studentëve në Program të dytë studimi, në prag të fillimit të vitit Akademik), (dhënie informacioni në Rektorat, Statistikë, internet sektorit IT.
- Ka kryer regjistrime shitesa që vijnë të miratuar nga MASR në programe të ndryshme, dhënie informacioni në Rektorat dhe Statistikë, internet sektorit IT.
- Ka kryer regjistrim për konkurim kuota nga Trojet – Kosovë, Maqedoni, Mali Zi, Preshevë dhe Bujanovc. Si dhe nga komuniteti Romë dhe Egjiptian sipas Kuotave të miratuara.
- Ka ndjekur konkursin hap pas hapi, plotësim dokumentacioni, përgatitje liste të pikëve përfundimtare. Përcjellje informacioni Rektorat, Statistikë, internet sektorit IT.
- Ka kryer përgatitjen e formularëve tip që kërkon Statistika, dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Rinisë. (Tetor- Nëntor-Dhjetor).

- Ka kryer mbledhjen e mandat arkëtimeve që kanë kryere studentët për taksën e regjistrimit, etj., dhe rakordimi me degën e financës pranë Universitetit. Janar, Shkurt dhe Qërshor, Shtator, Tetor për studentët përsëritës, si dhe ata që fillojnë studime (në bashkëpunim)
 - Ka bërë regjistrimin e aplikantëve për “Master i Arteve”
 - Ka përgatitur listat për Master, tabelat e pikëve të ndarë me zëra sipas vendimeve dhe kritereve që janë propozuar nga Njësitë kryesore të FAS, miratuar nga Dekani.
 - Ka përgatitur listën përfundimtare me pikë sipas rendit zbritës për Master, afishimi në ambientet e Fakultetit, Relacion në Rektorat-Statistikë të Universitetit, internet sektorit IT
 - Ka kryer regjistrimin e studentëve fitues për “Master i Arteve”, dhënie informacioni në Rektorat dhe Sektorit të Statistikës pranë Universitetit të Arteve.
 - Ka përpiluar dhe percejellë tabelën me të gjitha të dhënat për studentët sipas shtojcës së MASR, për të marrë nr e matrikulimit për studentët e kursit të parë Master në Sektorin e Statistikës për përcjellje në MASR, (pritja e listës së përfunduar nga MASR me Nr. Matrik. Hedhja nga ana e sekretares në regjistër e të dhënave).
 - Ka përgatitur Librin me të gjitha gjenerimetet edhe për studentët që vazhdojnë “Master i Arteve” (Dorëzimi në Statistikë).
 - Ka përgatitur të dhënat për plotësimin e Diplomave dhe listën e notave me lëndë dhe kredite për ciklin e parë të studimeve “Bachelor” dhe ciklin e dytë të studimeve “Master i Arteve” në të gjitha programet e studimi të FAS. **(Nuk është bërë e realizueshme shpërndarja e diplomave për të dy ciklet, mungesë diplome. Jemi në pritje të diplomave),** bashkëpunim.
 - Ka bashkëpunuar me Njësitë Bazë, sistemim të Orarit të ri mësimor.
 - Ka realizuar përgatitjen e Rregjistrave Mësimorë për çdo lëndë dhe pedagog. (në fillim të vitit akademi)
 - Ka bashkëpunuar përditë me Zv/Rektorin, Burimet Njerëzore, Statistikën dhe Administratorin në Rektorat të UART, për realizimin e detyrave të dala nga bashkëpunimi.
 - Në raste të konkurimit dhe regjistrimit të kandidatëve të ciklit të parë Bachelor, ciklit të dytë Master i Arteve si dhe fituesit kam punuar me orë te zgjatura si dhe të shtunë dhe të dielë, datë dhe orë e përcaktuar nga zgjatja e kohës së konkursit.
 - Informacione, njoftime te ndryshme për studentet here pas here nga sistemi, bashkëpunim.
 - Informacion, njoftim pedagoqeve te FAS, për problem te ndryshme, bashkëpunim.
- Kam kryer detyra të ndryshme që dalin gjatë ditës, pritje, sqarime etj.

j) Të dhëna mbi studentët si:

i) numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit.

SEKRETARIA MESIMORE:

Të dhëna mbi studentët si:

i) numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit;

a) STUDENTË TË REGJISTRUAR PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020:

NË CIKLIN E PARË, BACHELOR.

Programi i studimit Aktrim, nr. Studentëve

<i>Nr.</i>	<i>Programi i Studimit</i>	<i>Viti akademik</i>	<i>Cikli i studimeve</i>	<i>Nr. studentëve</i>
1	<i>Aktrim</i>	<i>2021 – 2022</i>	<i>I tretë Bachelor</i>	<i>10</i>
2	<i>Aktrim</i>	<i>2020 - 2021</i>	<i>I dytë Bachelor</i>	<i>10</i>
3	<i>Aktrim</i>	<i>2019 - 2020</i>	<i>I parë Bachelor</i>	<i>10</i>
	<i>Totali</i>			<i>30</i>

<i>Nr.</i>	<i>Programi i Studimit</i>	<i>Viti akademik</i>	<i>Cikli i studimeve</i>	<i>Nr. studentëve</i>
1	<i>Regji</i>	<i>2021 - 2022</i>	<i>I tretë Bachelor</i>	<i>10</i>
2	<i>Regji</i>	<i>2020 - 2021</i>	<i>I dytë Bachelor</i>	<i>9</i>
3	<i>Regji</i>	<i>2019 - 2020</i>	<i>I parë Bachelor</i>	<i>9</i>
	<i>Totali</i>			<i>24</i>

<i>Nr.</i>	<i>Programi i Studimit</i>	<i>Viti akademik</i>	<i>Cikli i studimeve</i>	<i>Nr. studentëve</i>
1	<i>Skenografi-Kostumografi</i>	<i>2021 - 2022</i>	<i>I tretë Bachelor</i>	<i>10</i>
2	<i>Skenografi-Kostumografi</i>	<i>2020 - 2021</i>	<i>I dytë Bachelor</i>	<i>10</i>
3	<i>Skenografi-Kostumografi</i>	<i>2019 - 2020</i>	<i>I parë Bachelor</i>	<i>9</i>
	<i>Totali</i>			<i>29</i>

<i>Nr.</i>	<i>Programi i Studimit</i>	<i>Viti akademik</i>	<i>Cikli i studimeve</i>	<i>Nr. studentëve</i>
1	<i>Koreografi</i>	<i>2021 - 2022</i>	<i>I tretë Bachelor</i>	<i>12</i>
2	<i>Koreografi</i>	<i>2020 - 2021</i>	<i>I dytë Bachelor</i>	<i>12</i>
3	<i>Koreografi</i>	<i>2019 - 2020</i>	<i>I parë Bachelor</i>	<i>15</i>
	<i>Totali</i>			<i>39</i>

<i>Nr.</i>	<i>Programi i Studimit</i>	<i>Viti akademik</i>	<i>Cikli i studimeve</i>	<i>Nr. studentëve</i>
1	<i>Regji Filmi & TV</i>	<i>2021 - 2022</i>	<i>I tretë Bachelor</i>	<i>9</i>
2	<i>Regji Filmi & TV</i>	<i>2020 - 2021</i>	<i>I dytë Bachelor</i>	<i>10</i>
3	<i>Regji Filmi & TV</i>	<i>2019 - 2020</i>	<i>I parë Bachelor</i>	<i>8</i>
	<i>Totali</i>			<i>27</i>

DIPLOMUAR NË BACHELOR:

- Programi i studimit Aktrim, nr. 10 Studentëve **Diplomuar 9 studentë**
- Programi i studimit Regji, nr. 11 Studentëve **Diplomuar 6 studentë**
- Programi i studimit Skenografi dhe Kostumografi, nr. 13 Studentëve **Diplomuar 9 studentë**
- ✓ Programi i studimit Koreografi, nr.13 Studentëve **Diplomuar 6 studentë**
- ✓ Programi i studimit Regji Filmi dhe Televizioni, nr.11 Studentëve **Diplomuar 5 studentë**

TOTALI 35 STUDENTË

b) STUDENTË TË REGJISTRUAR PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020:
NË CIKLIN E DYTË, MASTER NË ARTE.

Nr.	Programi i Studimit	Viti akademik	Cikli studimeve	Nr. Student.
1	Aktrim dhe Mësuesi	2021 - 2022	I parë Master	11
2	Aktrim dhe Mësuesi	2020 - 2021	I dytë Master	6
	<i>Totali</i>			17

Nr.	Programi i Studimit	Viti akademik	Cikli i studimeve	Nr. Student.
1	Regji Teatri -Spektakli& Mësuesi	2021 - 2022	I parë Master	7
2	Regji Teatri -Spektakli& Mësuesi	2020 - 2021	I dytë Master	8
	<i>Totali</i>			15

Nr.	Programi i Studimit	Viti akademik	Cikli i studimeve	Nr. Student.
1	Skenografi-Kostumografi Mësuesi	2021 - 2022	I parë Master	10
2	Skenografi-Kostumografi Mësuesi	2020 - 2021	I dytë Master	7
	<i>Totali</i>			17

Nr.	Programi i Studimit	Viti akademik	Cikli i studimeve	Nr. Student.
1	Koreografi dhe Mësuesi	2021 - 2022	I parë Master	8
2	Koreografi dhe Mësuesi	2020 - 2021	I dytë Master	8
	<i>Totali</i>			16

Nr.	Programi i Studimit	Viti akademik	Cikli i studimeve	Nr. Student.
1	Regji Filmi & TV	2021 - 2022	I parë Master	7
2	Regji Filmi & TV	2020 - 2021	I dytë Master	6

	<i>Totali</i>			13
--	---------------	--	--	----

DIPLOMUAR NË MASTER I ARTEVE:

Programi i studimit Aktrim dhe Mësuesi,

Diplomuar 6 studentë

Programi i studimit Regji Teatri dhe Spektakli dhe Mësuesi

Diplomuar 8 studentë

Programi i studimit Skenografi dhe Kostumografi dhe Mësuesi

Diplomuar 4 studentë

Programi i studimit Koreografi dhe Mësuesi

Diplomuar 7 studentë

Programi i studimit Regji Filmi dhe Televizioni dhe Mësuesi

Diplomuar 6 studentë

TOTALI 31 STUDENTË

ii) Numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioriteteve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore.

iii) Numrin e studentëve të shkëlqyer;

Studentë të shkëlqyer në FAS, nr. studentë.

iv) Numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen;

Studentë të çregjistruar apo transferuar për vitin akademik 2021-2022:

a). në ciklin e parë, BACHELOR, nuk ka.

b). në ciklin e dytë, MASTER NË ARTE, student.

c). Studentë të çregjistruar apo transferuar për vitin akademik 2021-2022:

v) numrin e studentëve që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit;

1. Studentë që kanë fituar bursa....

2. Studentë që janë përjashtuar nga bursat janë studentë.

3. Studentë që kanë reduktim të tarifave të shkollimit janëstudentë.

vi) pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre;

Nuk kemi pasur studentë në aktivitete ndërkombëtare.

vii) Përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen;

VITI AKADEMIK 2021-2022

Programi i ciklit të parë të Studimit Aktrim në Bachelor

Nr.	Programi i studimit në Bachelor	Nota mesatare	Kalueshmëria %
1	Aktrim viti I (2019 – 2020)	7.39	100 %
2	Aktrim viti II (2020 – 2021)	7.5	100 %

3	Aktrim viti III (2021 – 2022)	7.9	90 %
	Mesatarja si program studimi	7.59	96.66 %

Programi i ciklit të parë të Studimit Regji në Bachelor

Nr.	Programi i studimit në Bachelor	Nota mesatare	Kalueshmëria %
1	Regji viti I (2019 – 2020)	7.6	100 %
2	Regji viti II (2020 – 2021)	7.9	90 %
3	Regji viti III (2021 – 2022)	7.9	54.54 %
	Mesatarja si program studimi	7.8	81.5 %

Programi i ciklit të parë të Studimit Skenografi dhe Kostumografi në Bachelor

Nr.	Programi i studimit në Bachelor	Nota mesatare	Kalueshmëria %
1	Skenografi-Kostumografi viti I (2019-2020)	7.83	100 %
2	Skenografi-Kostumografi viti II (2020-2021)	8.6	81 %
3	Skenografi-Kostumografi vitiIII(2021-2022)	8	100 %
	Mesatarja si program studimi	8.14	93.6 %

Programi i ciklit të parë të Studimit Koreografi në Bachelor

Nr.	Programi i studimit në Bachelor	Nota mesatare	Kalueshmëria %
1	Koreografi Viti I (2019 – 2020)	7.6	90 %
2	Koreografi Viti II (2020 – 2021)	7.76	100 %
3	Koreografi Viti III (2021 – 2022)	8.4	83 %
	Mesatarja si program studimi	7.92	9.1 %

Programi i ciklit të parë të Studimit Regji Filmi dhe Televizioni në Bachelor

Nr.	Programi i studimit në Bachelor	Nota mesatare	Kalueshmëria %
1	Regji Filmi dhe TV viti I (2019 – 2020)	8.8	90 %
2	Regji Filmi dhe TV viti II (2020 – 2021)	7.75	80 %
3	Regji Filmi dhe TV viti III (2021 – 2022)	8.6	90 %
	Mesatarja si program studimi	8.3	86.6 %

Nota mesatare dhe kalueshmëria si Fakultet në programet e ciklit të parë:

Nr.	Programi i studimit Bachelor	Nota mesatare	Kalueshmëria %
1	Aktrim	7.59	96.66 %
2	Regji	7.8	81.5 %
3	Skenografi Kostumografi	8.14	93.6 %
4	Koreografi	7.92	9.1 %
5	Regji Filmi dhe TV	8.3	86.6 %
	Mesatarja BACHELOR si FAS	7.95	

Programi i ciklit të dytë të Studimit Aktrim dhe Mësuesi në Master

Nr.	Programi i studimit Master	Nota mesatare	Kalueshmëria %
1	Aktrim dhe Mësuesi I (2020 – 2021)	7.8	100 %
2	Aktrim dhe Mësuesi II (2021 – 2022)	7.6	100 %
	Mesatarja si program	7.7	100 %

Programi i ciklit të dytë të Studimit Regji Teatri dhe Spektakli dhe Mësuesi në Master

Nr.	Programi i studimit Master	Nota mesatare	Kalueshmëria %
1	Regji Teatri -Spektakli dhe Mësuesi I	8.5	100 %
2	Regji Teatri -Spektakli dhe Mësuesi II	8	90 %
	Mesatarja si program	8.2	95 %

Programi i ciklit të dytë të Studimit Skenografi- Kostumografi dhe Mësuesi në Master

Nr.	Programi i studimit Master	Nota mesatare	Kalueshmëria %
1	Skenografi -Kostumografi dhe Mësuesi I	7.6	25 %
2	Skenografi -Kostumografi dhe Mësuesi II	8.1	100 %
	Mesatarja si program	7.85	62.5 %

Programi i ciklit të dytë të Studimit Koreografi dhe Mësuesi në Master

Nr.	Programi i studimit Master	Nota mesatare	Kalueshmëria %

1	Koreografi dhe Mësuesi I	8.5	90 %
2	Koreografi dhe Mësuesi II	7.75	100 %
	Mesatarja si program	8.1	95 %

Programi i ciklit të dytë të Studimit Regji Filmi dhe Televizioni dhe Mësuesi në Master

Nr.	Programi i studimit Master	Nota mesatare	Kalueshmëria %
1	Regji Filmi &TV dhe Mësuesi I	9.1	100 %
2	Regji Filmi &TV dhe Mësuesi II	8.2	100 %
	Mesatarja si program studimi	8.6	100 %

Nota mesatare dhe kalueshmëria si Fakultet në programet e ciklit të dytë:

Nr.	Programi i studimit Master	Nota mesatare	Kalueshmëria %
1	Aktrim dhe Mësuesi	7.7	100 %
2	Regji Teatri Spektakli dhe Mësuesi	8.2	95 %
3	Skenografi - Kostumografi dhe Mësuesi	7.85	62.5 %
4	Koreografi dhe Mësuesi	7.75	95 %
5	Regji Filmi dhe TV dhe Mësuesi	8.6	100 %
	Mesatarja Master si FAS	8.02	90.5 %

PROCESI ADMINISTRATIV E FINANCIAR

Për prioritetet në kërkesat për investime kemi patur parasysh:

- të plotësojmë nevojat tepër urgjente që ka sot Fakulteti i Artit Skenik për një zhvillim normal të mësimit dhe njëkohësisht të përforcojmë infrastrukturën e mësimdhënies në ato ambiente ku është më e domosdoshme, (studiot dhe klasat e fakultetit, salla e madhe e koncerteve dhe salla black-box, atelietë e skenografisë, sallat e lëvizjes skenike dhe koreografisë si dhe palestra e fakultetit, Kompletimi me Paisje&Orendi, Laboratore Mesimore e.t.j),
- Kërkesat më prioritare, në zërin Investime do të ishin dhe mbeten:
 1. Rikonstruksion i godinës ekzistuese të FASkenik (godina D dhe C. Në godinën C gjëndet edhe laborator i "Salla Black-Box" i cili përdoret nga studentët e dramës, regjisë, skenografisë, koreografisë dhe regjisë së filmit),
 2. Kompletim me pajisje & orendi, klasa, studio & atelje e zyra të administratës së fakultetit, (një kërkesë e vazhdueshme për një situatë aktuale mund të thuhet edhe mjerane me mangësi të theksuara),
 3. Sistemi i ngrohje ftohjes në ambientet e FAS.
 4. Investime në rrjetin kompjuterik dhe informatik,

5. Kompletimi i sallës B-Box me infrastrukture mbështetëse për adaptimin në laborator regji&filmi, (dokumenti teknik i gatshëm)
6. Blerje literature e përditësuar për programet e studimit të FAS në fondin e Bibliotekës.
7. Investim për laboratorët e programit të studimit Regji Filmi dhe Televizioni.
8. Investim për realizimin e laboratorit të kostumografisë. Materialet për këtë laborator janë në proces.
9. Investim në rregullimin e tarracës të fakultetit.
10. Investim në sistemin e ndriçimit (për punë) të ambienteve si: studio, klasa, Atelieron e Skenografi-Kostumografi, sallën e Koreografisë, klasat e Regji Filmi dhe Televizioni, Palestra, zyra, koridore.
11. Investim total në **sallën e madhe Koreografi**.

Ecuria e procesi administrativ e financiar:

Punonjësit e administratës së FAS kanë qënë në shërbim të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Gjatë këtij viti janë realizuar detyrat përkatëse nga çdo punonjës i administratës. Laborantët dhe punonjësit e tjerë kanë bashkëpunuar gjatë periudhës së provimeve dhe konkurs, për mbarëvajtjen e tyre në realizim dhe paraqitjen sa më dinjitoze. Ata kanë qënë në dizpozicion për çdo nevojë dhe kërkesë të studentëve në më se tridhjetë shfaqje provimesh dhe diplomash gjatë 2 semestreve të vitit akademik 2021-2022, duke realizuar dekoret dhe pajisjen me veshje të garderobës dhe rekuizitë. Janë bërë riparime të ndryshme në studio dhe salla gjatë të gjithë periudhës, ku gjithë secili ka dhënë kontributin e tij.

Janë sistemuar ambjentet ku janë zhvilluar konkurset dhe përgatitjet për fillimin e vitit akademik 2022-2023

Fakulteti i Artit Skenik, si pjesë përbërëse e UART-së, me grupin e punës përkatës ku bënin pjesë anëtarë nga tre departamentet si dhe Zv/Dekani dhe Kryetarja e degës e fakultetit, studioj dhe punoi me vemëndjen e duhur për të paraqitur në Rektorat kërkesat të cilat bëjnë të mundur realizimin e një procesi mësimor-krijues normal.

Të tre departamentet kanë studiuar me imtësi gjendjen aktuale në pikëpamje të infrastrukturës dhe pajisjeve laboratorike, planin mësimor, numrin e stafit pedagogjik e administrativ, numrin e studentëve të ndarë sipas programeve të studimit e më pas kanë dalë në disa konkluzione e kërkesa konkrete.

Ky projekt-buxhet i hartuar nga FAS përmban në vetvete kërkesa thelbësore që kanë të bëjnë me momente esenciale të zhvillimit të fakultetit siç janë :

- **Investimet**
- **Bazë materiale** (për laboratorët e departamenteve)
- **Materiale të ndryshme** (kancelari, elektrike, hidraulike, mjete pastrimi etj)
- **Mbështetje për praktikat mësimore**

Projektet mësimore e krijuese të studentëve të tre departamenteve në FAS, brenda një viti akademik kapin një shifer prej rreth 60 (gjashtëdhjetë) të tillë. Pra, programet e studimit të Aktrimit, Regjisë, Skenografi-Kostumografi, Koreografisë e Regjisë së Filmit dhe Televizionit, kanë sipërmarrje konkrete me projekte krijuese, të cilat janë të fiksuara qartazi në planin mësimor të miratuar në Senatin e UART dhe çdo shpenzim financiar që ka të bëjë me këto projekte është i mbështetur pikërisht mbi këtë plan. Domosdoshmëria e plotësisimit me bazë materiale të laboratorëve të këtyre departamenteve përbën një sfidë për Universitetin tonë.

Ne mendojmë se kurrsesi nuk duhet të ulim cilësinë e projekteve krijuese me studentët, pikërisht me argumentin se nuk kemi mbështetje financiare. Kërkesat e pedagogëve dhe

studentëve për realizimin e projekteve nuk duhet të zbresin në nivelin minimal edhe pse ne shpesh japim porosi që në kërkesat e tyre për mbështetje me dekore e mjete të tjera ata të jenë të kursyer. Kjo gjë do të ishte një zgjidhje oportune ditore, por me pasoja të mëdha në edukim profesional të studentëve tanë për nesër.

Padyshim që ne jo çdo gjë do të duhet ta kërkojmë nga buxheti i UART. Ne do të përpiqemi për të aplikuar me projekte konkrete edhe duke shfrytëzuar mundësi të tjera që ofrohen si FZHR etj., por të gjithë e dimë se realisht edhe këto mundësi aplikimi janë të vogla.

Ne duam të trajtojmë së bashku dhe një moment tjetër të rëndësishëm. Dy nga laboratorët kryesorë ku zhvillojnë procesin e tyre metodik e krijues studentët e të gjitha programeve tona janë: Salla e Madhe e shfaqjeve dhe Salla Black-Box. Vendosija e tyre në parametra normal funksionimi do e ndihmonte shumë këtë proces. Për momentin Salla e Madhe është në rikonstruksion dhe nuk mund të përdoret, dhe nënvizojmë faktin se në Sallën Black-Box ne zhvillojmë dhe proces mësimor të përditshëm dhe në vitet në vijim ajo do të shfrytëzohet maksimalisht, pra edhe më shumë se aktualisht nga fakulteti për procesin mësimor e krijues, kjo si rezultat i mungesës së ambienteve. E gjithë kjo ngarkesë padyshim që ka amortizimin e vet, e si rezultat është nevojë vendosja e pajisjeve të reja.

Disa nga kërkesat tona emergjente janë plotësuar si:

- **Riparimi i kondicionerëve (një studio 2 Regji dhe një në Sallën e Vogël Koreografi).**
 - **Izolimi i tarracës në fakultet.**
 - **Riparimi i dyshemesë në Sallën e madhe Koreografi.**
- Janë akoma disa emergjenca që ne do të donim ti parashtronim për zgjidhje pranë rektoratit si:*
- **Rikonstruksioni tërësor i sallës së koreografisë (tek godina e muzikës)**

Disa nga kërkesat tona të mëparshme janë në proces realizimi, si:

- **Montimi i pajisjeve Audio-Vizuale në 2 Studiot Akrim 2, Regji 2.**
- **Rikonstruksioni i tualeteve të studentëve (kati i dytë).**

Si përfundim ne jemi të bindur se kërkesat tona përbëjnë një domosdoshmëri për një proces të rregullt cilësor e bashkëkohor. Po ashtu mendojmë se plotësimi i tyre garanton cilësinë dhe funksionimin normal të institucionit tonë. E kundërta do të ndodhte nëse ne do të vazhdojmë të qëndrojmë në këto parametra. Pra, do të cenohej cilësia si rezultat i pamjaftueshmërisë së fondeve.

Ne ofrojmë në çdo moment bashkëpunimin tonë me gjithë sektorët ndihmës të rektoratit për gjithçka ka të bëjë me përgatitjen e projekteve dhe me mundësinë e ekspertizës profesionale me pedagogët tanë.

Në mbyllje, do të theksonim se Fakulteti i Artit Skenik do të jetë gjithmonë i gatshëm për të ecur me ritmet e ndryshimeve, në rritje të efektueshmërisë së punës me një metodikë sa më të pasur dhe motivim më të lartë të stafit pedagogjik e studentëve, përmes një procesi sa më interaktiv, gjë që e kërkon rritja e cilësisë së fakultetit tonë.

Studentë që kanë përfituar Bursë, Përjashtim nga Tarifa Vjetore (Bachelor) dhe Reduktim Tarife (Master) për vitin akademik 2021-2022 në FAS

1.	Studentë që kanë përfituar Bursë. (Bachelor)	27
2.	Studentë që kanë përfituar Përjashtim Tarife. (Bachelor)	28

3.	Studentë që kanë përfituar Reduktim Tarife. (Master)	23
----	--	----

Mbi analizën e vitit akademik 2021-2022 të Fakultetit të Arteve të Bukura

Qëllimi dhe objektivat e veprimtarisë mësimore shkencore e artistike në Departamentin e Pikturës.

Fakulteti i Arteve të Bukura, Departamenti i Pikturës, për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij gjatë vitit shkollor 2021 - 2022, ka pasur një angazhim tepër profesional në aspektin pedagogjik në shërbim të studentëve si dhe në harmonizim të plotë për kualifikimin e tyre në aktivitetet artistike.

Vëmendja kryesore ka qënë tek rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet adaptimit të njohurive bashkëkohore në procesin pedagogjik, duke përfshirë dhe realizimin cilësor të projekteve artistike dhe shkencore në fushën e arteve pamore. Departamenti i Pikturës ka gërshetuar eksperiencën e gjatë pedagogjike të stafit akademik me tendencat më të fundit të artit, duke u bërë lider i prurjeve bashkëkohore që konturojnë qartë jo vetëm realizimin e objektivave për arritjen e misionit tonë, por gjithashtu evidentojnë institucionin si qëndra kryesore e arsimit të lartë në fushën e arteve pamore, me prezantime studentore të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me orientim drejt punësimit në tregun e punës.

FAB-DP, për vitin shkollor 2021 - 2022 në planin e objektivave strategjike, ka ndërthurur planet mësimore me eksperiencat pedagogjike ndërkombëtare që lidhen me programin ERASMUS +, duke sjellë risi informacioni dhe analize për t'u përshtatur më së miri me strukturat e shkollave europiane, në shkëmbimin ndër universitar ndërmjet pedagogëve dhe studentëve.

Fokus i rëndësishëm ka qënë përshtatshmëria e njohurive akademike në funksion të aktivitetit kulturor dhe artistik, që vjen si rezultat i informacioneve të detajuara e të trajtuara nëpërmjet stafit pedagogjik në programet përkatëse të studimit, duke i dhënë fakultetit tonë jo vetëm vlera me rëndësi akademike, por edhe funksionin e një qëndre të hapur dialogu dhe komunikimi për edukimin artistik.

1. Veprimtaria Mësimore

Për vitin akademik 2021-2022, procesi mësimor ka nisur më 18 Tetor 2021 dhe ka përfunduar në 17 qershor 2021.

Pushimet e dimërit filluan me datë 24 dhjetor 2021.

Semestri i parë filloi më 18 tetor 2021 dhe u mbyll me 11 shkurt 2021.

Semestri i dytë filloi më date 01 mars 2021 dhe u mbyll më 17 qershor 2021.

Sezonet e provimeve, përgjithësisht, janë zhvilluar në përputhje me strukturën e vitit akademik. Ato filluan me sezonin e dimrit me dt. 15.02.2021.

a. Mbi provimet e mbartura

- Për provimet e mbartura të cilat duket se paraqesin një numër të kufizuar studentësh, pedagogët respektivë respektuan datat dhe kohen e përcaktuar, duke garantuar një mbarëvajtje sa më të mirë të gjithë procesit të provimit, si në rastet e zhvillimit të tij me shkrim, me gojë apo e kombinuar.

Në rastet kur ato do e kalonin numrin e përcaktuar të studentëve, u rekomandua ndarja e tyre në grupe. Kjo solli zhvillimin e provimit në dy orare të ndryshme, por brenda të njëjtës datë.

b. Mbi shikimin e punëve në atelier

- Për shikimin e detyrave në atelier u respektua ndarja e studentëve në grupe jo më mëdha se 5 studentë, të cilët u vendosën në orare të ndryshme psh. Grupi 1 ora 9:30 deri më 10:30, Grupi 2 ora 10:30 deri më 11:30, dhe kështu me rradhë. Duke pasur parasysh që grupi më i madh i studentëve nuk e kalon nr. 18 studentë. (Konsiderojmë këtu që virusi Covid-19

është akoma aktiv). Kjo u bë për të minimizuar mundësinë e infektimit të studentëve në ambientet e brendshme të fakultetit, në bashkëpunim sa më rigoroz të stafit pedagogjik dhe administratës së Fakultetit. Për çdo nevojë nuk u hezitua të angazhohej stafi ndihmës i administratës, apo dhe laborantët respektiv.

- Gjatë kohës së shikimit të punëve në atelier u bë kujdes për respektimin e orareve, si dhe marja në analizë një pas një të studentëve. Marja në analizë, u bë në bazë të ndarjeve lëndore si dhe me angazhimin e komisioneve përkatëse. Me përfundimin e vlerësimit të studentëve, komisioni, në presencë të grupit të studentëve, analizoi në përgjithësi ecurinë e programit mësimor dhe dha orjentime për vazhdimësinë.
- Përgjatë gjithë procesit u respektuan maksimalisht të gjitha rregullat e përcaktuara nga Njësia Kryesore dhe ajo Bazë.

I gjithë procesi u mbikëqyr nga afër nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe u përfundua me një raport të shkruar nga koordinatorët e caktuar për çdo Program Studimor. Raporti përmbante një përshkrim të zhvillimit të procesit dhe problematikave që dolën për shkak të zhvillimit të mësimit dhe se si mund të vazhdohet më tej për të ngushtuar sado pak handikapet e lindura gjatë këtij procesi.

Ndërkohë rikujtoj që semestri i dytë rifilloi me dt. 01.03. 2021 dhe përfundoi me dt. 17.06.2021.

Që nga përfundimi i periudhës pandemike, duhet të vlerësojmë se orët mësimore, me vendim të veçantë të Ministrisë së Arsimit Rinisë e Sporteve, u ndryshuan, nga 60 min. në 50 min.

“Fakultetet e UART të organizojnë konsultime në lëndët speciale të cilat janë provime në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Konsultimet të zhvillohen në klasa, studio, atelie apo salla në mënyrë individuale ose dhe në grupe të vogla studentësh në orarin e përcaktuar nga departamenti përkatës.”

Si rezultat duke filluar nga data 17 maj 2021 u realizuan këto masa:

1. Filloi, ose u intensifikua procesi i konsultimeve në lëndët e atelierit, proces që kishte filluar disa muaj më parë, por që me afrimin e fundit të sezonit (dt. 18 qershor 2021) u bë i domosdoshëm për përfundimin me sukses të vitit shkollor.
2. U zhvilluan në klasa, atelie dhe laboratorë konsultime në një numër të kufizuar studentësh, që garantojnë një mbarvajtje sa më të mirë të gjithë procesit. Në rastet kur ato i kaluan numrin e 10 studentëve u rekomandua ndarja e tyre në 2 grupe, të cilët mund ta zhvillojnë konsultimet në dy orare të ndryshme.
3. Për çdo specifikë, secili pedagog përcaktoi vetë mënyrën më të përshtatshme për zhvillimin e konsultimeve, bazuar në veçantinë e programit dhe produktit final. Për çdo paqartësi pedagogët u konsultuan me Drejtuesin e Njesisë Bazë.
4. Lëndët teorike vazhduan dhe mbyllën procesin e leksioneve në bazë të rregullave të përcaktuara më parë.

Mbi sezonin e provimeve:

- U publikuan datat e provimeve të mbartura dhe atyre përfundimtare të vitit akademik 2021-2022.

- Për provimet teorike, si të mbartura, apo ato përfundimtare pedagogët respektivë përcaktuan modelin më të përshtatshëm për zhvillimin me sukses të procesit.

- Në rastet kur provimi u zhvillua me shkrim në Lektorium u morën masa që numri i studentëve të mos i kalojnë 20-25 studentëve, dhe secili prej tyre të vendoset në një rresht më vete në formë të kryqëzuar në skajet e rreshtit.

Mbi shikimin e punëve në atelier

Sezoni i provimeve të verës në nivelin Bachelor u hap në dt.19 qershor ndërsa diplomimi u zhvillua në dt. 5 korrik 2021.

Sezoni i provimeve të verës në nivelin Master u hap në dt.15 qershor ndërsa diplomimi u zhvillua në dt. 8-13 korrik 2021.

Procesi në tërësi u zhvillua normalisht.

Ndërkohë me vendim të Senatit të UA me nr. 11, dt. 21.06.2021 mbi “Disa ndryshime në rregulloren e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe rregulloren e Ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master në UART për vitin akademik 2020-2021.

Për krijimin e mundësisë të dhënies së provimeve për të gjitha lëndët duke përfshirë dhe ato speciale në tre sezone u bë e mundur hapja e Sezonit të Vjeshtës:

Pas shpalljes së datave, procesi i provimeve dhe diplomimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe e Ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master u zhvillua me sukses në datat 12 - 30 shtator 2021 sipas kalendarit të strukturës vjetore.

2. Ngarkesat dhe orët mësimore

Me fillimin e vitit akademik 2021-2022, Njësia Bazë e Pikturës ka realizuar shpërndarjen e ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar dhe në vazhdimësi të atij me kohë të pjesëshme dhe afat të caktuar. Ngarkesa mësimore për vitin akademik 2021-2022 në Njësinë Bazë të Pikturës ka rezultuar një total prej 4500 orësh.

Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*. Përsa i përket stafit akademik me kohë të pjesëshme, konstatohen raste me tejkalim norme dhe këto shkojnë deri në 50% sipas udhëzimit të sipërpërmendur.

Departamenti i Pikturës - DP

Në vitin akademik 2021-2022, Departamenti i Pikturës në FAB ka vazhduar punën akademike për zbatimin e programeve përkatëse të studimit. Duke patur parasysh qëllimet dhe objektivat kryesore të këtyre programeve, stafi pedagogjik ka punuar me përkushtim dhe seriozitet.

Në këtë vit akademik u thellua kërkimi artistik dhe eksperimentimi akademik, në mbështetje të zhvillimeve dhe risive bashkëkohore të skenës artistike ndërkombëtare. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe marrëdhëniet dhe eksperiencat e ndryshme me shkolla dhe personalitete jashtë kufijve, vizitat dhe workshopet e organizuara nga dekanati dhe fakulteti në përgjithësi, por edhe nga Departamenti në veçanti.

Këtë vit akademik, nga bashkëpunimi i universitetit tonë me partnerët evropianë, italianë e spanjollë, nëpërmjet Programit Erasmus + REACH u mundësua pajisja me mjete të reja laboratorike moderne e Programit të Pikturës Monumentale, Departamenti i Pikturës.

Për vitin akademik 2021 – 2022, Departamenti i Pikturës diplomoi 44 studentë në të dy ciklet e studimit, me një paraqitje të kënaqshme dhe rezultate të mira artistike.

Sa i takon punës në atelje dhe realizimit të detyrave e projekteve të dhëna, në përgjithësi mund të thuhet se janë realizuar objektivat e paracaktuara në nivel të kënaqshëm, por gjithsesi edhe këtë vit akademik, disa mangësi në infrastrukturën mbështetëse kanë tendencën të kthehen në mangësi kronike, për të cilat duhen marrë masat e nevojshme që të përmbyllen. Të tilla do të ishin:

- mungesa e mjediseve optimale për punën në klasë, në programin e studimit Pikturë Kavaleti, si pasojë e numrit të madh të studentëve për një total prej 34 studentësh në Ciklin e Parë dhe 15 për Ciklin e Dytë;
- cilësia e modeleve, një problem i kahershëm, që ka të bëjë me pagesën e ulët të modeleve;

- mungesa e laboratorit të Pikturës së Kavaletit, e një mjedisi të dytë mësimor, apo suportit teknik dhe material për lëndën e Teknologjisë së Pikturës dhe atë të Imazhit Digjital;

Këto mangësi i kemi evidentuar prej kohësh dhe presim të fillojnë të përmbushen, në shërbim të rritjes së mëtejshme të interesit të studentëve për mësimin dhe cilësisë së mësim dhënies në përgjithësi.

Po kështu, kërkohet një angazhim më këmbëngulës i organeve drejtuese të Fakultetit sa i takon realizimit dhe mbështetjes financiare për praktikat mësimore Brenda vendit, si edhe për vizita të shkurtra mësimore në vendet fqinje.

Si rezultat:

Me gjithë përpjekjet serioze të stafit akademik për realizimin e programeve të studimit, mbetet ende mjaft punë për tu bërë në drejtim të mbështetjes logjistike dhe bazës materiale, në zbatim të detyrimeve dhe kritereve që kërkon Procesi i Bolonjës.

ngarkesa mesimore vjetore për personelin akademik në institucionet e arsimit të lartë.

Analizë e Departamentit të Pikturës në Fakultetin e Arteve të Bukura për vitin akademik 2020-2021, mbështetur në ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe urshërësës nr. 29, date 10.09.2018.

- Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor brënda IAL është:

- | | |
|-----------------------|----------|
| a) Kategoria Profesor | 140 orë; |
| b) Kategoria Lektor | 165 orë; |
| c) Asistent Lektor | 195 orë; |

Çdo orë e realizuar në auditor mbi këtë përcaktim është orë suplementare e cila përllogaritet sipas koeficientëve dhe paguhet e plotë nga IAL-të. Orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200 orë. Në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë she miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulojë dhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë. **Udhëzim Nr. 29, date 10.09.2018**

- Personeli akademik me kohë të pjesëshme mund të mbulojë ngarkesën vjetore në auditor:

a) Kategoria Profesor	120 orë;
b) Kategoria Lektor	120 orë;
c) Asistent-Lektor	120 orë.

Personeli akademik me kohë të pjesëshme nuk mund të ketë orë suplementare. Ky personel paguhet deri në ngarkesën maksimale të përcaktuar në auditor.

Programet e Studimit

Viti i I-rë / Bazat e Formimit të Përgjithshëm.

Viti i bazave të përgjithshme është vit idetyrueshëm për studentët që sapa hyjnë në Fakultetin e Arteve të Bukura, duke pasuruar njohuritë e tyre fillestare dhe zhvilluar kreativitetin artistik.

Teoria e Ngjyrës

Nëpërmjet “Teorisë së Ngjyrës” studenti duhet të njohë dhe të asimilojë bazën e gramatikës dhe të sintaksës së ngjyrës. Ky proces trajton shumë nga problemet e ngjyrës që pozojnë para njeriut dhe pictures, si në planin praktik e ngushtësisht profesional dhe në atë metodik e intelektual.

Nëpërmjet njohurive që merr, studentit i krijohet mundësia të mos ta konceptojë ngjyrën si një realitet tërësisht individual, por si një unitet të pa kontestueshëm, që lind nga eksperiencia pedagogjike dhe “zbulimet” artistike, dy tendenca themelore në formimin e personalitetit. Duke marrë këto njohuri, studenti, ekuilibrin objektiv të ngjyrës e modelon me koshiencën e një ekuilibëri subjektiv dhe hedh hapin e parë në projektimin e vet dhe të laboratorit të tij krijues.

Vëllimi në Hapësirë

Qëllimi i këtij kursi është të familjarizojë studentët me marrëdhënien estetike të vëllimit dhe hapësirës në konceptin 3-dimensional. Ky program ka objektiv themelor që të zhvillojë dhe të rrisë kapacitetin e komunikimit të studentit në përmjet gjuhës artistike (imazhit). Ky program realizohet nëpërmjet ushtrimeve, detyrave, projekteve dhe bisedave teorike. Bisedat teorike kanë për qëllim që studentët të përvetësojnë konceptet bazë të kompozimit (elementët e tij, gjuhën vizuale).

Kompozimi dhe Teoria e Ngjyrës

Lënda zhvillohet në vitin e parë dhe merr përsipër të ofrojë njohuritë fillestare mbi mundësitë që ofron kompozimi në procesin krijues (detyra, projekte).

Me anë të leksioneve dhe shembujve nga historia e artit bashkëkohor, i prezantohen studentit mundësitë dhe cilësitë që mbart lënda, si: masa, hapësira, figuracioni, ritmi, dimensionimi.

Qëllimi ynë është që të vendoset një process komunikimi krijues me studentët, ku lënda shtjellohet hap pas hapi dhe mbështetet mbi propozimet e projektet që ata sjellin. Gjithashtu, lënda synon të nxisë qëndrimet personale mbi etikën dhe estetikën ndaj kompozimit në sipërfaqet e sheshta dhe mbi rolin e imazhit dhe figurës në procesin krijues.

Nudo

Programi i Nudos zhvillohet çdo ditë të javës dhe është i detyruar për të gjithë studentët e kursit të parë. Qëllimi kryesor i tij është kontakti i studentit me natyrën, figurën e njeriut, njohjen dhe interpretimin mbi të. Programi synon të aftësojë studentët me mjetet shprehëse, gjuhën plastike dhe veçanërisht të nxisë qëndrime individuale dhe bashkëkohore të shprehjes në raportin që vendoset midis modelit, studentit e mjeshtrisë.

Programi i Studimit, Viti i Parë.

Emër, mbiemër	Norma	Mbi norma U-29/18	Ngarkesa Mesimore + U-29/18	Mbi norma aktuale	Ngarkesa mësimore
Prof. Gazmend Leka	140	200	340	40	180 orë
Prof. Artan Peqini	70	200	270	110	180 orë
As. Lektor Gentian Tabaku	195	200	395	165	360 orë
As. Lektor Orlis Vathi	195	200	395	105	240 orë
As. Lektor Artan Buca	195	200	395	105	300 orë
As. Lektor Shpëtim Kërçova	195	200	395	105	180 orë
Doktor Merita Selimi	165	200	365	75	120 orë
As. Lektor Dea Tili (e ftuar)	120	-	-	-	60 orë

Gjithësej 1620 orë

Atelje e vitit të parë.**Orë mbi normë**

Prof. Gazmend Leka	40 orë
Prof. Artan Peqini	110 orë
As. Lektor Gent Tabaku	165 orë
As. Lektor Orlis Vathi	105 orë
As. Lektor Artan Buca	105 orë
As. Lektor Shpëtim Kërçova	105 orë
Doktor Merita Selimi	75 orë
As. Lektor Dea Tili (e ftuar)	60 orë
	<u>Totali 765 orë</u>

Programi i studimit Pikturë Kavaleti

Në programin e Pikturës, për Ciklin e Parë të Studimeve BA, objektivi kryesor është formimi i kompetencave artistike dhe profesionale të kualifikuara të studentit, që merr në considerate pluralizmin e gjuhës dhe përtëritjen e teknikave dhe respekton e nxit kërkimin e tij vetjak. Vëmendje i kushtohet sa teknikave tradicionale aq edhe gjuhëve të reja të shprehjes artistike. Puna në atelier bazohet kryesisht në realizimin e projekteve, të cilat bëhen shkak për të dale në analiza, diskutime dhe trajtime teorike më të përgjithshme.

Cikli formues dy-vjeçar MA, konsiderohet i dobishëm për të thelluar njohuritë e fituara në Ciklin e Parë BA dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të drejtë e logjike mes disiplinave të ndryshme të artit, me synimin për të përvetësuar lidhjen mes traditave gjuhësore dhe atyre më të reja.

Toleranca krijuese është kusht i domosdoshëm për krijimin e një procesi interaktiv, në shërbim të krijimit të një atmosphere sa më të shëndetshme artistike.

Në përfundim të këtij program dy-vjeçar, studenti mbron diplomën me një projekt konkret në një nga teknikat e trajtuara prej tij gjatë dy viteve, e përzgjedhur nga pedagogët në procesin e punës, duke patur parasysh prijet individuale të secilit.

Të diplomuarit e këtij programi mund të zhvillojnë aktivitetet profesional në fronte të ndryshme, si në krijimtarinë e lirë, ashtu edhe në fusha të ndryshme estetike dhe artistike të komunikimit pamor.

Angazhimi i personelit akademik.**Norma + 200 orë mbi normë = Ngarkesa Mësimore****Programi i Studimit, Pikturë Kavaleti.**

Emër, mbiemër	Norma	Mbi norma U-29/18	Ngarkesa Mesimore + U-29/18	Mbi norma aktuale	Ngarkesa mësimore vjetore
Prof. Asc. Edmond Gjokopulli	140	200	340	190	330 orë
Dr. Zef Paci	165	200	365	165	300 orë
Dr. Merita Selimi	165	-	-	-	120 orë

As. Lektor, Shpëtim Kërcova	195	-	-	-	120 orë
As. Lektor, Hari Aleksii (Dep.Art Aplikuara)	195	-	-	-	150 orë
As. Lektor, Helidon Haliti (Dep. Pik. Monumentale)	195	-	-	-	180 orë
As. Lektor, Zigrida Sulaj (e ftuar)	120	-	-	-	120 orë
As. Lektor, Alket Frashri (i ftuar)	120	-	-	-	120 orë

Gjithësej 1440

Atelje e Pikturës Kavaletit

Prof. Asc. Edmond Gjipopulli

Dr. Zef Paci

Orë mbi normë

190 orë

165 orë

Programi i studimit Pikturë Monumentale

Programi i atelierit të Pikturës Monumentale zhvillohet në dy drejtime bazë, Pikturë Murale dhe Pikturë në Transparencë.

Ky program në nivelin Bachelor ofron njohuri mbi procese artistike, që kanë të bëjnë me integrimin e veprës së artit në arkitekturë, në mjedise të jashtme dhe të brendshme. Po ashtu, konsiston në zhvillimin e proceseve krijuese të studentit, duke e pasuruar gjuhën pamore me mjete e teknika alternative e bashkëkohore të shprehjes artistike.

Programi i nivelit Master është i orientuar në thellimin e studimeve të edukimit artistik, me nivel më të lartë profesional, ku përparësi mbetet kreativiteti i orientuar drejt fenomeneve, risive apo prurjeve artistike bashkëkohore.

Programi zhvillon potenciale profesionale duke evidentuar specifikat individuale të studentëve. Piktura Monumentale bashkëshoqëron zhvillimet socio-ekonomike e urbane në sintezë me arkitekturën, ku larmia e teknikave të aplikimit të këtij arti integrohet si një process pamor unik e me impact të spikatur publik. Këto njohuri e bëjnë studentin të angazhuar në sfida e veprimtari konkrete si dhe e bën atë të aftë e të aksesueshëm në tregun e punës.

Programi i Studimit, Pikturë Monumentale.

Emër, mbiemër	Norma	Mbi norma U-29/18	Ngarkesa Mesimore + U29/18	Mbi norma aktuale	Ngarkesa mësimore vjetore
Dr. Mikel Temo	90	200	290	195	285 orë
As. Lektor, Helidon Haliti	195	200	395	225	420 orë
As. Lektor, Ermal Baboçi	195	200	395	195	375 orë
As. Lektor, Ilir Kaso	195	200	395	45	240 orë
Prof. Fatmir Miziri	120	-	-	-	120 orë

Gjithësej 1440 orë

Atelje e Pikturës Monumentale

Ore mbi normë

Dr. Mikel Temo	195
As. Lektor, Helidon Haliti	225
As. Lektor, Ermal Baboçi	195
As. Lektor, Ilir Kaso	45
Prof. Fatmir Miziri (i ftuar)	

Totali 640

Siç shohim dhe nga tabelat e vlerësimit të ngarkesave mësimore për çdo pedagog me kohë të plotë, mbartin gjithashtu dhe një ngarkesë shtesë të pagueshme deri në masën 200 orë.

Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Një aspect tjetër i procesit mësimor është dhe praktika mësimore nje proces njohës që zhvillohet nga çdo program studimi dhe lidh organikisht formimin e studentit me realitetin jashtë auditorit universitar. Studenti gjatë praktikave mësimore, inkurajohet të përdorë gjithë kapacitetin e tij njohës në shërbim të të tretëve apo dhe atij vete, në mënyre të pavarur dhe direkte. Praktika mësimore, apo ajo profesionale e vendos studentin në kushtet e marrëdhënieve në punë dhe bën lidhjen midis njohjes dhe kërkesës së tregut.

Mbas përfundimit të studimeve Bachelor dhe Master studentët tanë janë të kualifikuar të punësohen në bazë të kërkesave të tregut e të japin kontributin e tyre sipas fushave përkatëse të edukimit.

- **Së fundmi**, Ateljeja e Pikturës Monumentale u pasurua nga një laborator i ri i financuar nga program Erasmus + REACH. Ky laborator, i pajisur me aparataturat dhe aksesoret më të avancuar të kohës, duhet të bëhet një nga hapësirat më të rëndësishme të aplikimit të teknologjive bashkëkohore të restaurimit të pikturave murale, mozik, afresk, al seco, vitrazh, qeramikë, gur, dru, etje. Ky laborator në mënyrë të ngutshme, kërkon sistemin e mundshëm në një nga hapësirat e studiuara dhe përshtatur në përputhje me kërkesat teknike të tij.
- Si fillim një staf prej dy pedagogësh nga Atelje e Pikturës Monumentale është duke u specjализuar për këtë qëllim, si me trajnime on-line, ashtu dhe nëpërmjet kontaktit real. Së fundi u relizua me sukses trajnimi 4 ditor nga Universiteti i Bolonjës në bashkëpunim me Universitetin e Arteve, Tiranë, Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Arkitekturës dhe Muzeu Arkeologjik, në Ravenna të Italisë, nga data 14/12/2021 në 18/12/2021. Udhëtime të tjera trajnuese jashtë vendit, janë parashikuar gjatë muajit Janar 2022 dhe në vazhdim.
- **Objektivi është:** Krijimi i një programi të ri studimi, brënda përgjegjësive administrative e programuese të Departamentit të Pikturës, si pjesë integrale të tij. Shtimi i këtij programi, mbështetur dhe nga laborator i përmendur më lart, do të jetë një vlerë e shtuar e Universitetit të Arteve dhe do ti japë atij vendin e merituar në fushën kërkimore shkencore.
- Përsa i përket nevojave të brendshme të departamentit të pikturës për staf mësimor dhe administrativ, me kohë të plotë apo të pjesëshme, Ateljeja e Pikturës Monumentale ka nevojë të punësojë me kohë të plotë një laborant mësimor i cili do të kujdesej për mbarëvajtjen e tij, pajisjen me materialet e duhura, organizimin e ambientit, etje.
- Në ateljenë e Pikturës së Kavaletit dhe programit të tij, në lëndën Teknologji Specialiteti, u shtua dhe një pedagog i ftuar me ngarkesë 4 orë x 30 javë = 120 orë vjetore.

Akreditimi i UART 2021

Sipas urdhrorit të Rektorit të UART, nr. 96, dt. 11.06.2021 bazuar në vendimin e bordit të akreditimit nr. 68 dt. 21.09.2017. "Për kreditimin e parë të Institucionit të Arsimit të Lartë

Universiteti i Arteve të Tiranë” u ngrit një grup pune ku Drejtuesi i Njësisë Bazë, Dr. Ermir Hoxha ishte antar dhe përfaqësues i Fakultetit të Arteve të Bukura.

Si rrjedhojë:

1. Pas direktivave dhe të Dekanit u morën masa për plotësimin e dokumenteve të kërkuara nga drejtuesi i Grupit të punës, Prof. Dr. Erald Bakalli,
2. U azhormuan të gjithë sillabuset e Fakultetit.
3. U ofruar informacion dhe asistencë për çdo anëtar tjetër të grupit sipas kërkesave specifike të secilit.
4. U plotësua dokumentacioni me raportet përkatëse.

Në fund të punës u evidentuan 32 materiale të ndryshme:

Ato ishin:

1. 1. 14 Procedura projekti
2. 1. 16 Raporti i vlersimit te punes mesimore
3. 1. 19 Projekti (tip i nje projekti te realizuar)
4. 1.18 Leje per pjesmarrje ne projekte artistike
5. 2. 4. 1 Projekte sociale
6. 2. 15. 1 Regjister per regjistrim studentesh
7. 2. 15. 2-Regjister vleresimi studentesh
8. 3. 4 Tabelat e planeve mesimore
9. 3. 5 Tabelat e ngarkeses mesimore
10. 3. 8 Model syllabus
11. 3. 17 - 3. 18 URDHERA PER KONKURS
12. 3. 19 Urdher dekani konkurset
13. 3. 20 Urdher per komisionet e diplomimit
14. 3.12. 3 RVB Raporti i vlersimit të brendshëm
15. 3. 28 TRANSFERIMET nga jashte ne Uart
16. 3. 33 Aktivitete të FAB për UART
17. 4. 3. 1 Evidence mbi praktikat mesimore
18. 4. 3. 2 Evidence e procesit te praktikave mesimore
19. 4. 4. 2 dhe 4.4.5 Evidence diplomimi
20. 4. 4. 4 Data provimesh dhe komisionet e lendeve teorike
21. 4. 4. 5 Procesi i diplomimit
22. 4. 5. 1 Praktika e hedhjes se te dhenave
23. 4. 5. 2 Menyra e info te stud
24. 4. 5. 3 Menyra e njoftimit te stafit
25. 4. 5. 4 Menyra e hedhjes se notes
26. 4. 5. 5 Burimet online
27. 5.23 Relacion galeria FAB
28. 5. 3 Broshura
29. 5. 5 Orari pritjes studenteve
30. 5. 7 Master-dosje student
31. 5. 11 - 5. 12 Aftesi e kufizuar+komunitet egjiptian
32. 5. 23 Galeria fab

Infrastruktura në Shërbim të Mësimdhënies dhe Kërkimit Artistiko-Shkencor

Në vazhdimësi të kërkesave të përvitshme, paraqitur nga Rektorati Nr. Prot. 200/3, Dt. 08.03.2021, lidhur me projektet e kërkimit shkencor të Fakulteteve të Arteve, nga drejtuesi i Njësinë Bazë Arte te Aplikuara, Dr. Ermir Hoxha në bashkëpunim të ngushtë me disa pedagogë

të stafit të FAB paraqiti përshkrimin, objektivat, qëllimin dhe një preventiv financiar për **Projektin për Kërkim Shkencor "Curriculum"**,

Tema dhe qëllim i projektit "Curriculum" synon pikësëpari hulmutimin shkencor dhe kuptimin e fenomenit të Shkollës së Artit në Shqipëri, si pjesë shumë e rëndësishme e ndërtimit të identitetit artistik dhe kulturor të artit në Shqipëri. Ky qëllim do të arrihet i ndarë në dy etapa. Në fazën e parë do të mundohemi të kuptojmë natyrën e këtij fenomeni, nëpërmjet intervistave me pedagogë aktual dhe apo të dalë në pension, bashkëbisedime me protagonistë të saj, si dhe bashkëveprimet me disa nga emrat më të rëndësishëm të shkencës vendase, në fusha si estetika, kritika e artit, sociologjia apo dhe antropologjia. Për të stimuluar edhe më shumë dialogun, këto bashkëbisedime dhe leksione të hapura, do të përmbillen me një konferencë po me këtë temë, shoqëruar me një ekspozitë me vepra të Fondit të Fakultetit të Arteve të Bukura. **Konferenca si zë në vetvete ka gjetur mbështetjen financiare të Partnerit kryesor të projektit, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.**

Në fazën e dytë materiali i mbledhur nga arkivistja dhe stafi, do të sistemohet, përpilohet, redaktohet e shtrohet për një botim mbi Historikun e Shkollës së Artit në Shqipëri. Teksti do të realizohet nga stafi i Fakultetit të Arteve të Bukura e do të ilustruhet me foto nga veprat e Fondit dhe ato nga arkivat personale të pedagogëve themelues të shkollës. Ai do të supervizohet nga Profesorët më në zë pjesë e stafit të Fakultetit si dhe nga antarë të zgjedhur të Akademisë së Shkencave. Më pas do kalojë në redaktim e korrektim gjuhësor për të pasur një produkt final i cili respekton maksimalisht të gjithë kriteret shkencore të kohës.

DEPARTAMENTI I ARTEVE TË APLIKUARA

Nëpërmjet materialit në vazhdimësi, po ju informoj rreth aktivitetit pedagogjik, artistik dhe shkencor që njësia bazë Arte të Aplikuara ka zhvilluar përgjatë vitit akademik 2021-2022.

2. Veprimtaria Mësimore

Për vitin akademik 2021-2022, procesi mësimor ka nisur më 18.10.2021 dhe ka përfunduar në 30 shtator 2022. Sezonet e provimeve, përgjithësisht, janë zhvilluar në përputhje me strukturën e vitit akademik. Në sezonin e dimrit ato u zhvilluan mes datave 11.02.2022 -1.03. 2022, ndërsa në atë qershorit 18.06.2022 - 6.07.2022 dhe ai i vjeshtës 12.09.2022 – 30.09.2022.

Kryesisht mësimi, procesi i provimeve dhe ai i diplomimeve është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe nuk janë shënuar incidente domethënëse që të kenë penguar apo vështirësuar zhvillimin normal të tyre. I gjithë procesi i mësimit, provimeve dhe diplomave është vëzhgimin nga afër prej Kordinatorëve të Programeve Studimore dhe Përgjegjësi i Njesisë Bazë.

2. Ngarkesat dhe orët mësimore

Me fillimin e vitit akademik 2021-2022, Njësia Bazë Arte te Aplikuara ka realizuar shpërndarjen e ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar dhe në vazhdimësi të atij me kohë të pjesëshme dhe afat të caktuar. Ngarkesa mësimore për vitin akademik 2021-2022 në Njësinë Bazë Arte te Aplikuara ka rezultuar në një total prej 5055 orësh.

Të gjithë pedagogët me kohë të plotë kanë marrë përsipër realizimin e mbinormës mësimore në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*. Përsa i përket stafit akademik me kohë të pjesëshme, konstatohen raste me tejkalim norme dhe këto shkojnë deri në 50% sipas udhëzimit të sipërpërmendur.

Përsa i përket Pedagogëve me kohë të plotë gjendja e ngarkesës paraqitet si vijon:

Programet	Norma	Orë të realizuara	Orë plus
-----------	-------	-------------------	----------

Programi i Studimit, Pikturë Tekstil & Modë	725	1110	385
Programi i Studimit, Pikturë Grafikë.	620	1395	775
Programi i Studimit, Pikturë Multimedia	725	1200	505
Fotografia	620	1005	385
Totali	2690	4710	2050

Totali i mbi normës në departament aktualisht është $385 + 775 + 505 + 385 = 2050$ orë
Përsa i përket Pedagogëve me kohë të pjesshme gjendja e ngarkesës paraqitet si vijon:

Programet	Norma	Orë të realizuara	Orë plus
Programi i Studimit, Pikturë Tekstil & Modë	240	160	-
Programi i Studimit, Pikturë Grafikë.	360	270	-
Programi i Studimit, Pikturë Multimedia	120	120	-
Fotografia	120	240	120
Totali	840	790	120

Si konkluzion i analizës në Departamentin e Arteve të Aplikuara:

Rezulton që Programi me më shumë mbinormë është Programi i Studimit Pikturë Grafikë, me 775 orë, rrjedhojë dhe e normës së ulët të stafit dhe angazhimit të një pjese të tij dhe në Departamentet e tjera. Ndërkohë kujtojmë që Programi i studimit Fotografi këtë vit është me gjysëm angazhim pasi ka filluar vetëm në vitin akademik 2020 -2021 si rrjedhojë në vitin 2022- 2023 do të ketë ngarkesën e plotë në gjithë ciklin Bachelor, e së shpjëti dhe në ciklin e dytë Master.

Mbas një analize të hollësishme të mbi-normimit të personelit akademik me kohë të plotë e kohe të pjesëshme (të ftuar) dhe nevojave për personel të ri me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe lehtësimi të ngarkesës së pedagogëve aktual, pas konsultimit dhe me kolegët në Programet respektive dhe mbi normimin prej **2050** orësh, **lind nevoja për marrjen e një pedagogu me kohë të plotë në Lëndën Fotografi.**
Si vijon tabela e ngarkesës mësimore për stafin me kohë të plotë dhe të pjesshme.

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTEVE TE BUKURA
DEPARTAMENTI I ARTEVE TE APLIKUARA
PASQYRA E NGARKESËS MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË PËR VITIN AKADEMIK 2022 - 2023

NR.	EMËR MBIEMËR	TITULLI GRADA	LËNDA	PROGRAMI I STUDIMIT	K. CHIKË I	K. CHIKË II	Nr. studentëve	SEMESTRI I				SEMESTRI II				Norma Vjetore	Nentotali		TOTALI
								Lek.	Sem.	L. Sp.	Prakt.	Lek.	Sem.	L. Sp.	Prakt.		BA	MA	
1	NAJADA HAMZA	PROFESOR	Tekstil Modë	Tekstil	I	II	2	5	2				5			150	0	255	
2	VLADIMIR MYRTI	PROFESOR	Multimedia	Multimedia	I	II	2	4	4				4	2		120	0	210	
3	ALBES FUSHA	PROF. ASOC.	Foto Art, Tekstil Fot.	FAB Grafike	I	II	2	4	4				6	2		150	0	240	
4	ARDIAN ISUFI	PROF. ASOC.	Grafike	Grafike	I	II	2	4	6				4	4		120	0	270	
5	ALTIN LIKA	AS.LEKTOR	Komp. Tekstil Haps.	FAB	I	II	2	8	4				8	2		240	0	330	
6	GENC PERMETI	AS.LEKTOR	Tek. Spec. Tekstil Modë	Tekstil	I	II	2	7	8				7	2		230	0	330	
7	PETRAQ PAPA	AS.LEKTOR	Grafike	Grafike	I	II	2	4	8				4	4	30	120	0	300	
8	ARDIAN KAPË	AS.LEKTOR	Tekstil, Vio. 3D	Tekstil	I	II	2	6	2				6	2		180	0	240	
9	YALBONA KARAFI	AS.LEKTOR	Tekstil Prezi, Dizajni (2q)	Tekstil	I	II	2	6	5				6	2		180	0	285	
10	EDIËSON CERAJ	AS.LEKTOR	Multimedia/Foto dhe Imazhi	Multimedia	I	II	2	8	4				8	2		240	0	330	
11	FLORIAN HAXHIH	AS.LEKTOR	Montazh Video / Kamera	Multimedia	I	II	2	5	7				5	5		150	0	330	
12	HAFRIN ALEKSI	AS.LEKTOR	Pikturë / Vizatim / Pikt. Digitale	Graf. Pikt. Kav.	I	II	2	12	7				12	4		360	0	525	
13	UNDAR MUÇA	AS.LEKTOR	Tekstil Grafike	Grafike	I	II	2	6	5				6	3		180	0	300	
14	ILIR BUTKA	AS.LEKTOR	Tek. e Fotografisë / P. Portfolio	Fotografi	I	II	2	5	4				4	2		120	0	225	
15	BOSITA HABAZA	AS.LEKTOR	Fotografi modë	FAB	I	II	2	6	2				6	2		180	0	240	
16	ERMIR HOXHJA	Doktor	Histori e Artit Shqiptar	Viti I	I	II	2	6					6		30	180	30	300	

FAKULTETI I ARTEVE TE BUKURA
DEPARTAMENTI I ARTEVE TE APLIKUARA
PASQYRA E NGARKESËS MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME PËR VITIN AKADEMIK 2022 - 2023

NR.	EMËR MBIEMËR	TITULLI GRADA	LËNDA	PROGRAMI I STUDIMIT	Kursi CHIKË I (Pars)	Kursi CHIKË II (Pjesë)	Nr. studentëve	SEMESTRI I				SEMESTRI II				Norma Vjetore	Nentotali		TOTALI
								Lek.	Sem.	L. Sp.	Prakt.	Lek.	Sem.	L. Sp.	Prakt.		BA	MA	
1	ALBANA LETI	DOKTOR	Tekst. Tekstil & Modë	Pik. Tek. & Modë	II-III		26	2					4			120	120	0	120
2	DRIËTAN NABI	AS.LEKTOR	Njës. me Prog. Komp.	Pikturë Grafike	II-III		29	2					4			120	120	0	120
3	ANISA PATURI	AS.LEKTOR	Tekst. Grafike (Zgjedh)	Pikturë Grafike	II-III		20	2					2			120	60	0	60
4	Orërita Kapllani	AS.LEKTOR	Fotografi	Foto & Grafike	II-III		22	2					8			120	240	0	240
5	BESHNIK SHIPATA	AS.LEKTOR	Njëshuri Animacioni	Pikturë Grafike	II	III	22	2					4		2	120	0	90	90
6	SILVANA FINI	DOKTOR	Estetika dhe Dizajni	Pik. Tek. & Modë			20	2					1		1	120	0	30	30

LABORANTE MËSIMORE, ngrackesa mesimdhënie (pa pagese)

NR.	EMËR MBIEMËR	TITULLI GRADA	LËNDA	PROGRAMI I STUDIMIT	Kursi	Nr. studentëve	SEMESTRI I				SEMESTRI II				Norma Vjetore	Nentotali		TOTALI	
							Lek.	Sem.	L. Sp.	Prakt.	Lek.	Sem.	L. Sp.	Prakt.		BA	MA		
																			BA
1	LINDA LUPI	LABORANTE	Montazh video Kamera	Pik. Multimedia	III		2						4			120	120	0	

Ndërkaq pranë Departamentit Arte të Aplikuara në programet studimore të Pikturë Multimedia, Pikturë Tekstil & Modë, Pikturë Grafike dhe Fotografi, për vitin akademik 2021-22, në të dy ciklet, ndoqën studimet 125 studentë. Numri i studentëve sipas programeve të studimit dhe cikleve përkatëse në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Njësia Bazë Arte të Aplikuara në vite rezultojnë si më poshtë vijon:

Programi	2017 - 2018		2018 - 2019		2019 - 2020		2020 - 2021		2021 - 2022	
	Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma	Ba	Ma
Multimedia	30	13	30	14	21	13	22	18	21	14
Tek. Modë	30	16	27	15	28	16	27	20	27	13
Grafikë	37	15	42	21	39	19	30	22	21	23
Fotografi									6	

Bazuar në konsultimet e mbajtura me pedagogët dhe konsultimet e herë pas herëshme të regjistrave mësimore, rezulton se objektivat e secilës prej lëndëve, në programet e studimit pranë Njësive Bazë Arte të Aplikuara, janë realizuar në përputhje me parashikimet e syllabuseve të lëndëve respektive.

1.2. Përgjatë vitit akademik 2022-23, janë parashikuar ndryshime të Planeve Mësimore në Ciklin e I dhe në Ciklin II, në kuadër të të cilave, kurrikula mësimore duhet të përmirësohet dhe përshtatet me tregun e punës dhe ofertës didaktike, në disa lëndë specifike për programet e studimit respektiv.

Në lidhje me hapjen e studimeve të Ciklit III që çojnë në fitimin e gradës Doktor, bazuar shkresës Nr. 3708 prot, datë 02.04.2019 të MAS, dhe shkresën e Rektorit të UA Nr. 360/1 Prot, datë 09.04.2019, me tonën Nr. 138 prot datë 09. 04.2019, pranë Njesisë Bazë Arte të Aplikuara u ngrit grupi i punës i cili punoi për plotësimin e dosjes dhe aplikimin në MASH. Aktualisht procesi i hapjes së **PROJEKT PROPOZIM PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DOKTORATURË “NË ARTET PAMORE”** pret miratimin nga Senati dhe Bordi i Administrimit të Kërkesës, Projekt Propozimit dhe Rregullores, për tu paraqitur pastaj në Ministrinë e Arsimit.

3. Procesi i Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të akreditimit të programeve të studimit të ciklit të Dytë Master në Arte, në FAB.

Raportet e Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të akreditimit të tre programeve të studimit:

- 1) Master i Arteve Pikturë Grafikë dhe Mësuesi
- 2) Master i Arteve Pikturë Multimedia dhe Mësuesi
- 3) Master i Arteve Pikturë **Tekstili, Modë dhe Mësuesi**

Dokumentacioni u hartuan dhe mbështet në përputhje të plotë me:

- Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për ndryshimin e VKM Nr. 41, datë 24.01.2021”.
- Manualin mbi “Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit” viti 2017, seksioni Nr. 3. “Procedura për vlerësimin e programeve të studimit në kuadër të akreditimit të parë periodik”.
- VKM Nr.824, datë 24.12.2021 “Miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”.
- Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar me Udhëzimin e MASR Nr. 37 datë 4.12.2018, “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 29 datë 10.09.2018”.
- Udhëzimin e MASR Nr.52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar me udhëzimin Nr.11 datë 10.04 2017.
- Akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi si dhe akteve të tjera rregullatorë të Universitetit të Arteve.
- Statutit të UART të Miratuar me Urdhër të MASR Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të Universitetit të Arteve”.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.

Raportet u hartuan nga Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për tre programet e studimit. Ato u ngritën me urdhër të Dekanit të FAB për këtë proces me Shkresë Nr. 27 prot., datë 04.03.2022

“Mbi ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e brendshëm, në kuadër të akreditimit të programeve të studimit të ciklit të dytë Master”, dërguar Departamentit të Arteve të Aplikuara. Përveç këtij grupi, me urdhër të Dekanit me Nr. 30 prot., datë 23.05.2022 “Mbi ngritjen e Grupit të Punës për Akreditimin e Programeve Master”, për të përmirësuar performancën në Programet e Studimit përkatës, u caktuan dhe 6 ndihmës kordinatorë. Për këto programe studimi në Dep. e Arteve të Aplikuara kordinator ishin As. Lek. Edison Çeraj, As. Lek. Harri Aleksi, As. Lek. Valbona Karaboja.

Përbërja e grupeve të Vlerësimit të Brendshëm për programit e studimit Master siguronin përfaqësimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrativ si dhe studentëve në Departamentin e Arteve të Aplikuara. Në ngritjen e këtyre grupeve janë mbajtur në konsideratë kritere që lidhen me aftësinë profesionale; integritetin; objektiviteti, njohja e bazës ligjore dhe e kodit të cilësisë, memoria historike dhe institucionale, aftësia dhe mundësia e mbledhjes së informacionit në kohë dhe me përgjegjësi.

Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) përmes Koordinatorit Institucional ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) gjatë të gjithë procesit të vlerësimit në kuadër të akreditimit. Për të zbatuar sa më mirë procedurat për vlerësimin e programeve të studimit në kuadër të akreditimit të parë, u kërkua trajnim i GVB për vetë rëndësinë që kishte ky proces. Në trajnimin e GVB morën pjesë jo vetëm anëtarët e GVB por edhe strukturat mbështetëse të Institucionit duke u informuar për rëndësinë, modalitetet dhe dokumentacionin e nevojshëm për këtë proces.

GVB deri në hartimin përfundimtar të këtij Raporti ka punuar duke rënë dakord fillimisht me:

- dokumentet e nevojshëm dhe mbështetëse të hartimit të Raportit,
- zbatimit të kriterëve dhe standardeve të vlerësimit sipas standardeve shtetërore të cilësisë,
- zbatimi me përgjegjësi dhe korrektësi i kriterëve sipas Manualit të ASCAL/ 2021 referimin dhe evidentimin e materialeve mbi të cilat iu është dhënë përgjigje plotësimi të standardeve sipas fushave,
- mbështetjes në Statutin e UART,
- VKM-së për marrjen e statusit të veçantë si i vetmi Institucion publik që ofron programe në fushën e artit,
- si dhe të gjithë akteve rregullatorë të funksionimit të Institucionit.

Anëtarë të GVB kanë realizuar takime të përjavshme me autoritet drejtuese të UART si me Rektorin, Dekanin e Fakultetit, anëtarë të stafit akademik dhe administrativ, takime me përfaqësues të studentëve duke zhvilluar bisedime, duke marrë opinione dhe duke ndarë mendimet me studentë dhe përfaqësues të Këshillit studentor.

4. Infrastruktura në Shërbim të Mësimdhënies dhe Kërkimit Artistiko-Shkencor

Në vazhdimësi të kërkesave të përvitshme, paraqitur nga Rektorati lidhur me projektet e kërkimit shkencor të Fakulteteve të Arteve, nga drejtuesi i Njësinë Bazë Arte të Aplikuara, Dr. Ermir Hoxha në bashkëpunim të ngushtë me disa pedagogë të stafit të FAB do të riparaqitet përshkrimi, objektivat, qëllimi dhe një preventiv financiar për **Projektin për Kërkim Shkencor “Curriculum”**.

Tema dhe qëllim i projektit “Curriculum” synon pikësepëri humultimin shkencor dhe kuptimin e fenomenit të Shkollës së Artit në Shqipëri, si pjesë shumë e rëndësishme e ndërtimit të identitetit artistik dhe kulturor të artit në Shqipëri. Ky qëllim do të arrihet i ndarë në dy etapa. Në fazën e parë do të mundohemi të kuptojmë natyrën e këtij fenomeni, nëpërmjet intervistave me pedagogë aktual dhe apo të dalë në pension, bashkëbisedime me protagonistë të saj, si dhe bashkëveprimi me disa nga emrat më të rëndësishëm të shkencës vendase, në fusha si estetika, kritika e artit, sociologjia apo dhe antropologjia. Për të stimuluar edhe më shumë dialogun, këto

bashkëbisedime dhe leksione të hapura, do të përmbillen me një konferencë po me këtë temë, shoqëruar me një ekspozita me vepra të Fondit të Fakultetit të Arteve të Bukura. **Konferenca si zë në vetvete ka gjetur mbështetjen financiare të Partnerit kryesor të projektit, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.**

Në fazën e dytë materiali i mbledhur nga arshivistja dhe stafi, do të sistemohet, përpilohet, redaktohet e shtrohet për një botim mbi Historikun e Shkollës së Artit në Shqipëri. Teksti do të realizohet nga stafi i Fakultetit të Arteve të Bukura e do të ilustruhet me foto nga veprat e Fondit dhe ato nga arkivat personale të pedagogëve themelues të shkollës. Ai do të supervizohet nga Profesorët më në zë pjesë e stafit të Fakultetit si dhe nga antarë të zgjedhur të Akademisë së Shkencave. Më pas do kalojë në redaktim e korrektim gjuhësor për të pasur një produkt final i cili respekton maksimalisht të gjithë kriteret shkencore të kohës.

5. Aktivitete të realizuara nga Njësinë Bazë Arte te Aplikuara Master- Class, Leksione të Hapura, Ekspozita dhe Tryeza të rumbullakëta.

Përgjatë vitit akademik 2021-22 Programet e Studimit pjesë e Njësisë Bazë Arte të Aplikuara kanë siguruar organizimin dhe mbarëvajtjen e një numri të konsiderueshëm aktivitetesh. Më konkretisht përgjatë vitit akademik 2021-22 janë zhvilluar:

A. Projektet artistike të realizuara për Programin e Studimit Pikturë Grafikë për vitet 2021 – 2022

- Ekspozitë Studentore – PORTOFOLIO GRAFIKA – Galeria FAB, UART
- Work Shop: Dizajni Grafik, lektor Harri Aleksi – Dcode packaging NR.1, Lektorium FAB
- Work Shop: Dizajni Grafik me Marsel Zara – Dcode packaging NR.2, Lektorium FAB
- Work Shop: 2 GULIVERËT me temë PERMOGRAFIA – Lektorium FAB & Qendra Harabel
- Takim studentor me kritikun Italian Giovanni Granzotto – Lektoriumi rrethor UART.
- Takim studentor me kuratorin amerikan Raino Isto – ZETA Qendra e Artit Bashkëkohor, Tiranë.
- Aplikimet studentore në pjesëmarrjen e Bienales Ndërkombëtare të Grafikë, GAT – TIRANA.
- Takim Studentor me Street Artistin Grek SAME84 – Atelie Grafika, UART.
- Takim Studentor me artistin Ergys Krisiko në ekspozitën personale, COD, Tiranë.
- Vizitë studentore në ekspon graffiti SAME84 “Ne jemi Heronjtë tanë”, Muzeu Historik, Tiranë.
- Takim studentor – 8 Dhjetori / DITA E RINISË – Atelie Grafika, UART.
- Takim studentor me temë “DIPLOMA PAMORE” analiza studimore, Atelie Grafika, UART.
- Vizitë studentore në site arkeologjike për praktikën mësimore, Sarandë
- Vizitë kulturore - Ekspozita personale e Prof. Asc. Ardian Isufi: KOMPLOTI I TIRANËS, Galeria Kombëtare e Kosovës, Prishtinë.
- Work Shop – DARK CALIGRAPHY me lektor Harri Aleksi, Atelie Grafika, UART.
- Konkurs studentor për ilustrimin “TRUPI IM, E DREJTA IME”, RedCloud, Tiranë.
- Pjesëmarrje studentore në SPRING FESTIVAL, Open AIR – Sheshi Skënderbej, Tiranë.
- Takim kulturor për artisten Lumturi Blloshmi “KAFKA” – Qendra Harabel, Holli UART
- Vizitë studentore në ekspozitën e lektor Petraç Papa “ACTA URBANA”, Galeria FAB
- Takim kulturor dhe akademik në ekspozitën studentore ”M.O.S.” të MULTIMEDIAS, Tiranë.
- Aksion Studentor në bashkëpunim me Postën Shqiptare “UKRAINA – Post Cards”
- Takim Studentor – Historiku I Filatelisë Shqiptare, Galeria e Postës Shqiptare, Tiranë.
- Work Shop – ATELIE GRAFIKA në bashkëpunim me Universitetin e New York-ut, UART.

- Projekt Virtual Studentor “7 CIIAMBERS” – ONLINE ART në bashkëpunim me BALPHIN GROUP, Tiranë
- “The seven Talks” - Projekt në bashkëpunim me 7 CHAMBERS, Fakulteti i Arteve të Bukura dhe Univesiteti i Nju Jorkut, Tiranë. 7 takime në 7 javë, nëntor dhjetor 2022, të ftuar Ardian Isufi, Harri Aleksi, Elton Koritari, Daniela Kavaja, Besmira Lahi, Majlinda Hala, Petraq Papa.

B. Projektet artistike të realizuara për Programin e Studimit Pikturë Multimedia për vitet 2021 – 2022

- Vizitë e studentëve të Multimedias në Galerinë Destil për të parë ekspozitën Nepotik nr. 3, si dhe për të bërë një bisedë me kuratorin. (Maj, 2022)
- Takim me studiuesin Giovanni Granzotto në Lektoriumin e Fakultetit të Muzikës, ku mbajti temën “Nga ilirët dhe romakët deri në ditët e sotme: një histori e vetme në Mesdhe”, organizuar nga Atelieri i Multimedias (Vladimir Myrtezai) dhe Harabel. (Maj, 2022)
- Vizitë e artistit dhe regjisorit Tin Dirdamal në Atelierin e Multimedias për të prezantuar disa prej veprave të tij dhe për një bashkëbisedim me studentët. (Shkurt, 2022)
- Video-performancë e dy studenteve të Multimedias, Nadia Abazi dhe Kristiana Çene në Sheshin Nënë Tereza, pjesë e temës “Something stupid” (Florian Haxhihyseni). (Shkurt, 2022)
- Vizitë e studentëve të Multimedias në Galerinë COD për të parë ekspozitën “Në kërkim të artit” të Helidon Gjergjit, si dhe për një bashkëbisedim me artistin. (Janar, 2022)
- Vizitë mësimore në Korçë. (Dhjetor, 2021)
- Vizitë mësimore në Elbasan, te Metalurgjiku, në kuadër të temës “Stok” (Vladimir Myrtezai). (Tetor, 2021)
- Ekspozitë e studentëve të Multimedias në Galerinë FAB, me titull “Njëmijë lejlekë”, kuruar nga pedagogët e atelierit. (Korrik, 2021)
- Pjesëmarrje e disa studentëve në workshopi-n “Tulla Visual Art Lab”, në Qendrën Tulla. (Qershor, 2021)
- Praktikë mësimore në Himarë. (Qershor, 2021)
- Studentët vizitojnë ekspozitën “Ngjyrosje” të Edison Çeraj, shoqëruar me një bashkëbisedim me autorin. (Nëntor, 2020)
- Praktikë mësimore në Himarë. (Qershor, 2020)

C. Projektet artistike të realizuara për Programin e Studimit Pikturë Tekstil dhe Modë për vitet 2021 – 2022

- Qershor 2021. Diploma Bachelor – Photo shoot.
- Korrik 2020. Sfilate me studentet e vitit te dyte Master ne Atelierin e Tekstil dhe
- Mode nen udheheqjen e Profesoresh Najada hamza, Ardian Kapo, Genc Permeti.
- 10 Korrik 2021. Diplomat Master nen udheheqjen e Prof. Najada Hamza, Ardian Kapo dhe Genc Permeti- Galeria FAB.
- 21 Tetor 2021. Creating a Common Future. Programi i bashkepunimit Nderkombetar (Maqedonia e Veriut).
- 23 Shkurt 2022. Masterclass EASDBURGOS Spanje me studentet e Tekstil dhe Mode.
- 29 Mars 2022. Edicioni i tetëmbëdhjetë i Festivalit Ndërkombëtar të Vokalit Operistik “Marie Kraja”. Sfilatë nga studentët e Tekstil dhe Modë nën drejtimin e Prof. Najada Hamza, Ardian Kapo, Genc Përmeti.
- Prill 2022. Praktikë me studentet e Atelierit Tekstil dhe Mode ne Muzeun Arkeologjik Durres

dhe Amfiteatri i Durrësit nën drejtimin Prof. Najada Hamza, Ardian Kapo, Genc Permeti.

- Korrik 2022. Diplomati Bachelor.

- Korrik 2022. Diplomati Master nën udhëheqjen e Prof. Najada Hamza, Ardian Kapo dhe Genc Permeti- Galeria FAB.

- 4 korrik 2022. Urban Sculptures-19 years of wearable art. Platforma e Artit Bashkëkohor HARABFI, së bashku me Ateliein Tekstil & Modë të Fakultetit të Arteve të Bukura në Universitetin e Arteve, drejtuar nga Najada Hamza, në sheshin ballor të Universitetit të Arteve, ofroi një event prezantues të 19 viteve punë të Atelieit për krijimin e skulpturave të buta, veshjeve jo veshje të cilat sfidojnë konceptin tradicional qoftë të modës e qoftë të modës e qoftë të skulpturës.

6. Galeria FAB / Aktivitetet artistike

6.1 Përgjatë vitit 2022 janë realizuar këto aktivitete

8 – 15 shtator 2021	“Çfare na trameton Yonusi”, ekspozitë konkurs ndërkombëtar e organizatës kulturore “Yonus Emre”, në Tiranë, kuruar nga Ermir Hoxha
20 – 30 shtator 2021	“Nana” ekspozitë personale e piktorit Zaim Elezit, kuruar nga Sadik Spahija
15 – 19 tetor 2021	Dea Film Festival, Edmond Topi i ftuar
22 tetor – 12 nëntor 2021	“Kaloj një grua”, ekspozitë personale e piktorit Gazmend Leka, pedagog, kuruar nga Ermir Hoxha
15-25 nëntor 2021	Ekspozitë në grup, grupimi artistik “Nëntor”, kuruar nga Aleksander Filipi
6 – 22 dhjetor 2021	“Folie Baroque” ekspozitë personale e piktorit Arben Golemit, kuruar nga Ermir Hoxha
3 shkurt -10 shkurt 2022	Eldon Luarasi, “ Rrëfime”Ekspozitë personale e artistit Eldon Luarasi, kuruar nga Genc Përmeti pedagog
7 mars – 15 mars 2022	Vladimir Llakaj, “My Loved ones”, pedagog, ekspozitë personale
18 mars – 3 prill 2022	Orion Shima, “This Fall”, pedagog, ekspozitë personale, kuruar nga Parid Teferici
7 prill – 17 prill 2022	Egla Memaj, “Epitaf”, ekspozitë personale, e ftuar nga FAB
21 prill – 30 prill 2022	Qazim Kërtusha, ekspozitë personale, kuruar nga Sadik Spahija
11 maj – 5 qershor 2022	Artan Peqini, “Përtej Kohës - Udhëtimi magjik”, pedagog, ekspozitë personale, kuruar nga Najada Hamza
10 – 20 qershor 2022	Petraç Papa, “Acta Urbana”, ekspozitë personale. Pedagog, kuruar nga Najada Hamza
30 qershor – 7 korrik 2022	“Close Contact”, kuruar nga Tansel Turkdogan, Java e Kulturës Turke, Ekspozitë e artit Bashkohor Turk, Kordinatorë Merita Selimi
22 – 29 gusht 2022	Lida Shosha, “Ngjyrat e Jetës”, ekspozitë personale Piktore e ftuar
14 shtator – 1 tetor 2022	Can You Hear Me? Grupi prej 14 artistësh nga vendet nordike, kuruar nga Mats Jansson, ftuar nga Genc Mulliqi, dhe Ambasada Suedeze.
3 tetor – 9 tetor 2022	Rosita Habazaj, “12 years of color and lines transformation”, pedagoge, ekspozitë personale

13 tetor – 12 nëntor 2022	Arben Bajo, Mythodea, ekspozite personale, kuruar nga Ardian Kapo, Ermir Hoxha
16 nëntor – 7 dhjetor 2022	Gazmend Leka, “Dhe Yjet Rrinë e Vështrojnë”, pedagog, personale, kuruar nga Ermir Hoxha
9 dhjetor – 19 dhjetor 2022	Ekspozitë në grup, grupimi artistik “Nëntor”, kuruar nga Aleksander Filipi
21 dhjetor – 31 dhjetor 2022	Fatmir Tufina, personale, piktor, i ftuar

6.1. Të dhëna mbi aktivitetet në Galerinë FAB në këtë periudhë

1. Galeria e zhvillon aktivitetin e saj kryesisht gjatë kalendarit të vitit akademik. Evidentohen mesatarisht rreth 20 aktivitete në një vit akademik.
2. Frekuentueshmëria e saj varion në rreth 300 vizitorë për aktivitet, prej të cilëve 20 % janë pedagogë, 50 % studentë dhe 30 % artëdashës.
3. Kryesisht rreth 90 % e këtyre aktiviteteve janë angazhim i Fakultetit të Arteve të Bukura, ku perfsihen performanca të studenteve, ekspozita personale të pedagogëve, ekspozita të atelieve apo dhe ekspozita të studenteve të këtij fakulteti. Pjesa tjetër e aktiviteteve organizohen nga artistë e kuratorë që operojnë jashtë institucionit si dhe individë të ndryshëm që shprehin dëshirën të ekspozojnë veprat e tyre.
4. Në një vit kalendarik, galeria arrin një numër maksimal vizitorësh në rreth 5000 persona, për rreth 20 ekspozita.
5. Kapaciteti i saj maksimal arrin në 150 - 200 persona për inagurime, kjo në varësi të aktivitetit dhe punimeve që ai ofron.
6. Pasqyrimi i aktivitete në media e shkruar dhe audio vizive ka qenë maksimal, duke pasur parasysh që për secilin prej tyre njoftohen në mënyrë direkte dhe elektronike mbi 30 gazetarë.
7. Aktivitetet e Galerisë FAB pasqyrohen rregullisht në rrjetet sociale Facebook, Instagram, si në faqet e saj zyrtare ashtu dhe ato të UA.

7. Çështje të Tjera

Problematika 1. Konstatohet përsëri mungesa e mbështetjes financiare që pedagogët duhet të gëzojnë në funksion të një zhvillimi normal të aktivitetit artistik dhe shkencor. Konkretisht, të gjitha pjesëmarrjet e stafit akademik në konferenca shkencore, aktivitete ekspozitash etj, janë mbuluar me shpenzimet e vetë stafit akademik ose me fonde të siguruara nga këta të fundit nëpërmjet aplikimeve në donatorë të ndryshëm. E njëjta problematikë vërehet edhe për financimin e botimeve të studimeve, përkthimeve të stafit akademik.

Zgjidhja 1. Lidhur me problematikën 1, sugjerojmë që të krijohet mundësia e një fondi të dedikuar për të mbuluar shpenzimet e pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca dhe aktivitete artistike në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjithashtu propozojmë që Universiteti i Arteve të sigurojë një fond të mjaftueshëm për botimin e një reviste shkencore e cila mund të publikohet dy herë në vit.

Njësinë Bazë- Skulpturë

Nëpërmjet materialit në vazhdimësi, po ju informoj rreth aktivitetit pedagogjik, artistik dhe shkencor që njësinë bazë Skulpturë ka zhvilluar përgjatë vitit akademik 2021-2022.

3. Veprimtaria Mësimore

Për vitin akademik 2020-2021, procesi mësimor ka nisur më 02 Nëntor 2020 dhe ka përfunduar në 30 shtator 2021. Sezonet e provimeve, përgjithësisht, janë zhvilluar në përputhje me strukturën e vitit akademik. Ato filluan me sezonin e dimrit më dt. 20.02.2021, por për shkak

të situatës së krijuar nga Pandemia, me urdhër të Rektorit nr. 3 datë 15. 02.2021, mbi “Ndryshimin e Strukturës Vjetore të procesit mësimor për vitin akademik 2020-2021, sezoni i provimeve të dimrit për Ciklin e Parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe Ciklin e Dytë të studimeve me kohë të plotë Master në Universitetin e Arteve”, u vendos shtyrja e provimeve të dimrit deri me datë 14.03.2021. Si rezultat semestri i dytë rifilloi me dt. 15.03. 2021 dhe përfundoi me dt. 18.06.2021.

Ndërkohë rikujtoj që viti akademik 2020-2021 u përshkua tërësisht nga Pandemia Covid-19, e cila përcaktoi në bazë të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit zhvillimin e mësimit online, pothuaj gjatë gjithë vitit i akademik.

Ndryshime u kërkuan të realizoheshin gjatë sezonit të provimeve fillimisht të dimrit. Si rezultat i kësaj u morën këto masa:

c. Mbi provimet e mbartura

1. Për provimet e mbartura të cilat duket se paraqesin një numër të kufizuar studentësh, pedagogët respektivë respektuan distancat fizike, duke garantuar një mbarvajtje sa më të mirë të gjithë procesit të provimit, si në rastet e zhvillimit të tij me shkrim, me gojë apo e kombinuar.

Në rastet kur u kaluan numri prej 10 studentësh u rekomandua ndarja e tyre në 2 grupe. Kjo sollti zhvillimin e provimit në dy orare të ndryshme, por brenda të njëjtës datë.

2. Në rastin kur një student ndodhej fizikisht me banim larg kryeqytetit, u pa me prioritet zhvillimi i provimit në versionin online. Pedagogët e lëndës patën një plan rezerve për të përmbushur këtë kërkesë specifike, me qëllim evitimin e ardhjes së tyre në këtë kohë pandemie.

d. Mbi shikimin e punëve në atelier

1. Për shikimin e detyrave në atelier u respektua ndarja e studentëve në grupe jo më mëdha se 5 studentë, të cilët u vendosën në orare të ndryshme psh. Grupi 1 ora 9:30 deri më 10:30, Grupi 2 ora 10:30 deri më 11:30, dhe kështu me rradhë. Kjo u bë për të evituar grumbullimin e studentëve në ambjete të brendshme të fakultetit, një fenomen që duhet evituar me bashkëpunimin sa më rigoroz të stafit pedagogjik, në bashkëpunim dhe me administratën e Fakultetit. Për çdo nevojë nuk u hezitua të angazhohej stafi ndihmës i administratës, apo dhe laborantët respektivë.
2. Gjatë kohës së shikimit të punëve në atelier u bë kujdes për respektimin e distancave, vendosjes së domosdoshme të maskës nga gjithë stafi dhe studentët.
Për provimet përfundimtare të master vitit II, u sugjerua ndarja po në dy grupe meqë numëri maksimal i studentëve është 9, por hapësirat kohore ishin më të gjata. psh. Grupi 1 ora 9:30 deri më 11:30, Grupi 2 ora 11:30 deri më 13:30, për ti dhënë sa më shumë kohë procesit të kryhet me sukses.
3. Përgjatë gjithë procesit u respektuan me rigorozitet maksimal të gjithë masat e paralajmëruara antikovid, distancimin social, mbajtjen e maskës në çdo moment dhe hapësirë, dizifektimin sa më të shpeshtë duarve.

I gjithë procesi u mbikëqyr afër nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe u përfundua me një raport të shkruar nga koordinatoret e caktuar për çdo Program Studimor. Raporti përmbante një përshkrim të zhvillimit të procesit dhe problematikave që dolën për shkak të zhvillimit të mësimit online dhe se si mund të vazhdohet më tej për të ngushtuar sado pak handikapët e lindura nga kushtëzimet pandemike. Për monitorimin e rregullsisë së procesit online, një pasqyrë elektronike e realizimit të mësimit ofrohej me raporte javore nga stafi i IT.

Ndërkohë rikujtoj që semestri i dytë rifilloi me dt. 15.03.2021 dhe përfundoi me dt. 18.06.2021, në formatin online sipas Urdhërit të Ministrit të Arsimit nr. 104, datë 30.4.2020, për “Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 (e në vazhdim) nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid 19”, si dhe te vendimit të rektoratit të UART me nr.34 datë 04 Maj 2020, “Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19, në Universitetin e Arteve”.

Lëndët janë zhvilluar online në platformën MICROSOFT TEAMS.

Ndërkohë me sygjerimin e brendshëm nga Dekanati, prej muajit prill 2021 u propozua ofrimi i mundësisë gjithë studentëve në ambientet e shkollës, në format individual për konsultime me stafin pedagogjik për lëndët respektive gjithnjë në respektim maksimal të rregullave antikovid. Kjo solli normalizimin e plotësimin e handikapit të krijuar në semestrin e parë dhe mundësinë e përmblylljes më të sukseshme të procesit mësimor, projekteve artistike dhe procesit të diplomave.

Kjo përjasje e ndihmuar dhe nga normalizimi i gjendjes dhe vaksinimi i stafit të UA-së realizuar në fund të muajit mars 2021, u konkretizua edhe më me Vendimin Rektorit nr. 11 dt. 11.05.2021 “Mbi marrjen e masave për mbarimin e vitit akademik 2020-2021 në Universitetin e Arteve”, i cili specifikonte që duke filluar nga dt. 17.05.2021 **“Fakultetet e UART të organizojnë konsultime në lëndët speciale të cilat janë provime në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Konsultimet të zhvillohen në klasa, studio, atelie apo salla në mënyrë individuale ose dhe në grupe të vogla studentësh në orarin e përcaktuar nga departamenti përkatës.”**

Si rezultat duke filluar nga data 17 maj 2021 u realizuan këto masa:

5. Filloi, ose u intensifikua procesi i konsultimeve në lëndët e atelie, proces që kishte filluar disa muaj më parë, por që me afrimin e fundit të sezonit (dt. 18 qershor 2021) u bë i domosdoshëm për përfundimin me sukses të vitit shkollor.
6. U zhvilluan në klasa, atelie dhe laboratorë konsultime në një numër të kufizuar studentësh, (maksimumi 10) gjithnjë duke respektuar distancat fizike që garantojnë një mbarëvajtje sa më të mirë të gjithë procesit. Në rastet kur ato i kaluan numrin e 10 studentëve u rekomandua ndarja e tyre në 2 grupe, të cilët i zhvilluan konsultimet në dy orare të ndryshme.
7. Për çdo specifike, secili pedagog përcaktoi vetë mënyrën më të përshtatshme, për zhvillimin e konsultimeve, bazuar në veçantinë e programit dhe produktit final. Për çdo paqartësi pedagogët u konsultuan me Drejtuesin e Njësisë Bazë.
8. Sistemi online vazhdoi të ofrohet për gjithë ata studentë që banojnë larg, jashtë kufinjve, apo që e kishin të pamundur për të zhvilluar konsultime fizikisht në ambientet e fakultetit.
9. Lëndët teorike vazhduan dhe mbyllën procesin e leksioneve vetëm në versionin online.

Mbi sezonin e provimeve:

1. U publikuan datat e provimeve të mbartura dhe atyre përfundimtare të vitit akademik 2020-2021.
 - Për provimet teorike, si të mbartuara, apo ato përfundimtare pedagogët respektivë përcaktuan modelin më të përshtatshëm për zhvillimin me sukses të procesit. U këshilluan dy modelet bazë, ai fizik duke respektuar maksimalisht distancat, ndarë në 2 a më shumë grupe, apo versionet alternative me gojë, ose online.
 - Në rastet kur provimi u zhvillua me shkrim në Lektorium u morën masa që numri i studentëve të mos i kalojnë 20-25 studentëve, dhe secili prej tyre të vendoset në një rresht më vete në formë të kryqëzuar në skajet e rreshtit.

- U rekomandua maksimalisht dritaret e dyert e hapura për një ajrosje sa më të plotë të ambjetit. Gjithashtu u rekomandua një distancë 60 min nga njëra seancë provimi në tjetrën për një ajrosje maksimale të ambjetit.

2. Si gjithnjë prioritet maksimal mbeti shëndeti i të gjithëve, i cili mund të parandalohet vetëm nga respektimi maksimal i distancave, mbajtja e maskës në çdo moment, si dhe higjienizmi i duarve dhe ambjeteve.
3. Në rastin të veçanta kur një student, apo disa prej tyre ishin fizikisht të pamundur u pa me prioritet zhvillimi i provimit në versionin online. Pedagogët e lëndës patën një plan rezerve për të përmbushur këtë kërkese specifike, me qëllim evitimin e ardhjes së tyre në këtë kohë pandemie. Vlerësimi i kësaj alternative mbetet në gjykimin personal të pedagogut.

Mbi shikimin e punëve në atelier

1. Për shikimin e detyrave në atelier u respektua ndarja e studentëve në grupe jo më mëdha se 5 studentë, të cilët duhet të vihen në orare të ndryshme psh. Grupi 1 ora 9:30 deri më 10:30, Grupi 2 ora 10:30 deri më 11:30, dhe kështu me rradhë. Duke pasur parasysh që grupi më i madh i studentëve nuk e kalon nr. 18 studentë, (për një mesatare 10 studentë) u sygjera ndarja në 2-3 grupe. Kjo u bë për të evituar grumbullimin e studentëve në ambjete e brendshme të fakultetit, një fenomen që duhej evituar me bashkëpunimin sa më rigoroz të stafit pedagogjik, në bashkëpunim dhe me administratën e Fakultetit. Për çdo nevojë u angazhua dhe stafin ndihmës i administratës, apo dhe laborantët respektiv.
2. Gjatë kohës së shikimit të punëve në atelier u bë kujdes për respektimin e distancave, vendosjes së domosdoshme të maskës nga gjithë stafi dhe studentët.
3. Për provimet përfundimtare, diplomimi për Nivelin Bachelor dhe Master, procesi u zhvillua pa prezencën e publikut, por vetëm me prezencën e studentit dhe komisionit.
4. Përgjatë gjithë procesit u respektuan me rigorozitet maksimal të gjithë masat e paralajmëruara antikovid, distancimin social, mbajtja e maskës në çdo moment dhe hapësirë, dizifektimin sa më të shpeshtë të duarve.
5. Sezoni i provimeve të verës në nivelin Bachelor u hap në dt.19 qershor ndërsa diplomimi u zhvillua në dt. 5 korrik 2021.
6. Sezoni i provimeve të verës në nivelin Master u hap në dt.15 qershor ndërsa diplomimi u zhvillua në dt. 8-13 korrik 2021. Për një zhvillim më cilësor të procesit u ngritën dy komisione, drejtuar nga pedagogët me titull më të lartë, respektivisht Prof. Sadik Spahija, Prof.Ass. Pjerin Kolnikaj, Prof.Ass. Genc Mulliqi, Lektor Ergys Krisiko, Lektor Vladimir Llakaj dhe Lektor Viktor Ferraj.
7. Procesit në tërësi u zhvillua normalisht.
8. Ndërkohë me vendim të Senatit të UA me nr. 11, dt. 21.06.2021 mbi “Disa ndryshime në rregulloren e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe rregulloren e Ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master në UART për vitin akademik 2020-2021.
9. Gjatë 20 shkurt-14 2022 mars u bë Prezantimi i Punëve Bachelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë.
10. Gjatë muajve gusht- shtator 2022 u organizua konkursi për pranimin në shkollë.
11. Për krijimin e mundësisë të dhënies së provimeve për të gjitha lëndët duke përfshirë dhe ato speciale në tre sezone u bë e mundur hapja e Sezonit të Vjeshtës për 2021-22.
12. Pas shpalljes së datave, procesi i provimeve dhe diplomimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe e Ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master u zhvillua me sukses në datat 6-30 shtator 2022 sipas kalendarit të strukturës vjetore.

13. Pas shpalljes së datave, procesi i provimeve dhe diplomimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe e Ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master u zhvillua me sukses në datat 6-30 shtator 2022 sipas kalendarit të strukturës vjetore.
14. Sezoni i provimeve të verës në nivelin Bachelor u hap në dt.19 qershor ndërsa diplomimi u zhvillua në dt. 12 korrik 2022
15. Sezoni i provimeve të verës në nivelin master u hap në dt.19 qershor ndërsa diplomimi u zhvillua në dt. 17 korrik 2022

Programi i studimit Skulpturë

16. Misioni i këtij program studimi është që të formojë studentë me dije akademike dhe artistike në lidhje me skulpturën, vëllimin dhe marrëdhënien e veprës artistike me hapësirën ku do të ekspozohet. Ky process aftësimi arrihet nëpërmjet ushtrimeve, detyrave dhe projekteve, që realizohen në mënyrë individuale nga studentët nën drejtimin e stafit akademik. Ushtrimet dhe detyrat kanë për qëllim të rrisin aftësinë analizuese dhe interpretuese të studentit në marrëdhënie me figurën njerëzore dhe subjekte të tjera. Projektet kanë si qëllim rritjen e kapacitetit krijues dhe punës së pavarur të studentit.
17. Në Ciklin e Parë të Studimit (Bachelor) i jepet një rëndësi më e madhe rritjes së kapacitetit analizues dhe interpretues të studentit nëpërmjet ushtrimeve dhe detyrave studimore. Studentët njihen me gurët, mermerët, hekurin, drurin e material të tjera, teknikat e punimit të tyre si dhe mjetet më efikase që ofron teknologjia e kohës.
18. Në Ciklin e Dytë të Studimit (Master) i jepet një rëndësi parësore rritjes së kapacitetit krijues, punës së pavarur dhe debatit të hapur të studentëve; perfeksionohet raporti aktiv dhe krijues i tij, i lidhur ngushtë me eksperimentimin dhe specifikat e materialeve.
19. Njohja dhe përpunimi i materialeve e më pas eksperimentimi me ta, realizohet në laboratorin e skulpturës dhe është pjesë e rëndësishme e procesit të punës së ateljerit të skulpturës në të dy ciklet e studimit.

Programi i studimit Skulpturë Qeramikë

20. Atelieri i Skulpturës Qeramikë ka për mision formimin e artistëve qeramistë në dy drejtime kryesore: Qeramikë Artistike edhe Qeramikë Industriale (dizajn). Synimi kryesor është krijimi i koncepteve të drejta te studentët për shprehjet plastike në rrafsh/hapësirë nëpërmjet aftësimit të tyre profesional për realizime të pavarura dhe me individualitet krijues.
21. Procesi në Ciklin e Parë të studimit (Bachelor), shoqërohet me studime plastike dhe projekte, të cilat i orientojnë studentët drejt zhvillimeve bashkëkohore.
22. Laboratori është vendi ku ekzekutohet dhe eksperimentohet teknikisht pjesa më e madhe e projekteve të qeramikës artistike dhe industriale. Në laborator studentit merr njohuritë bazë mbi materialet, procesin tekniko-teknologjik dhe praktikon punën me allçi, baltë, glazurë, pjekjen, veçoritë dhe mënyrat e përdorimit të materialeve të ndryshme.
23. Në Ciklin e Dytë (Master) studentët orientohen në bazë të prirjeve individuale dhe hapësirave të tregut të punës në zhvillime të veçanta të qeramikës artistike apo industriale.
24. Gjatë këtij viti u realizua dhe paisja e laboratorit me furra të reja të teknologjisë së fundit, përkatësisht furrë muffle 1300 °C dhe furra tjetër 1300 °C.

2. Akreditimi i UART 2021

Sipas urdhërit të Rektorit të UART, nr. 96, dt. 11.06.2021 bazuar në vendimin e bordit të akreditimit nr. 68 dt. 21.09.2017, "Për kreditimin e parë të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i Arteve të Tiranë" u ngrit një grup pune ku Drejtuesi i Njësisë Bazë, Dr. Ermir Hoxha ishte antar dhe përfaqësues i Fakultetit të Arteve të Bukura.

Si rrjedhojë:

1. Pas direktivave dhe të Dekanit u morën masa për plotësimin e dokumentave të kërkuara nga drejtuesi i Grupit të punës, Prof. Dr. Erald Bakalli,
2. U azhurnuan të gjithë sillabuset e Fakultetit.
3. U ofruar informacion dhe asistencë për çdo antar tjetër të grupit sipas kërkesave specifike të secilit.
4. U plotësua dokumentacioni me raportet përkatëse.

3. Aktivitete të realizuara nga Njësinë Bazë Skulpturë

Master-Class, Leksione të Hapura, Ekspozita dhe Tryeza të rrumbullakëta.

Përgjatë vitit akademik 2021-22 Departamenti i Skulpturës ka siguruar organizimin dhe mbarëvajtjen e një numri të konsiderueshëm aktivitetesh.

Më konkretisht përgjatë vitit akademik 2021-22 janë zhvilluar:

20 shkurt-14 mars 2021	Prezantimi i Punëve Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
11 qershor 10 korrik 2021	Prezantimi i Punëve Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
2-12 korrik 2021	Diplomat Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
10-15 korrik 2021	Ekspozitë në Hollin e Shkollës nga student i Batchelor Skulpturë v. III Euro Rasa
9-13 korrik 2021	Prezantimi i Punëve Master Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
10-15 korrik 2021	Diplomat Master Skulpturë Ekspozitë në Galerinë FAB

20 shkurt-14 mars 2022	Prezantimi i Punëve Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
11 qershor 10 korrik 2022	Prezantimi i Punëve Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
2-12 korrik 2022	Diplomat Batchelor Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
9-17 korrik 2022	Prezantimi i Punëve Master Skulpturë dhe Skulpturë-Qeramikë
10-17 korrik 2022 17-22 korrik 2022	Diplomat Master Skulpturë Ekspozitë në Galerinë FAB

Cështje të Tjera

Problematika 1. Konstatohet përsëri mungesa e mbështetjes financiare që Atelietë dhe pedagogët duhet të kenë në funksion të një zhvillimi normal të aktivitetit artistik dhe shkencor. Konkretisht:

- Pajisjet në Laboratorin e Qeramikës janë tejet të amortizuara, nevojiten disa pajisje të reja, - Të gjitha pjesëmarrjet e stafit akademik në konferenca shkencore, aktivitete ekspozitash etj...

janë mbuluar me shpenzimet e vetë stafit akademik ose me fonde të siguruar nga këta të fundit nëpërmjet aplikimeve në donatorë të ndryshëm.

- E njëjta problematikë vërehet edhe për financimin e botimeve të studimeve, përkthimeve të stafit akademik.

KRYETARE E DEGËS

PUNËT E REALIZUARA PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 NË FAB.

Kryetarja e degës në FAB në bashkëpunim dhe koordinim edhe me strukturat e tjera në rektorat edhe në fakultet ka qënë e angazhuar të realizojë çdo detyrë administrative, funksionale si dhe operative ditore dhe vjetore.

Në zbatim të planit vjetor të punës dhe detyrave funksionale të pozicionit të punës kam udhëhequr punën dhe kam përgatitur projekt buxhetin (Pjesën e shpenzimeve operative dhe investimet) bashkëpunim me përgjegjësit e njësisive bazë për përgatitjen e orarit vjetor mësimor dhe koordinimit të hapësirave, përgatitjen e dokumentacionin ditor për shërbime dhe mirëmbajtje, dokumentacioni ditor për listëprezencën dhe çdo dokumentacion tjetër të kërkuara nga administratori i UART.

Së bashku me punonjësit në varësi (specialistët dhe laborantët mësimor) kemi mbajtur në gjëndje pune ambientet mësimore dhe infrastrukturën mbështetëse. Në sezonin e verës janë mbikqyrur punimet për mirëmbajtjen e ambienteve në çdo atelier të FAB, laborator dhe në Galerinë FAB.

Çdo ditë kemi garantuar shërbim, kontroll periodik të rrjetit elektrik, hidraulik si dhe higjienizimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve.

- Kam ndjekur me përpikmëri zbatimin e buxhetit të miratuar duke ju përgjigjur të gjitha kërkesave të atelier-laboratore për bazë materiale për vitin akademik 2022 në FAB.
- Organizim për parashikimin e projekt-buxheti për vitin 2022, për të gjitha nevojat që do të kenë labororet/ atelieret bashkë me shefat e Departamentit i kemi prezantohet Dekanit dhe Administratorit UART.
Në zbatim të Ligjit «Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë», "Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar me akte ligjore, Ligjit të Kuvendit të Shqipërisë «Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar, Ligjit Nr. 9367, datë 07/04/2005 "Për parandalimin dhe Konfliktin e Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike", Ligjit 119/2004 "Për të Drejtën e Informimit", Ligjit 9887, datë 10/03/2008 i ndryshuar me ligjin 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore të eprorëve tanë, të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në bashkëpunim të ngushtë me Rektorin e UART, Administratorin e institucionit, me Sektorët e tjerë respektivë që ka lidhje të pashmangshme pune, gjatë vitit kalendarik 2021, duke zbatuar korrektësi Plan-Programin Vjetor të Punës për vitin 2022, në rezymenë (gëthmonë sa më të përmbledhur) të punës së saj rezulton sa më poshtë vijon:

nr	Koha e kryerjes së aktivitetit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Mai	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
	Emërtimi i aktivitetit												
1.	Hartimi i të gjithë procedurave të Dr.MBNJ												
2.	Hartimi i Planit të punës për vitin 2022 të DrMBNJ												
3.	Ndjekja e procedurës së punësimit të personelit akademik/ ndihmës dhe të stafit administrativ												
4.	Lidhja e kontratave të punës me personelin akademik/administrativ dhe ndihmës												
5.	Përditësimi i regjistrit të punonjësve mbi performacën në punë (kontroll i befasishëm)												
6.	Shqyrtimi i dokumentacionit të dosjeve personale të stafit dhe kontrolli i tyre periodik												
7.	Studimi i akteve ligjore dhe nënligjore për çështje që lidhen me Burimet Njerëzore dhe UART												
8.	Zhvillimi i takimeve të punës me specialistët e personelit në Rektorat/ Fakultete me qëllim bashkëpunim dhe përmirësimin e punës.												
9.	Hartimi i planit të lejeve të zakonshme për personelin akademik / administrativ												
10.	Plotësimi i librezave Personale të punës për punonjësit.												
11.	Ndjekja e ndryshimeve në paga të personelit të UART për shkak të kualifikimeve përkatëse dhe bazuar kjo në Vendimet e Këshillit të Ministrave												
12.	Ndjekja dhe zbatimi i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.												
13.	Ndjekja dhe zbatimi i Ligjit për të drejtën e informimit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Si autoritet përgjegjës												
14.	Ndjekja e propozimeve për të bërë dekorimet e punonjësve												
15.	Nxjerrë të dhëna mbi personelin e UART duke shqyrtuar regjistrat që disponon kjo Drejtori.												
16.	Ndjekja e ecurisë dhe mbarëvajtjes së punës për personelin e UART.												
17.	Ndjekja dhe zbatimi i Ligjit për Deklarimin dhe kontrollin e pasurisë si Autoritet përgjegjës												

periodikisht sipas kërkesave të tyre, rreth konfliktit të interesave të autoriteteve, në Universitetin e Arteve.

- Në bashkëpunim të ngushtë me Dekanët e Fakulteteve, udhëhequr nga Rektori i UART, organizoi përpunimin e Strukturës Organizative dhe Analitike të UART, duke u konsultuar me Dekanët e Fakulteteve dhe Përgjegjësit e Njësive Kryesore për përputhshmërinë sa më konkrete të pozicioneve të punës me kualifikimin përkatës të çdo punonjësi mësues, (sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave 331/2009) me ndryshimet përkatëse sipas kërkesave të sektorëve/Fakulteteve.
- Në fund të muajit Mars 2022 në bashkëpunim me Rektoren UART dhe Dekanet e Fakulteteve u bë dhe planifikimi i lejes vjetore për vitin 2022, si për punonjësit mësues ashtu edhe për punonjësit e administratës sipas Ligjeve dhe akteve përkatëse. Universiteti i Arteve duke qenë institucion arsimit, fillimin e lejes vjetore e ka gjithmonë në fund të procesit mësues. Kjo Drejtori përgatiti gjithë praktikën e lejeve vjetore.
- Sipas kërkesave të Drejtorisë së Menaxhimit dhe Burimeve Njerëzore/etj në MAS, kjo drejtori ka informuar rregullisht të dhëna për punonjësit mësues, jo mësues dhe për punonjësit me kontratë të përkohshme.
- Në bashkëpunim të ngushtë me Zv/Rektorin Mësues dhe Njësitë Bazë të fakulteteve të udhëhequr gjithnjë nga Rektori, në muajin Gusht 2022, u përgatitën procedurat e Konkursit për marrjen në punë të punonjësve mësues me kontratë me kohë të pjesshme dhe normë të reduktuar/ dhe të ftuar.
- Ky proces filloi me publikimin në Faqen e Web-it të UART në muajin Gusht 2022, Vendimi i Senatit akademik nr. 30/20.07.2022 “Numri i personelit akademik të Uart/me kohë të plotë/me kontratë/ me kontratë me kohë të pjesshme dhe normë të reduktuar”/ Vendimi i Senatit akademik nr. 31/20.07.2022 “Miratimi i kriterëve të punësimit të personelit akademik të Uart me kohë të pjesshme dhe normë të reduktuar” dhe Përfundoi në fillim të procesit mësues.

Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Inf.SJP-A, për çdo hap të procesit të rekrutimit të punonjësve mësues me kontratë me kohë të pjesshme dhe me normë të reduktuar, informoi Rektoren për mbarëvajtjen e procedurave dhe zbatimin e Urdhërave nga Komisionet ad-hoc të Fakulteteve, deri në përfundimin e tyre duke e finalizuar me Miratimin e punonjësve nga Senati Akademik/Rektori.

Kjo Drejtori në bashkëpunimin të vazhdueshëm dhe tepër frytdhënës me Zv. Rektoren për Mësimin, përgatiti materialin e Miratimit të punonjësve mësues me kontratë me kohë të pjesshme dhe me normë të reduktuar, Projekt – Vendimin duke ia paraqitur Senatit Akademik për miratimin e Punonjësve në përshtatshmëri me aktet ligjore në fuqi.

Në vijim të pikës së mësipërme Sekretariati Teknik përgatiti dhe materialin për miratimin e numrit punonjësve mësues me kontratë me kohë të pjesshme dhe me normë të reduktuar në Bordin e Administrimit të UART.

Kjo Drejtori në bashkëpunimin të vazhdueshëm dhe tepër frytdhënës me fakultetet sipas kërkesave të tyre janë kryer punësimet sa më poshtë:

Nr.	Fakulteti/ Rektorati	Nr. personelit	Pozicioni
1.	Fakulteti i Muzikës	2	akademik
2.	Fakulteti i Arteve të Bukura	2	akademik
3.	Fakulteti i Artit Skenik	4	akademik
4.	Rektorat	4	administratë

- Kjo Drejtori u angazhua edhe në Grupin e punës për Menaxhimin Strategjik të Universitetit të Arteve, Buxhetit Afatmesëm dhe me grupin më të rëndësishëm atë të Akreditimit të Programeve mësuese të Uart... etj .
- Duke qenë Njësia përgjegjëse për regjistrimin e kërkesave, koordinimin dhe përgatitjes së praktikës së informacionit, Drejtorja e menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në zbatim të

Ligjit të Arsimit të Lartë, i ndryshuar, Ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" së bashku me Sektorin e IT, konsultohet me Ligjin 119/2004 "Për të Drejtën e Informimit" dhe ligjit 9887, datë 10/03/2008 i ndryshuar me ligjin 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Kjo Drejtori ka freskuar e rifreskuar sipas Ligjit çdo 3 (tre) muaj faqen e Transparencës së UART. Në bashkëpunim me Sektorin e IT janë shpalluar në këtë faqe të Universitetit të gjitha aktet Urdhëra e Vendime të rëndësishme të Universitetit tonë (sipas Ligjit të transparencës)

- Drejtorja e MBNJ e udhëhequr nga Titullari i institucionit, ka ndjekur procedurat e kualifikimeve të punonjësve dhe sistemimin e tyre në pozicionin e punës sipas kualifikimit përkatës.
- Në bashkëpunim me Administratorin dhe Sektorët respektive që merren me Buxhetin e UART, u përgatit materiali për Buxhetin 2022, duke mos bërë lejen e plotë vjetore me qëllim përmbushjen e afateve të ministrisë përgjegjëse.
- Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Inf.SJP-A, një nga detyrat plotësuese të kohës së punës ka edhe Protokollin e Uart:

1. Plani i punës së Protokollit për vitin 2022

N.r.	Koha e Kryerjes së Aktivitetit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Hartimi i procedurës së protokollimit të dokumentave.												
2	Hartimi i Rregullores së Protokollit												
3.	Ndjekja e procedurës së evidentimit dhe shpërndarjes së korrespondencës zyrtare që vjen në Rektorat dhe veprimet për nisjen e saj sipas destinacioneve përkatëse.												
4.	Protokollimi dhe administrimi i çdo dokumenti tjetër të brendshëm si raporte, studime, relacione, procesverbale, plane pune, si të gjitha dokumentet e tjera relevante.												
5	Mbajtja e kontakteve me MAS për marrje dhe dhënie informacioni reciproke.												
6.	Zbatimi i standardeve institucionale të cilësisë që lidhen me aktivitetet e Protokollit si dhe përmirësimi vazhdimisht i cilësisë së punës.												

- Duke bërë edhe detyrën e Protokollit, çdo shkresë e ardhur nga institucionet e tjera Titullare apo të bashkëpunimit, shkresa që vijnë nga Fakultetet dhe çdo person që kërkon një të drejtë apo një përgjigje shkrese, e protokollon dhe e përcjell, sipas lëndës së shkresës në destinacionin përkatës. Në fund të vitit kalendarik këto dokumente bashkohen me dokumentat e brendshme dhe arkivohen sipas lëndës, qëllimit në Sektorët respektivë.

Specialisti i Arkivit

Performanca/Analiza 12 mujore e punës për vitin 2022.

N.r.	Koha e Kryerjes së Aktivitetit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
	Emertimi i Aktivitetit												
1	Hartimi i procedurës së arkivimit të dokumentave.												
2	Hartimi i Rregullores së arkivit												
3.	Ndjekja e arkivimit të evidentimit dokumentacionit sipas strukturës												
4.	Hartimi i listave konkrete me afatet e ruajtjes së dokumentacioneve si dhe lista tip e përgjithshme.												
5	Hartimi i urdhërit për ngritjen e komisionin të ekspertizës, si dhe urdhërin për asgjestimin e dokumentacioneve të përkohshëm.												
6.	Çelja e dosjeve sipas pasqyrës emërtuese për dosjet RHK dhe 5-10 Vjet.												
7.	Mbajtja e kontakteve me Drejtorin e Përgjithshme të Arkivit për marrje dhe dhënie informacioni reciproke.												

- o Po merret me dorëzimin e dokumentacionit të arkivit (të viteve të paraardhës), e cila është një punë tepër voluminoze.

Sektori IT

Performanca/Analiza 12 mujore e punës për vitin 2022.

Angazhimi i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga vënia në një rrafsh e vizionit të zhvillimeve teknologjike me strategjitë Institucionale, duke kryer integrimin e proceseve me teknologjitë përkatëse. Sektori i Teknologjisë së Informacionit është gjithashtu përgjegjës për të gjitha aspektet e zhvillimit dhe implementimit të iniciativave me bazë teknologjike brenda Institucionit. Ky Sektor administron sistemet ekzistuese, njëkohësisht duke i dhënë zgjidhje të gjitha problematikave të lindura në mbështetje të proceseve të Teknologjisë së Informacionit dhe vlerave bazë të Institucionit. **PËRSHKRIM I ANGAZHIMEVE TË SEKTORIT TË TI** Momentet kryesore të angazhimit të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Universitetin e Arteve, janë:

1. Administrimi i rrjetit kompjuterik të Institucionit me të gjitha elementet përbërëse të tij në tërësi në nivelin harduer dhe softuer, që përfshin administrimin e njës kryesore dhe njësive në përbërje të saj, ashtu si edhe të njësive sekondare e terciare të ndërlidhjes fizike dhe me valë,

nëpërmjet proceseve të adresimit dhe kontrollit të regjistrit të adresave elektronike, menaxhimit të sigurisë në hyrje dhe në rrjetin e brendshëm, konfigurimeve dhe kontrollit në distance të njësive përbërëse të zinxhirit të komunikimit, monitorimit të vazhduar të cilësisë së shërbimit, mbajtjes së kopjeve rezervë të konfigurimeve, diagnostikimit të defekteve, zëvendësimit dhe konfigurimit të pajisjeve të reja, etj, ashtu si edhe shtrimin, riparimit apo zëvendësimit të linjave fizike të ndërlydhjes në rrjetin institucional; Faqe 2 nga 6

2. Administrimi i çdo stacioni pune (kompjuterik) të institucionit për personelin administrativ, stafin akademik, stafin ndihmës-akademik, sallat dhe laboratorët mësimorë, stacionet e punës në sallat dhe ambientet e performancave, etj, që përfshin instalim të njësive kompjuterike fizikisht, diagnostikim dhe riparim të defekteve teknike, zëvendësim, instalim dhe konfigurim të elementeve harduer, ashtu si edhe instalime dhe konfigurime në nivel softuer duke përfshirë instalime të sistemeve operative, paketave softuer apo programeve kompjuterike specifike, konfigurime të përgjithshme apo specifike, konfigurime në rrjetin institucional, etj. Angazhimi njëkohësisht përfshin asistimin kundrejt personelit të Institucionit në procese të punës lidhur me përdorimin e programeve kompjuterike të ndryshme – në vendndodhje apo në “cloud”, asistimin mbi printimin, përpunimin dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave dhe informacionit, asistimin mbi përdorimin e sistemeve operative, etj;

3. Administrimi cilësor dhe sasior i shërbimit të internetit brenda Institucionit;

4. Menaxhimi dhe administrimi i Platformës “Microsoft Office 365” e cila përdoret për shkëmbim të materialeve didaktike, komunikim, realizim të konsultimeve audiovizuale online, përdorim të paketës office, akses në email-in universitar, etj, që përfshin administrim të bazës së të dhënave të përdoruesve dhe të aksesit, konfigurim dhe administrim të moduleve të përfshira në platformë si Azure Active Directory, Exchange, Sharepoint, Teams, Stream, Onedrive, modulet Office, etj;

5. Administrimi i sistemit PITAGORA, i përdorur për menaxhimin e studimeve dhe të kurrikulës në shërbim të marrëdhënies Pedagog - Student – Institucion, të mundësuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH), në bashkëpunim me Sekretariatë e Fakulteteve në Dekanate dhe në koordinim me RASH, si dhe asistim kundrejt Pedagogëve dhe Studentëve lidhur me përdorimin e tij;

6. Administrimi i prurjeve të reja (studentëve të rinj) në Universitetin e Arteve realizohet përmes përdorimit të sistemit dhe të portalit U-Albania dhe ndërlydhjes së këtij portali me sistemin PITAGORA, të vëna në dispozicion nga RASH, proces i cili administrohet nga Sektori i TI në koordinim me RASH, Sekretariatë Mësimore në Dekanate, si dhe me Sektorin Statistikë-Informacion dhe Sektorin Mësimor në Rektorat;

7. Angazhim si Sekretariat Teknik pranë Këshillit të Etikës së Universitetit;

8. Administrim i platformës GRADUA e cila adreson proceset ALUMNI në UART, të ndërtuar përmes projektit të Erasmus+ KA2 nën të njëjtin emër, në koordinim me Zyrën e Projekteve si dhe strukturat paralele në Rektorat

9. Administrimi, përditësimi dhe pasurimi me funksionalitete i shërbimeve elektronike të Bibliotekës Shkencore të Universitetit, të cilat ofrohen për anëtarët e saj përmes dy sistemeve të zbatuara gjatë viteve 2011 dhe 2012, të përbëra nga 1) sistemi i menaxhimit të integruar ërmes të cilit Biblioteka kryen katalogimin dhe administrimin e fondit fizik të librave, kartelave elektronike, qarkullimit, etj, si edhe kryen shfaqjen përmes shfletuesit publik (OPAC) të titujve për audiencën e gjerë; dhe 2) sistemi i arkivit digjital përmes të cilit përdoruesit kanë mundësi të shfletojnë materialet në Faqe 3 nga 6 trajtën elektronike (digjitale). Gjithashtu administrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave në rrjet të ruajtjes së arkivave multimediale;

10. Administrimi i serverit të vënë në dispozicion të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve për mbajtjen e kopjeve rezervë të dokumenteve dhe të dhënave;

11. Administrimi i portalit zyrtar ueb të Institucionit, përditësim i vazhduar me informacion në bashkëpunim me Sektorët dhe strukturat përkatëse në Dekanate dhe Rektorat;

12. Administrimi i shërbimit dhe adresarit e-mail të Institucionit;

13. Administrimi i të gjitha faqeve të Institucionit në rrjetet sociale (Facebook, Google, Instagram, Twitter, LinkedIn, Youtube) dhe përditësimi i vazhdueshëm me informacion në lidhje me aktivitete të zhvilluara apo promovime të aktiviteteve të ardhshme; të reja dhe njoftime mbi proceset akademike, workshop-e, masterklasë, konkurset, pranimet, provimet, thirrjet për aplikime, bashkëpunime, etj; zhvillimin e projekteve të ndryshme në të cilat Institucioni është pjesëtar/ partner/ bashkëpunëtor, bashkëpunime ndërinstitucionale, etj; Shpërfaqje e regjistrimeve nga skenat të shfaqjeve, koncerteve, performancave, etj, ashtu si edhe shpërfaqje të punimeve të Degës së Regjisë së Filmit dhe Televizionit pranë Fakultetit të Artit Skenik, etj.

14. Administrimi i sistemit të video-mbikëqyrjes me kamera CCTV të Institucionit, që përfshin mirëmbajtje të infrastrukturës dhe të sistemit në tërësi, instalim dhe konfigurim të kamerave në rastet e zhvendosjes së tyre, etj, si dhe realizimi i proceseve të Monitoruesit në përputhje me përcaktimet në Rregulloren përkatëse;

15. Administrimi i Sistemit të Parkingut me kartë, programim i kartave të aksesit sipas udhëzimeve të marra nga Dekanatet dhe Rektorati, administrim i të dhënave të përdoruesve në bashkëpunim me DMBNJ. 16. Administrimi i projekteve të profilit të Teknologjisë së Informacionit në Institucion nëpërmjet hartimit të strategjive Institucionale të zhvillimit të TI, hartimit të projekteve argumentuese dhe teknike, propozimeve për investime në drejtim të zhvillimit të infrastrukturës së TI, etj;

17. Ndjekje e zbatimit nga Palët e Treta dhe ndjekje e marrëdhënies sa i takon vijimësisë së projekteve dhe shërbimeve në profilin e Teknologjisë së Informacionit në Institucion; 18. Përfaqësimi i Institucionit gjatë ndërveprimit me Palë të Treta për çështje që kanë të bëjnë me Teknologjinë e Informacionit; 19. Organizimi i mbledhjeve, seminareve, trajnimeve, etj, në funksion të rritjes së ndërveprimit dhe cilësisë së edukimit me në bazë Teknologjinë e Informacionit; 20. Si dhe gjithashtu mbështetja në drejtim të Teknologjisë së Informacionit sipas nevojave të parashtruara për realizimin e aktiviteteve të veçanta të Universitetit. Sektori i Teknologjisë së Informacionit është i përkushtuar për realizimin e angazhimeve, duke ngulmuar në shërbim cilësor, të shpejtë dhe korrekt.

Te gjitha aktivitetet dokumentohen. Faqe 4 nga 6 TË DHËNA STATISTIKORE Në vijim gjeni një tabelë me të dhëna statistikore të përmbledhura të volumit të shërbimeve të realizuara nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2022: 150+ m-l Linja rrjeti të vendosura në ambiente të jashtme, të brendshme, zyra, klasa mësimore, galeri, atelierë, etj. 15+ Pajisje të ndërlihdjes në rrjet (kabllor ose me valë) të vendosura dhe të konfiguruar, të zhvendosura apo të riparuar. 8-10 orë Pune mesatarisht në javë dedikuar instalimit të elementeve në rrjet. 10 orë Pune mesatarisht në javë dedikuar konfigurimit dhe shërbimeve në rrjet dhe internet. 10-12 orë Pune mesatarisht në javë dedikuar shërbimit të riparimit të pajisjeve kompjuterike të institucionit fizikisht. 10-12 orë Pune mesatarisht në javë dedikuar shërbimit në nivel softuer për administratën (instalime, konfigurime, asistim në procese të punës, etj) 24 orë Angazhim për mbikëqyrjen e pa-ndërprerë e cilësisë së shërbimit në rrjet dhe në internet për Institucionin. 200+ Kërkesa për mbështetje teknike të adresuara telefonikisht dhe elektronikisht. 100+ Kërkesa për mbështetje teknike të adresuara fizikisht (duke përfshirë konfigurim pajisjesh kompjuterike personale te stafit akademik). 10+ Seanca video-trajnimi rreth përdorimit të sistemit PITAGORA. 100+ Mesazhe të shkëmbyera me RASH dhe angazhim në shërbim të platformave të vendosura në dispozicion të UART, siç janë sistemi i menaxhimit të kurrikulës dhe studimeve "PITAGORA", portali "U Albania", etj. 15 orë Pune në javë mesatarisht dedikuar përditësimit me informacion dhe administrimit të medimeve zyrtare të komunikimit të UART, siç janë portali www.uart.edu.al, faqet në rrjetet sociale kryesore, njoftimet nëpërmjet postës elektronike, etj. 2-5 orë Pune në javë mesatarisht dedikuar mirëmbajtjes së sistemit të videombikëqyrjes CCTV të Institucionit si dhe përmbushjes së angazhimeve të Monitoruesit

në përputhje me rregulloren përkatëse, si dhe zhvendosjes dhe konfigurimit të kamerave, pjesë e këtij sistemi. 30+ Karta të parkingut të Institucionit të programuara, sipas udhëzimeve nga DMBNJ. Si dhe njëkohësisht, angazhim në shërbim të studimit, hartimit të dokumentacionit teknik dhe argumentues, si dhe propozimeve për investime në drejtim të zhvillimit të infrastrukturës së TI në Institucion; angazhim me ndjekjen e zbatimit të projekteve nga palë të Treta; angazhim në takime, seminare, trajnime, etj, të organizuara nga palë të treta për çështje të teknologjisë së informacionit. Faqe 5 nga 6 Gjithashtu Sektori i TI ka treguar gatishmëri të vazhdueshme për nevoja të lidhura me aktivitete të veçanta të realizuara në Universitet.

RISKU - PROBLEMATIKAT QË MUND TË SHFAQEN GJATË VITIT PASUES

Sektori i TI thekson nevojën për investime në drejtim të infrastrukturës së TI. Këto propozime për investime janë parashtruar në mënyrë të detajuar në Rektorat, të përqendruara pikat kryesore si më poshtë vijon:

1. Zbatimi i një infrastrukture të rrjetit kompjuterik të standardeve bashkëkohore, nëpërmjet plotësimit/ përditësimit të infrastrukturës ekzistuese me konektivitet hibrid fibër optike/ kabëll lan cat7, me synim kompletimin në tërësi të ndërlidhjes së komunikimit të të dhënave elektronike të kampusit Universitar si dhe të çdo ambienti në përbërje të tij, plotësuar me pajisjet përkatëse të ndërlidhjes/ adresimit/ sigurisë/ kontrollit të cilësisë. Shënim: Kjo pikë është aktualisht në proces përditësimi. Me zbatimin e infrastrukturës së re për Korpusin Qendror, standardet për këtë pjesë të kampusit janë përmirësuar ndjeshëm.

2. Zbatimi i një infrastrukture pa kablllo "wireless" për kampusin Universitar me administrim të qendëruar, nëpërmjet zbatimit të një sistemi të plotë të konektivitetit me valë të përbëre nga transmetuesit dhe njësia qendrore e koordinimit/ adresimit/ kontrollit të cilësisë, në mënyrë që të mundësohet mbulim i plote dhe efikas i kampusit me këtë shërbim.

3. Zbatimi i një sistemi telefonie për zyrat e Institucionit, të standardit VOIP.

4. Investimi për zbatimin e një strukture komunikimi të kompletuar të të dhënave elektronike brenda Institucionit në standardin "Active Directory" me "Domain Controller" dhe "Roaming Profile", i cili të konsistojë në blerjen e dy Serverëve profesionalë me konfigurim për redundancë të plotë, dhe në kontraktimin për zbatimin e kësaj strukture komunikimi nga palë të treta, duke përfshirë mirëmbajtjen të paktën 5 vjeçare.

5. Investimi për ndërtimin e një portali të ri bashkëkohor Universitar, si portë kryesore identifikuese dhe reklamuese e Universitetit në domain-in virtual dhe si rrugëkalim kryesor i shkëmbimit të informacionit ndërmjet grupeve të interesit, shërbim i cili të kontraktohet me palë të treta, duke parashikuar edhe mirëmbajtjen të paktën 5 vjeçare. Shënim:

Kjo pikë është ende në proces zbatimi nga një shoqëri private përmes një projekti të financuar nga T

-Mobile në vitin 2019. 6. Investimi për ndërtimin e një sistemi të arkivimit fizik (me barkodim) dhe digjital të dokumentacionit të Drejtorisë së BNJ, Informacionit dhe Protokol-Arkivit. Faqe 6 nga 6 NË PËRMBYLLJE Gjatë vitit 2022, një vit dinamik në planin e proceseve të Teknologjisë së Informacionit, janë synuar të përmbushen të gjitha detyrimet dhe angazhimet me përkushtim dhe profesionalizëm. Është treguar vëmendje e veçantë sidomos për momentet e mëposhtme:

- Hartimi i buxheteve vjetore dhe afatmesme për investimet në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, ashtu si edhe për infrastrukturën teknike të laboratorëve mësimorë. Gjithashtu në të njëjtin rrafsh, propozimi me studimin, argumentimin, hartimin e specifikimeve teknike, përlllogaritjen e kostove, etj, për investime novatore në infrastrukturën e TI;

- Angazhim përgjatë periudhës së konkurseve të pranimit përmes përpunimit të të dhënave në bashkëpunim me Sekretaritet Mësimorë në Fakultete dhe publikimin e tyre në portalin UALBANIA e në mediumet elektronike të UART;

- Administrimi për sa i takon përditësimit të të dhënave të UART në portalin UTransparenca, në bashkërendim me Drejtorinë Ekonomike dhe Zv. Rektorin për anën mësimorë; - Përditësimi

i vazhdueshëm i politikave të sigurisë në rrjetin kompjuterik Institucional, ashtu si edhe realizimi i fushatave të informimit me synim rritjen e aftësisë në drejtim të përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit në dispozicion, ashtu si dhe rritjen e vetëdijes mbi rreziqet që mund të shfaqen gjatë punës me mjetet e TI si dhe mënyrat e përbaljes me to; - Komunikimi i vazhduar dhe bashkëpunimi me RASH lidhur me të gjitha çështjet, siç është sistemi i menaxhimit të studimeve dhe kurrikulës PITAGORA (duke përfshirë koordinimin e punës me Sekretariatë Mësimore dhe strukturat paralele), pjesëmarrja në projekte të ndryshme të RASH, ndjekja dhe administrimi i platformave të tjera në përdorim të zhvilluara nga ana e RASH (portali UAlbania), etj; - Angazhimi me grupin e vlerësimit të brendshëm Institucional gjatë proceseve të Akreditimit Universitar.

Sektori Informacionit & Statistikës

Performanca/Analiza 12 mujore e punës për vitin 2022.

Në zbatim të Urdhrit të Rektorit nr 74, datë 02.11.2022, me nr.Prot 1662 datë 02.11.2022 “Mbi zhvillimin e Analizës Vjetore të punës për vitin akademik 2021-2021 në Universitetin e Arteve, analiza vjetore e Sektorit të Informacionit dhe Statistikës gjatë vitit 2021-2022 në mbështetje të nenit nr. 32, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL, në Republikën e Shqipërisë”, si dhe detyrave të përcaktuara në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Universitetit të Arteve dhe ato të përcaktuara nga Rektori, nën drejtimin e Administratores dhe në vartësi të Drejtorisë së Menaxhimit Burimeve Njerëzore dhe të Informacionit të Universitetit, mbledh e përpunon të gjitha llojet e informacionit të kërkuara nga instancat shtetërore, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, siguron funksionimin e rrjetit të shkëmbimit të informacionit në institucion në përputhje me detyrat që duhet të përballojë ai në fushën studimore e parashikuese strategjike si dhe për zbatimin e detyrave të Universitetit, sipas Statutit të tij. Sektori në lidhje të ngushtë me fakultetet, ka kryer detyrat si më poshtë :

1. Duke ndjekur hap pas hapi në bashkëpunim me Sekretariatë mësimore të fakulteteve, procedurat e konkurrimit deri në plotësimin e regjistrimit elektronik të studentëve me të gjitha të dhënat e skedës së regjistrimit, matrikullimin.
2. Ka mbledhur informacionet për studentët nga tre fakultetet, ka bërë përpunimin e të dhënave dhe hedhjen e tyre sipas Templateve për raportim statistikor të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Institutit të Statistikës dhe i ka dërguar informacionet me anë elektronike(E-mail), në periudha dhe afate të caktuara. Të dhëna mbi trupën mësimore ndihmës dhe punonjësve administrative.

TEMPLATET PËR RAPORTIM STATISTIKOR Të dhëna të përpunuara nga fakultete.
Regjistrimet në Arsimin e Lartë për çdo Degë: Numrin e studentëve të ndarë sipas fakulteteve, sipas cikleve, sipas programeve të studimit, sipas viteve, sipas gjinisë, sipas prejardhjes (fshat, të huaj). Të regjistruar të rinj (për herë të parë).

Moshat e Studentëve : Numrin e studentëve sipas moshave të ndarë sipas fakulteteve, sipas cikleve, sipas programeve të studimit, sipas viteve, sipas gjinisë. (gjithsej dhe pranuar të rinj).

Studentë me Nënshitetësi të Huaj sipas Shteteve: Numrin e studentëve sipas fakulteteve, sipas cikleve, sipas programeve të studimit

Provimet e Vjeshtës dhe Përfundimet Vjetore për çdo Degë: Të dhëna të përpunuara nga fakultete.

Nr e studentëve të ndarë sipas fakulteteve, sipas cikleve, sipas programeve të studimit, sipas viteve, sipas gjinisë, të regjistruar në qershor, kaluan në qershor, kaluan në vjeshtë, studentë me provime të mbartura, kalojnë në vitin pasardhës, si dhe të diplomuarit në qershor, vjeshtë, studentë të diplomuar në harkun kohor 3 vjeçar (KP), 2 vjeçar (MP) dhe 2 vjeçar (Msc-KP). **Provimet e Vjeshtës dhe Përfundimet Vjetore për çdo Degë Cikli i parë i studimit me kohë të plotë “ BACHELOR-KP” 2021-2022**

3. Ka mundësuar (në bashkëpunim me pergj.e sektorit te rrjetit kompjuterik) abdetimin e të dhënave (pasqyrave statistikore) në faqen e internetit.
4. Në vartësi të Drejtorisë së Menaxhimit Burimeve Njerëzore dhe të Informacionit mblidhen të dhënat e kualifikimit të personelit mësimor shkencor të fakultete dhe bëhet përpunimi si çdo vit.
5. Në vartësi të Drejtorisë së Menaxhimit Burimeve Njerëzore dhe të Informacionit ka mundësuar plotësimin e dosjeve të punonjësve mësimorë të ftuar të Universitetit me vërtetime të vjetërsisë në punë, duke i nxjerrë nga arkiva e Sektorit, si dhe plotësimin e plotë të dosjeve për procedurat e konkursit.
- 6 Në zbatim të Urdhërit të Rektorit nr.159, datë, 09.11.2021 “Fillimin e pranimeve të aplikimeve, nga ana e fakulteteve të UART, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2021-2022, në Universitetin e Arteve”. Urdhrit të Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 160, datë 09.11.2021 mbi “ Fillimin e procedurës së pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, nga ana e fakulteteve të Universitetit të Arteve , për studentët, të cilët do të aplikojnë për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë,në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, për vitin akademik 2021-2022 në Universitetin e Arteve”. Mbas miratimit te Vendimeve te Bordit te Administrimit, në vartësi të Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, ka përgatitur tabelat statistikore për studentët që përfitojnë përjashtim / reduktim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit për vitin 2021-2022.
7. Në vartësi të Drejtorisë së Menaxhimit Burimeve Njerëzore dhe të Informacionit dhe Drejtorinë Ekonomike, ka punuar për plotësimin në vazhdimësi të librit (që me krijimin e institucionit), me punonjësit mësimorë efektivë të ftuar, (emër, mbiemër, fakultet, departament, titull, lënda që jep).
8. Në vartësi të Drejtorisë së Menaxhimit Burimeve Njerëzore dhe të Informacionit, ka bashkëpunuar me sekretaritet e tre fakulteteve ka punuar për vazhdimësimin e plotësimit të “Arkivës Dixhitale të diplomave“, sipas Urdhërit nr. 209, datë 23.05.2012, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës “Për krijimin e arkivës dixhitale të diplomave të lëshuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, gjatë viteve 2002-2022”, me të dhënat e kërkuara sipas formatit të ardhur nga MASR.
9. Në vartësi të Drejtorisë së Menaxhimit Burimeve Njerëzore dhe të Informacionit bën raportimin në MASR për çdo informacion jashtë radhe kur kërkohet nga institucioni epror në fjalë.
10. Zbatime të Urdhërave të Administratorit për pjesmarjen në procedurat e prokurimit si anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurat e prokurimit te tenderat me objekt si më poshtë:
- a) “Rikonstruksion për nevoja të Fakulteteve (të Artit Skenik dhe të Arteve të Bukura) në Universitetin e Arteve”, sipas Urdhërit nr. 44, datë 06.06.2022
- b) “Furnizim Vendorsje të materialeve elektrike, pranë Fakultetit të Artit Skenik në UART”, sipas Urdhërit nr. 52, datë 02.09.2022.
- c) “ Blerje Instrumenta Muzikore, Piano, Kitara, Bateri, Trombë e të tjera, dhe vendorsje në funksion në Autoritetin Kontraktor”, sipas Urdhërit nr. 70, datë 21.11.2022
11. Zbaton çdo urdhër të posaçëm të Rektorit të Universitetit për situatë të veçantë, urgjente e ngjarje të rëndësishme në jetën e institucionit.

Analizë për veprimtarinë ekonomike të Universitetit të Arteve për Janar-Nëntor 2022

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015, datë 22.5.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar, ligjit vjetor nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimit të Ministrit të Financave, Nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues Nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” I ndryshuar, Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile/nëpunësve...”, i ndryshuar, VKM nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar” dhe vendimit të Bordit të Administrimit Nr.15 datë 15.07.2021 “Për miratimin e numrit të punonjësve...”, Universiteti i Arteve, për periudhën Janar-Nëntor 2022, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve.


Buxheti për vitin 2022 është miratuar nga strukturat vendimmarrëse Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, bazuar në burimet e financimit, të cilat paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Në lekë

Art.	Emertimi	Kapitulli Nr.6	Kapitulli Nr.8	TOTALI
231	Investime	27,918,720	-	27,918,720
600	Paga	26,386,879	274,552,717	300,939,596
601	Sigurime shoqër. dhe shëndet.	2,251,305	44,580,472	46,831,777
602	Mallra dhe shërbime të tjera	13,911,464	34,785,260	48,696,724
605	Transferimet korrente jashtë	-	242,310	242,310
606	Ndihmë & Rimbursim telefoni	400,600	226,640	627,240
606	Bursa & Rimbursim tarife	-	14,090,000	14,090,000
	TOTALI	70,868,968	368,477,399	439,346,367

Shënim: **Kapitulli Nr.6** (Të ardhurat e UA), **Kapitulli Nr.8** (Granti i mësimdhënies)

Pesha specifike, që zë cdo kapitull i buxhetit, në buxhetin total të vitit 2022, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:




Realizimi i buxhetit të Universitetit të Arteve, për periudhën Janar-Nëntor 2022 është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Art.	Emertimi	Plani Viti 2022	Realizimi 11M/2022	% e realizimit
231	Investime	27,918,720	1,022,400	4%
600	Paga	300,939,596	242,125,787	80%
601	Sigurime shoqër. dhe shëndet.	46,831,777	41,213,401	88%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	48,696,724	33,688,916	69%
605	Transferimet korrente jashtë	242,310	159,136	66%
606	Ndihmë & Rimbursime	627,240	552,437	88%
606	Bursa	14,090,000	10,614,250	75%
	TOTALI	439,346,367	329,376,327	75%

Pesha specifike e cdo zëri të shpenzimeve, në shpenzimet totale, të realizuara për periudhën Janar-Nëntor 2022, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Në tabelën e mëposhtme është paraqitur buxheti për vitin 2022, bazuar në burimet e financimit dhe realizimi i tij për periudhën Janar-Nëntor 2022.

Në lekë

Nr.	Emertimi	Plani Viti 2022	Realizimi 11M/2022	% e realizimit
1	Kapitulli Nr.6 (Të ardhura)	70,868,968	15,782,206	22%
2	Kapitulli Nr.8 (Grant)	368,477,399	313,594,121	85%
	TOTALI	439,346,367	329,376,327	75%

INVESTIME (231)

Miraturar me vendimet e Bordit të Administrimit, investimet e parashikuara për vitin 2022 dhe të realizuara për periudhën Janar- Nëntor 2022, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Emertimi	Plani Viti 2022	Realizimi 11M/2022	% e realizimit
1	Instalime elektrike	1,700,600	-	0%
2	Pajisje audivizuale	2,695,910	-	0%
3	Pajisje teknike	11,099,576	-	0%
4	Rikonstruksion	2,960,000	-	0%
5	Vegla muzikore	8,262,634	-	0%
6	Kondicioner	1,200,000	1,022,400	85%
	TOTALI	27,918,720	1,022,400	4%

Për të gjithë investimet e parashikuara të realizohen për vitin 2022, të paraqitura edhe në tabelën e mësipërme, kanë nisur procedurat e prokurimit.

PAGA (600)

SIGURIMET SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE (601)

Miratuar me vendimet e Bordit të Administrimit, shpenzimet për “Paga” dhe “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” të parashikuara për vitin 2022 dhe të realizuara për periudhën Janar- Nëntor 2022, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Art.	Emertimi	Plani Viti 2022	Realizimi 11M/2022	% e realizimit
600	Paga	300,939,596	242,125,787	80%
601	Sigurime shoq. dhe shëndetësore	46,831,777	41,213,401	88%
	TOTALI	347,771,373	283,339,188	81%

Realizimi i shpenzimeve për “Paga” dhe “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” është brenda parashikimit të vitit 2022. Për periudhën Janar-Nëntor 2022 janë realizuar shpenzime për pagesën e personelit të brendshëm dhe atë të ftuar. Gjithashtu u paguan edhe shtesat e plota të pagave bazuar në VKM Nr.647 datë 05.10.2022, Nr.621 date 28.09.2022 dhe Nr.627 datë 28.09.2022.

MALLRA DHE SHERBIME (602)

Miratuar me vendimet e Bordit të Administrimit, zëri “Mallra dhe Shërbime” i parashikuar për vitin 2022 dhe i realizuar për periudhën Janar-Nëntor 2022, është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në lekë


Nr. llog.	Emertimi	Plani Viti 2022	Realizimi 11M/2022	% e realizimit
6020	Mallra dhe shërbime të tjera	2,230,000	1,334,663	60%
6021	Materiale dhe shërbime speciale	780,000	230,800	30%
6022	Shërbime nga të tretë	28,100,924	23,745,831	85%
6023	Shpenzime transporti	120,000	76,306	64%
6024	Shpenzime udhetimi	1,000,000	23,833	2%
6025	Shpen. për mirëmbajtje te zakonshme	1,392,000	98,160	7%
6029	Shpenzime të tjera operative	15,073,800	8,179,323	54%
	TOTALI	48,696,724	33,688,916	69%

- **Shënim:** Zërat e shpenzimeve të tabelës së mësipërme, të detajuara, janë të pasqyruar në Tabelën Nr.1

Për periudhën Janar-Nëntor 2022 shpenzimet e realizuara për mallra dhe shërbime kanë shërbyer për realizimin e procesit të mësimdhënies si dhe të funksionimit të Universitetit të Arteve. Shpenzimet për procesin e mësimdhënies janë realizuar duke u bazuar në kërkesat e ardhura nga fakultetet.

Kryesisht realizimi zërit “Mallra dhe Shërbime” është brenda parashikimit për vitin 2022, por parashikohet të ketë mosrealizime nga nënzërat si shërbime nga të tretë (shpenzime telefonike), shpenzime për sigurim ndërtese, si dhe nga raporti kërkesë-ofertë si pasojë se disa nënzëra blihen me procedurë prokurimi.

Pesha specifike që zë cdo shpenzim, në shpenzimet totale të realizuara për mallra dhe shërbime, për periudhën Janar-Nëntor 2022, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:




TË ARDHURAT

Të ardhurat e parashikuara të realizohen për vitin 2022 dhe ato të realizuara për periudhën Janar-Nëntor 2022, nga Universiteti i Arteve, janë si në vijim:

Nr.	Burimi i krijimit i të ardhurave	Plani (P) Viti 2022	Realizimi (R) 11M/2022	Diferenca P-R	Në lekë
					% e realizimit
1	Tarifë Shkollimi	36,777,790	33,143,060	(3,634,730)	90%
2	Tarifë konkurrimi & regjistrimi	2,163,600	2,246,730	83,130	104%
3	Shërbim salle	500,000	510,000	10,000	102%
4	Qira ambjente	2,364,804	2,662,591	297,787	113%
5	Diploma, vërtet., shtypshk etj	300,000	443,133	143,133	148%
TOTALI		42,106,194	39,005,514	(3,100,680)	93%

Realizimi i zërave të të ardhurave është brenda parashikimit të vitit 2022, përveç zërit “Tarifë shkollimi”. Ky zë ka mosrealizim si pasojë e mosshlyerjes së tarifës së shkollimit nga studentët, për vitin akademik 2021-2022.

Pesha specifike që zë cdo burim, në të ardhurat totale të realizuara për periudhën Janar-Nëntor 2022, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të ardhurat e realizuara për periudhën Janar-Nëntor 2022, krahasuar me vitin 2021.

Në lekë					
Nr.	Burimi i krijimit i te ardhurave	Viti 2021 (lek)	11M/2022 (lek)	Diferanca 2022-2021	% e rritjes
1	Tarifë shkollimi	33,367,830	33,143,060	(224,770)	-1%
2	Tarifë konkurrimi & rregjistrimi	2,163,684	2,246,730	83,046	4%
3	Shërbim salle	425,000	510,000	85,000	20%
4	Qira ambjente	1,943,251	2,662,591	719,340	37%
5	Diploma, vërtet., shtypshk etj	279,100	443,133	164,033	59%
TOTALI		38,178,865	39,005,514	826,649	2%

TË TJERA

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e realizuara për periudhën Janar-Nëntor 2022, krahasuar me vitin 2021.

Në lekë					
Art.	Emertimi	Shpenzime Viti 2021	Shpenzime 11M/2022	Diferenca 2022-2021	% e rritjes
231	Investime	6,134,994	1,022,400	(5,112,594)	-83.33%
600	Paga	298,971,447	242,125,787	(56,845,660)	-19.01%
601	Sigur. shoqër. dhe shëndet.	44,869,093	41,213,401	(3,655,692)	-8.15%
602	Mallra & shërbime	31,558,929	33,688,916	2,129,987	6.75%
605	Transferimet korrente jashtë	158,500	159,136	636	0.40%
606	Bursa për studentët	16,880,750	10,614,250	(6,266,500)	-37.12%
606	Transf. për buxhetet e individ.	543,677	497,437	(46,240)	-8.51%
606	Rimbursim tarifë shkollimi	120,000	55,000	(65,000)	100.00%
TOTALI		399,237,390	329,376,327	(69,861,063)	-17.50%

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur shpenzimet e realizuara për periudhën Janar-Nëntor 2022, krahasuar me vitin 2021.




Tabela Nr.1
Në lekë

Nr. llog.	Emertimi	Plani (P) Viti 2022	Realizimi (R) 11M/2022	% e realizimit
6020100	Kancelari	250,000	242,195	97%
6020200	Materiale per pastrim dezinfikim ngrohje ndricim	360,000	239,532	67%
6020300	Matariale per funksionimin e pajisjeve te zyres	180,000	90,000	50%
6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	960,000	539,856	56%
6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre e te pergjithshme	480,000	223,080	46%
6020	Mallra dhe shërbime të tjera	2,230,000	1,334,663	60%
6021007	Libra dhe publikime profesionale	420,000	-	0%
6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	240,000	152,400	64%
6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	120,000	78,400	65%
6021	Materiale dhe shërbime speciale	780,000	230,800	30%
6022001	Energji elektrike	5,000,000	4,494,893	90%
6022002	Uje	1,200,000	894,924	75%
6022003	Sherbime telefonike	450,000	-	0%
6022004	Sherbime postare	10,000	10,905	109%
6022005	Sherbim ngrohje	1,200,000	-	0%
6022007	Sherbime bankare	10,000	3,143	31%
6022008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes (Minis. e Brendsh)	7,868,460	6,539,950	83%
6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	450,000	175,200	39%
6022099	Sherbime te tjera	11,912,464	11,626,816	98%
6022	Shërbime nga të tretë	28,100,924	23,745,831	85%
6023100	Karburant	50,000	49,794	100%
6023300	Shpenzime per Siguracion per makina	70,000	26,512	38%
6023	Shpenzime transporti	120,000	76,306	64%
6024100	Udhetim brenda vendit	500,000	-	0%
6024200	Udhetim jashte vendit	500,000	23,833	5%
6024	Shpenzime udhetimi	1,000,000	23,833	2%
6025300	Shpenzime per mirembajtje objekteve ndertimore	360,000	-	0%
6025400	Shpenzime mirembajte rrjeteve hidraulike elektrike	120,000	-	0%
6025500	Shpenzime mirembajte Pajisjeve, veglave te punes	600,000	50,400	8%
6025600	Shpenzime per mirembajte mjeteve te transportit	72,000	47,760	66%
6025800	Shpenzime per mirembajte Pajisje zyre	240,000	-	0%
6025	Shpen. për mirëmbajtje te zakonshme	1,392,000	98,160	7%
6029001	Shpenzime per pritje percjellje	120,000	51,984	43%
6029004	Shpenzim sigurim ndertese	480,000	-	0%
6029005	Shpenzime per honorare	9,955,000	5,745,575	58%
6029008	Shpenzime tatim dhe taksa	850,000	827,744	97%
6029099	Shpenz. te tjera materiale dhe sherbime operative	3,668,800	1,554,020	42%
6029	Shpenzime të tjera operative	15,073,800	8,179,323	54%
	TOTALI	48,696,724	33,688,916	69%

Miraturar me Vendim të Senatit Akademik Nr. _____ / Datë _____ / _____ / _____

